



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 282 Akti

Nr. 368 Vendimi
Tiranë, më 19.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko Kryesuese
Firdes Shuli Relatore
Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Springer, në datat 18.9.2020, 15.4.2021 dhe 19.4.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i dytë, salla 0 (*underground*), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kolë Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Z. Kolë Hysenaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
- 2.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.3.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Olsi Komici dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
- 3.** Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
- 4.** Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 8.11.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj.
- 5.** Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2019, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, të KDZH-së.
- 6.** Me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 18.5.2020, KLGj-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Kolë Hysenaj.
- 7.** Me vendimin nr. 1, datë 26.3.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kolë Hysenaj, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktoj kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 8.** Në datën 17.4.2019, subjektit iu komunikua përmes postës elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije edhe e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit.

Në po këtë datë, subjekti deklaroi përmes postës elektronike se nuk ka asnjë konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

9. Në datën 11.7.2020, subjekti njoftoi përmes postës elektronike se priste t'i nënshtrohej një ndërhyrjeje kirurgjikale dhe, për këtë arsye, do të ishte në pamundësi objektive për të vijuar komunikimin në kuadër të procesit të rivlerësimit për një periudhë të pacaktuar, duke paraqitur një rekomandim mjekësor për ortopedin të lëshuar nga mjeku i familjes.

10. Me vendimin nr. 2, datë 13.7.2020, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

11. Në datën 14.7.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 28.7.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Me letrën e datës 16.7.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.7.2020, subjekti i rivlerësimit informoi Komisionin se ishte në kushtet e paaftësisë së përkohshme në punë, në pritje të ekzaminimeve për ndërhyrje të mundshme kirurgjikale, duke paraqitur raport mjekësor të datës 11.7.2020, sipas të cilit bëhej i aftë për punë në datën 25.7.2020.

13. Në datën 20.7.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve deri më 28.7.2020.

14. Me kërkesën për shtyrje të datës 27.7.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 27.7.2020, subjekti i kërkoi Komisionit shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve për shkak se në datën 24.7.2020 i ishte nënshtuar një ndërhyrjeje kirurgjikale dhe vijonte të ishte i shtruar në spital, duke paraqitur kartelën klinike nr. *** të Spitalit Universitar të Traumës, pavijoni i ortopedisë.

15. Me vendimin nr. 3, datë 29.7.2020, Komisioni vendosi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve deri në datën 31.8.2020.

16. Në datën 31.8.2020, subjekti i rivlerësimit paraqiti, përmes postës elektronike, parashtrimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit.

17. Me vendimin nr. 4, datë 15.9.2020, pas analizimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj në seancë dëgjimore datë 18.9.2020, ora 10:30, pranë Pallatit të Koncerteve.

18. Në datën 18.9.2020 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

19. Me vendimin nr. 5, datën 23.9.2020, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit për subjektin e rivlerësimit me qëllim kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore shtesë.

20. Në përfundim të hetimit shtesë, në datën 2.12.2020, përmes postës elektronike, trupi gjykues i dërgoi subjektit rezultatet e hetimit administrativ shtesë, duke i caktuar si afat për paraqitjen e parashtrimeve deri më 16.12.2020.

- 21.** Në datën 16.12.2020, subjekti ka njoftuar përmes postës elektronike se në datën 14.12.2020 ishte diagnostikuar me Covid-19 dhe nuk mund të parashikonte kohën e rikuperimit, duke paraqitur analizën e kryer në laboratorin mjekësor “***”.
- 22.** Me vendimin nr. 6, datë 17.12.2020, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me rezultatet e hetimit shtesë, deri në datën 5.1.2021, si dhe të caktojë zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 8.1.2021.
- 23.** Në datën 5.1.2021, përmes postës elektronike, bashkëshortja e subjektit D. H., informoi Komisionin se subjekti Kolë Hysenaj gjendej në kushte të vështira shëndetësore, pasi ndodhej në intubim dhe furnizim me oksigjen të vazhdueshëm, duke paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë, të lëshuar nga instituti shëndetësor “Dispanseria” Tiranë, lëshuar në datën 5.1.2020, i cili fillonte prej datës 31.12.2020 deri më 15.1.2021.
- 24.** Me vendimin nr. 7, datë 7.1.2021, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e parashtrimeve në lidhje me rezultatet e hetimit shtesë deri në datën 20.1.2021, si dhe të shtyjë datën e seancës dëgjimore deri në një njoftim të dytë.
- 25.** Në datën 19.1.2021, përmes postës elektronike, bashkëshortja e subjektit D. H. informoi Komisionin se subjekti Kolë Hysenaj vijonte të ishte në kushte të rënda shëndetësore, për shkak të gjendjes post-covid dhe pneumonisë së shkaktuar prej tij, duke paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë, të lëshuar nga instituti shëndetësor “Dispanseria” Tiranë, lëshuar në datën 15.1.2021, i cili fillonte prej datës 15.1.2021 deri më 4.2.2021.
- 26.** Me vendimin nr. 8, datë 21.1.2021, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin për paraqitjen e parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit shtesë, deri në datën 8.2.2021.
- 27.** Në datën 8.2.2021, përmes postës elektronike, bashkëshortja e subjektit D. H., informoi Komisionin se subjekti Kolë Hysenaj vijonte të ishte në kushte të rënda shëndetësore, për shkak të gjendjes post-covid dhe pneumonisë së shkaktuar prej tij, duke paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë, të lëshuar nga instituti shëndetësor “Dispanseria” Tiranë, lëshuar në datën 5.2.2021, i cili fillonte prej datës 4.2.2021 deri në datën 3.3.2021.
- 28.** Në datën 10.2.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues i kërkoi subjektit sqarime mbi mënyrën e trajtimit të tij gjatë periudhës së infeksionit me Covid-19, nëse ishte trajtuar në kushte spitalore apo shtëpie, shoqëruar me dokumente që vërtetonin këto fakte.
- 29.** Në datën 15.2.2021, përmes postës elektronike, subjekti ka informuar se ishte trajtuar me oksigjen e antibiotikë të fuqishëm në kushte shtëpie për mëse tri javë, duke paraqitur dokumentacion shoqërues.
- 30.** Në datën 17.2.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues ka informuar subjektin për shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve deri në datën 18.3.2021.
- 31.** Në datën 18.3.2021, subjekti, përmes postës elektronike, dërgoi parashtrimet mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë.
- 32.** Me vendimin nr. 9, datë 9.4.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Kolë Hysenaj në seancë dëgjimore në datën 15.4.2021, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve.
- 33.** Në datën 15.4.2021 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore, në të cilën subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

34. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

35. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

36. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

37. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

38. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

39. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

40. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Po kështu, neni Ç i Aneksit të Kushtetutës parashikon se rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit. Në zbatim të këtyre dispozitave kushtetuese, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kol Hysenaj, bazuar në të tria kriteret, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancave dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

A. VLERËSIMI I PASURISË

41. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 29.1.2017, pra, në periudhën kur ligji

ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Kolë Hysenaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi 1840 dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

42. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin e rivlerësimit ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

43. Pas administrimit të raportit të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, nga Komisioni u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurive të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, si dhe të ligjshmërisë së krijimit/burimit të tyre, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuria apartament me sip. 120 m², Tiranë

44. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar: *pasuria nr. pasurie ***, z. k. ***, me adresë: ap. nr. ***, k. ***, p. ***, rruga “M. P.”, Tiranë. Vlera: 1.960.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Pasuri e përfutur me: (a) kontratë porosie datë 5.2.1997; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 3.10.2002; dhe (b) kontratë shkëmbimi pasurish të paluajtshme nr. *** rep., datë 27.9.2010. Burimi i krijimit: (a) hua kunatit në vlerën 1.300.000 lekë, shlyer gjatë viteve me këste; (b) kursime nga pagat; dhe (c) ndihmesë nga familja pas ndarjes nga trangu i babait.*

45. Konstatime të ILDKPKI-së për këtë pasuri

- Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar subjekti nuk ka deklaruar pasurinë e llojit “garazh” me sip. 25 m², në të njëjtën adresë me apartamentin në rrugën “M. P.” (“S. D.” apo “M. Gj.”) Tiranë. Ka paraqitur dokumentacion për këtë pasuri. Është deklaruar në deklaratën e vitit 2003 dhe është në të njëjtën kontratë me apartamentin dhe me çmim të përbashkët.

- Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar nuk është deklaruar saktë shuma e marrë hua për blerjen e banesës, ndërsa në deklaratën e vitit 2003 është specifikuar vlera 300.000 lekë nga vëllai P. H. dhe vlera 1.300.000 lekë nga kunati T. F.. Referuar deklarimeve ndër vite, huaja ndaj z. T. F. është shlyer deri në vitin 2007, kurse vëllai P. H. i ka falur shumën 200.000 lekë.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me huamarrjet e deklaruara dhe me burimin financiar të huadhënësve, ndërsa për kunatin subjekti ka paraqitur dokumentacion jofinanciar.
- Fshehje në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat e interesave private në ILDKPKI të vënies së pasurisë së subjektit, apartament me sip. 98 m², në vitin 2002 dhe më pas e zëvendësimit me apartamentin me sip. 120 m², në vitin 2010, në Tiranë, si kolateral për kredinë e marrë nga shtetasi P. P. në “Raiffeisen Bank”. Në rivlerësim ka paraqitur dokumentacionin përkatës.
- Konfirmim kontradiktor i ZVRPP-së Tiranë sa i përket kërkesës nga shtetasi Kolë Hysenaj për ndarje pasurie të apartamentit dhe garazhit me vërtetime pronësie më vete, pasi bashkëlidhur përgjigjes nr. ***, datë 25.4.2018, të ZVRPP-së Tiranë, kjo kërkesë gjendet e administruar nga ky institucion.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

46. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

46.1 ASHK Tirana Veri¹ konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit Kolë N. Hysenaj pasurinë e llojit “apartament” me sip.120 m², nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***.

46.2 OSHEE-ja² nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji elektrike për këtë pasuri. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka sqaruar dhe vërtetuar me dokumente shkresore se³ për këtë apartament disponon librezën me nr. kontrate ***, me kod klienti ***, hapur më 18.8.2000 dhe se në datën 12.1.2015 është bërë ndryshimi i emrit nga A. R. (pronari i mëparshëm) në emrin e tij. Ndërsa për apartamentin e disponuar prej tij më herët dhe të shkëmbyer në vitin 2010 me shtetasin A. R., depozitoi librezën me nr. kontrate ***, me kod klienti ***, e hapur në emër të tij në datën 18.8.2000, e cila ka kaluar në emër të znj. D. V..

47. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit nga aktet në dosje⁴, në rend kronologjik, rezultoi se:

47.1. Me kontratën e porosisë së datës 5.2.1997, noterizuar me vërtetimin nr. ***, datë 7.2.1997 dhe aneks kontratën bashkëlidhur, bashkëshortja e subjektit D. H. ka porositur pranë shoqërisë “****” sh.p.k., ndërtimin e apartamentit me sip. 98 m², nr. ***, k. ***, me çmim 19.600 USD.

47.2. Në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 12.12.1997, është regjistruar në pronësi të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Policisë Ndërtimore Tiranë, pallati i përbërë nga 21 apartamente dhe garazhe në katin e parë të tij.

47.3. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.10.2002, shtetasi Kolë Hysenaj bleu nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 98 m², nr. ***, rruga “M. Gj.”, Tiranë.

47.4. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të datës 3.9.2010, pasuria apartament me sip. 98 m², nr. ***, në rrugën “M. Gj.”, figuron e regjistruar në pronësi të shtetasit Kolë Hysenaj dhe është vënë si barrë hipotekore pranë ish-Bankës së Kursimeve, për një hua të marrë nga shtetasi P. P., për të cilin, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti sqaroi se ka qenë ish-anëtar i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe se ka pasur ka miqësi familjare prej 25-30

¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2019, nga ASHK Tirana Veri, në dosjen e Komisionit.

²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.4.2019, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

³Shihni librezat dhe shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2020, të FSHU-së.

⁴Shihni aktet në Aneksin 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2019, nga ASHK Tirana Veri në dosjen e Komisionit.

vjetësh. Vendosja e apartamentit të tij si garanci për marrjen e një kredie nga z. P. P. është bërë me qëllim për t'i ardhur atij në ndihmë për shkak të miqësisë mes tyre, deklarime të cilat konfirmohen me deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.2.2020, të ketij shtetasi. Ndërsa në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi, nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Korçë⁵, nuk u konfirmuan kallëzime apo procedime penale të regjistruara të trajtuara nga prokurori Kolë Hysenaj gjatë kohës që ka ushtruar funksionin në prokurorinë përkatëse.

47.5. Me kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 27.9.2010, pasuria apartamenti me sip. 98 m², nr. ***, në pronësi të subjektit, është shkëmbyer me pasurinë apartament me sip. 120 m², nr. ***, në pronësi të shtetasit A. H.. Sipas kësaj kontrate, shtetasi A. H. bëhet pronar i pasurisë me sip. 98 m², nr. ***⁶, p. ***, ndërsa shtetasi Kolë Hysenaj bëhet pronar i pasurisë me sip. 120 m², nr. ***, p. ***, te dyja me adrese ne rrugen “M. Gj.”. Pala A. H. ka marrë përsipër barrën hipotekore në favor të ish-Bankës së Kursimeve, sot “Raiffeisen Bank”. Po sipas kontratës, shkëmbimi bëhet pa asnjë kusht, pasi apartamenti i shtetasit A. H. është i parikonstruktuar dhe i pamobiluar. Kontrata e shkëmbimit është redaktuar pas pëlqimit të “Raiffeisen Bank” me deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.9.2010, sipas së cilës kjo bankë ka rënë dakord me shkëmbimin, si dhe kalimin e pasurisë me barrën hipotekore deri në shlyerjen e kredisë nga shtetasi P. P.. Me përfitimin nga ana e subjektit të pasurisë nr. *** sipas kontratës së shkëmbimit, kjo pasuri u vendos si garanci hipotekore për shlyerjen e kredisë në shumën 5.000.000 lekë shtetasit P. P. në “Raiffeisen Bank”, me kontratën e hipotekës nr. ***, datë 1.10.2010.

47.6. Siç vërehet, janë shkëmbyer pa asnjë kusht dy pasuri të ndodhura në të njëjtën godinë me sipërfaqe të ndryshme banimi, fakt i deklaruar nga subjekti edhe në DPV-në e vitit 2010, në të cilën është deklaruar kontrata e shkëmbimit me sqarimin se nuk janë shtuar para për shkëmbimin, pasi prona ka qenë e pamermetuar dhe e pamobiluar. Subjekti, i pyetur në lidhje me shkakun e këtij lloj këmbimi, si dhe për marrëdhënien me shtetasin A. H., në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka sqaruar se shtetasin A. H. e ka fqinjë, shkëmbimi i pasurive është realizuar pa kundërshtpërblim, me vullnet dhe dëshirë të plotë te paleve. Këto deklarime konfirmohen edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.2.2020 të shtetasit A. H.. Nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Korçë⁷ nuk u konfirmuan kallëzime apo procedime penale të trajtuara nga prokurori Kolë Hysenaj gjatë kohës që ka ushtruar funksionin në prokuroritë përkatëse.

47.7. Duke qenë se kontrata e shkëmbimit parashikonte se këmbimi është bërë pa asnjë kusht pasi apartamenti i shtetasit A. H. ishte i parikonstruktuar dhe i pamobiluar, si dhe në kushtet kur në të gjitha DPV-të pas vitit 2010 deri në DPV-në e vitit 2017, subjekti nuk ka deklaruar shpenzime rikonstruktimi e mobilimi, me qëllim evidentimin e vlerës së shpenzimeve të kryera në pasurinë e përfituar nga këmbimi, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: “

⁵Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

⁶Sipas ASHK-së Tirana Veri, pasuria nr. ***, apartament me sip. 98 m² (fituar me kontratë shkëmbimi me pasurinë z. k. ***, vol. ***, f. ***) figuron ende në emër të subjektit. Por, sipas kartelës së pasurisë, kjo pasuri rezulton në emër të znj. D. V.. Në vërtetimin e ZVRPP-së Tiranë pranë ILDKPKI-së rezulton që kjo pasuri është e transkriptuar në favor të të tretëve. Pasqyrimi në emër të subjektit, duhet të jetë lapsus.

⁷Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

... që nga hyrja në këtë apartament dhe deri aktualisht, në periudha të ndryshme të vitit, kam kryer zëvendësime apo riparime të pajisjeve elektroshtëpiake, për shkak të shtrirjes së këtyre blerjeve në kohë ...”. Pra, nuk ka deklaruar asnjë fakt në lidhje me investime rikonstruksioni apo mobilimi.

47.8. Në procesverbalin e pyetjes në ILDKPKI të datës 15.6.2016, subjekti ka deklaruar se punimet e kryera në apartament kanë qenë në vlerën 600.000 lekë, pa dhënë shpjegime lidhur me periudhën kur janë kryer këto punime dhe pa vënë në dispozicion dokumente shkresore. Lidhur me këtë deklaram, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime, dhe ne përgjigjet e datës 26.6.2020, ai deklaroi se shuma totale e shpenzimeve për rikonstruksionin e këtij apartamenti ka qenë 600.000 lekë e ndarë në rreth 6 vjet, ndërkohë që mobiljet i ka marrë nga banesa ekzistuese. Duke qenë se subjekti nuk vërtetoi investime të kryera me dokumente shkresore, si dhe nisur nga fakti që pasuria ishte shkëmbyer dhe marrë në dorëzim në vitin 2010, është logjike që shpenzimet për rikonstruksionin e apartamentit të jenë kryer në këtë vit dhe, për rrjedhojë, shuma prej 600.000 lekësh është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të këtij viti.

48. Pasi u verifikuan deklaramet e subjektit, sa i takon pasurisë apartament me sip. 98 m² dhe pasurisë apartament banimi me sip. 120 m², u konstatua se:

48.1. Në deklaratën e vitit 2003 është deklaruar: “*Apartament banimi me sip. 97 m² (2+1) (dhe garazh në vlerën 1.990.000 lekë), me adresë rruga “S. D.”, p. ***, ap. ***, k. ***, Tiranë, nga shoqëria ‘***’ sh.p.k., me burim: të ardhura familjare nga pagat e mia dhe bashkëshortes, si dhe hua familjare nga vëllai P. H. dhe kunati T. F.*”. Në rubrikën “*Detyrime financiare*” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: (a) hua për blerjen e banesës, marrë nga z. P. H. (vëllai i subjektit) në shumën 30.000 lekë. Kjo hua nuk është deklaruar si burim në deklaratën Vetting; dhe (b) hua për blerjen e banesës, marrë nga z. T. F. (vëllai i bashkëshortes, emigrant në Itali që prej vitit 1995), në shumën 1.300.000 lekë”.

48.2. Në DPV-në e vitit 2010 është deklaruar: “*Kontratë shkëmbimi pasurie të paluajtshme për apartament banimi me sip. 120 m², e pasqyruar me kontratën noteriale nr. ***, datë 27.10.2010, në Tiranë, midis palëve, shkëmbyesi i parë Kolë Hysenaj dhe shkëmbyesi i dytë A. H.. Prona e re pas shkëmbimit është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me nr. hipotekor ***, datë 28.9.2010*”.

48.3. Në deklaratën Vetting, ka deklaruar, *apartament banimi me sip. 120 m², nr. ***, z. k. ***, me adresë: ap. nr. ***, k. ***, p. ***, rruga “M. P.”, Tiranë. Vlera: 1.960.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Përfutuar me: (a) kontratë porosie datë 5.2.1997; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 3.10.2002; (b) kontratë shkëmbimi pasurish të paluajtshme nr. *** rep., datë 27.9.2010. Burimi i krijimit: (a) hua kunatit në vlerën 1.300.000 lekë, shlyer gjatë viteve me këste; (b) kursime nga pagat; (c) ndihmesë nga familja pas ndarjes nga trangu i babait.*

49. Në deklaratën Vetting është deklaruar vetëm apartamenti me sip. 120 m², nr. ***, z. k. ***, i përfutuar nga shkëmbimi me shtetasin A. H.. Nuk është deklaruar pasuria garazh me sip. 25 m², nr. ***⁸, i cili është blerë me të njëjtën kontratë shitblerjeje, nr. ***, datë 3.10.2002, që është blerë edhe pasuria apartament banimi me sip. 98 m², nr. ***. Subjekti, i pyetur mbi këtë mospërrputhje në përgjigje të pyetësorit nr. 3, deklaroi se: “... *garazhi me sip. 25 m² është blerë prej meje së bashku me apartamentin, kjo referuar kontratës nr. ***, datë 3.10.2002, e cila është deklaruar dhe depozituar rregullisht prej meje, qoftë në deklaratën periodike ashtu edhe*

⁸ Pasuria garazh është konfirmuar me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2019, të ASHK Tirana Veri, në dosjen e Komisionit.

*në deklaratën Vetting. Sqaroj Komisionin se pas nënshkrimit të kontratës së mësipërme të shitblerjes, kam bërë regjistrimin e saj në ZVRPP-në Tiranë, duke u lëshuar më pas edhe vërtetimin nga dokumenti hipotekor, por nuk jam pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie, prandaj edhe deklarimi i garazhit prej meje është bërë së bashku me banesën, duke dorëzuar në deklaratën periodike dhe deklaratën Vetting, kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.10.2002, ku qartësisht evidentohet se objekt shitblerje janë banesa dhe garazhi”. Pra, sipas subjektit, shkak i mosdeklarimit të garazhit në deklaratën Vetting ka qenë se të dyja këto pasuri kanë pasur të njëjtën origjinë prone dhe se për garazhin nuk ka qenë i pajisur me certifikatë pronësie.*

49.1. Për të vërtetuar këto pretendime, subjekti ka paraqitur: (i) shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 20.4.2018, të ZVRPP-së Tiranë, sipas së cilës apartamenti me sip. 98 m² dhe garazhi me sip. 25 m² janë regjistruar në hipotekë ne regjistrin hipotekor me të njëjtin numër rendor ***, datë 12.12.1997, ndarë më vonë në dy pasuri më vete: apartamenti me nr. pasurie *** dhe garazhi me nr. pasurie ***; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 27.2.2020, të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. P. A., sipas së cilës konfirmohet se shitja e apartamentit dhe garazhit ka qenë në vlerën 1.960.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 3.10.2002.

50. Sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 3.10.2002, çmimi i blerjes për të dyja pasuritë apartament dhe garazh, është përcaktuar në vlerën 1.960.000 lekë, ndërkohë që kontrata e porosisë, datë 5.2.1997, parashikon çmimin 19.600 USD ose 2.424.716 lekë⁹. Subjekti u pyet lidhur me diferencën e çmimit në këto kontrata dhe në përgjigjet e datës 26.6.2020, ka deklaruar se: “... në lidhje me mospërputhjen e monedhës së përcaktuar në kontratat përkatëse, mund të sqaroj komisionin se likuidimi i plotë i çmimit të pasurisë është kryer në monedhën lekë dhe ka qenë në vlerën prej 1.960.000 lekë. Për këtë fakt, pavarësisht se në kontratën e porosisë është përcaktuar çmimi në dollarë, nëse i referohemi nenit 2, pika 1, si edhe Aneks Kontratës së ndodhur bashkëlidhur kontratës së porosisë, kësti i parë në masën 30 % të çmimit total i referohet një vlere prej 588.000 lekë. Pra, pavarësisht se në kontratën e porosisë çmimi rezulton në dollar, përlllogaritjet e bëra nga shitësi, si edhe likuidimi i kësteve të saj është bërë në lekë, duke përlllogaritur kurset e monedhave në vlerën 1 USD i barasvlershëm me 100 lekë”.

51. Sa i takon çmimit të blerjes se garazhit, nuk rezulton që subjekti të ketë kryer deklarime, si dhe nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë sa është çmimi i përcaktuar nga palët për blerjen e tij, pasi kontrata e porosisë datë 5.2.1997 ka pasur si objekt vetëm porositjen e apartamentit me sip. 98 m² me çmimin 19.600 USD, ndërkohë që në kontratën e shitjes nr. ***, datë 3.10.2002, objekt i shitjes përveç apartamentit ka qenë edhe garazhi me sip. 25 m², ndërsa çmimi është 1.960.000 lekë, pa u përcaktuar një çmim specifik për secilën pasuri. Gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon që apartamenti dhe garazhi janë blerë së bashku me çmimin 1.960.000 lekë (19.600 USD). Ndërkohë, ky deklarim vjen në kundërshtim jo vetëm me kontratën individuale të porosisë së datës 5.2.1997, objekt i së cilës ka qenë vetëm apartamenti me sip. 98 m², por edhe me kontratën e sipërmarrjes së datës 9.1.1997, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe Gjykatës së Apelit Tiranë (redaktuar para kontratës individuale të porosisë me subjektin e rivlerësimit datë 5.2.1997), e cila parashikon vetëm çmimet e apartamenteve të banimit dhe, konkretisht, çmimet për apartamentet me sip. 98 m² janë 19.600 USD, të cilat do të likuidoheshin në mënyrën e përcaktuar në një kontratë individuale porosisë.

52. Me qëllim evidentimin e ndonjë favorizimi të subjektit për blerjen e garazhit dhe përfitim të tij për shkak të detyrës, me kërkesë të Komisionit, Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit

⁹ Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për datën 5.2.1997 është 123.71 lekë.

Gjyqësor Tiranë dhe Korçë¹⁰ nuk konfirmuan kallëzime apo procedime penale që kanë lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k dhe administratorin e saj, shtetasin P. A., apo çështje të trajtuara nga prokurori Kolë Hysenaj gjatë kohës që ka ushtruar funksionin në prokurorinë përkatëse.

53. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi konstatimin se, subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasurinë me nr. ***, garazh me sip. 25 m², i cili rezulton të jetë blerë së bashku me apartamentin e banimit, prej 98 m² në të njëjtin çmim (sa çmimi i apartamentit më vete), sipas pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, neneve 30, 31/1 dhe shtojcës nr. 2, “Deklarata e pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

54. Në prapësimet e datës 31.8.2020, në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka parashtruar se: (i) kontrata e porosisë nuk ka shërbyer dhe nuk mund të shërbejë si titull përfundimtar për fitimin e pronësisë, prandaj në të nuk janë detajuar të gjitha kushtet e këtij transaksioni, përveç çmimit; (ii) garazhi është përfituar me kontratën e shitblerjes së vitit 2002, së bashku me apartamentin, të cilën e ka depozituar në ILDKPKI; (iii) në DVP-në fillestare të vitit 2003 apartamenti së bashku me garazhin janë deklaruar bashkërisht pasi kanë qenë të regjistruar në të njëjtin numër pasurie duke pasur certifikatë pronësie vetëm për apartamentin; (iv) subjekti e ka konsideruar këtë një moscitim formal të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, duke referuar edhe arsyetimin që Komisioni ka bërë në vendimin nr. 49 të KPK, datë 25.7.2018, të subjektit A. D.

55. Pas riçeljes së hetimit administrativ, Komisioni thelloi hetimin në lidhje me blerjen e garazhit me të njëjtin çmim me apartamentin duke kërkuar nga ASHK-ja kontratat e lidhura për apartamente banimi dhe garazhe në godinën ku ndodhet apartamenti që ka blerë subjekti i rivlerësimit. Drejtoria Vendore Tirana – Jug¹¹ vuri në dispozicion aktet si vijojnë: (i) 12 kontrata me objekt shitblerjeje apartamenti, me palë shitëse Gjykata e Apelit dhe shoqëria “****” sh.p.k. ose palë shitëse Policia Ndërtimore dhe Gjykata e Apelit; (ii) dy kontrata me objekt shitblerje apartament+garazh me palë shitëse Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “****” sh.p.k.; (iii) dy kontrata me objekt shitblerje garazhi me palë shitëse Gjykata e Apelit Tiranë dhe shoqëria “****” sh.p.k., nga marrja në shqyrtim e të cilave u konstatua se: (i) vetëm në një rast subjekti ishte në të njëjtat kushte me blerësin D. B., kur apartamenti dhe garazhi janë blerë në të njëjtën kontratë dhe me të njëjtin çmim të parashikuar për apartamentin e banimit. Ndërkohë, nuk disponohen të dhëna se çfarë ka parashikuar kontrata e porosisë për këtë blerës; (ii) për dy blerës është lidhur kontratë e veçantë për apartamentin dhe kontratë e veçantë për garazhin, me çmimet përkatëse të ndryshme për secilën prej pasurive; (iii) në të gjitha kontratat e tjera objekt i shitjes ka qenë vetëm apartamenti dhe jo garazhi.

56. Në kushtet kur vetëm kontrata e shtetasit D. B. ka qenë në të njëjtat kushte me kontratën e subjektit të rivlerësimit, me njoftimin e rezultateve të hetimit shtesë, subjektit iu dha mundësia të vijojë të japë sqarime në lidhje me faktin që apartamenti ishte blerë në të njëjtin çmim me garazhin. Në parashtrimet e datës 18.1.2021, subjekti është fokusuar te çmimi i blerjes së pasurisë, duke pretenduar se nuk është trajtuar në mënyrë preferenciale, pasi sipas tij, nga krahasimi i çmimeve në kontratat e vëna në dispozicion nga ASHK-ja, referenca për metër

¹⁰Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 3.3.2020 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

¹¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.10.2020, dhe dokumentacionin bashkëngjitur nga ASHK-ja në dosjen e Komisionit.

katror është në raportet 13.830 lekë/ m² deri në 20.782 lekë/ m², ndërkohë që vlera e kontratës së tij rezulton me një çmim reference rreth 15.935 lekë/ m². Pra, sipas tij, ai është trajtuar me një çmim mesatar¹² krahasuar me banorët e tjerë të të njëjtit pallat ku banon.

57. Për sa pretendohet nga subjekti, Komisioni vlerësoi se krahasimi nuk mund të bëhet në mënyrën që parashtrohet prej tij, në konsideratë të disa rrethanave si vijojnë: (i) ndikimi i kursit të këmbimit, i cili për periudhën 1998 – 2002 (nga kontrata e parë e administruar deri në kontratën e subjektit) ka pasur një luhajtje shumë të madhe nga viti në vit, por edhe brenda të njëjtit vit; (ii) faza në të cilën ndodhet ndërtimi i pallatit në momentin e porositjes a të shitjes, e cila ndikon në çmimin e shitjes; (iii) tendenca e rritjes së çmimeve të pasurive të patundshme në vite bën që çmimet të ndryshojnë (normalisht të rriten) me kalimin e kohës. Kështu, nga krahasimi i kontratave që disponohen, nën këndvështrimin e faktorëve të sipërcituar, rezulton se në katër kontrata shitjeje, çmimi me të cilin subjekti ka blerë të dyja pasuritë është i barabartë me çmimin e vetëm një pasurie, atij të apartamentit¹³. Për rrjedhojë, duket se subjekti, praktikisht, e ka përfituar garazhin me sip. 25 m², pa paguar një çmim blerjeje për të.

58. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

58.1. Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim të procesit u konstatua se subjekti është trajtuar në mënyrë preferenciale nga shoqëria sa i takon blerjes së garazhit. Përtej çdo dyshimi, duke qenë se nuk u evidentuan fakte dhe nuk u administruan prova që të vërtetonin se kjo ka ardhur për shkak të ushtrimit të detyrës si prokuror dhe në respektim të parimit të objektivitetit, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni çmoi se shitja e garazhit në të njëjtën kontratë me apartamentin dhe në të njëjtin çmim, është shprehje e vullnetit të lirë të palëve ashtu sikurse edhe administratori i shoqërisë ka deklaruar dhe nuk e çmoi këtë si shkak për penalizim të subjektit.

58.2. Për sa i takon mungesës së deklaramit të garazhit në deklaratën *Vetting*, Komisioni çmoi se ka pasaktësi. Pavarësisht faktit që ZVRPP-ja Tiranë konfirmoi se apartamenti me sip. 98 m² dhe garazhi me sip. 25 m² janë regjistruar në regjistrin hipotekor me të njëjtin numër rendor ***, datë 12.12.1997 dhe janë ndarë më vonë në dy pasuri më vete, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* pasuritë kanë pasur numra të ndryshëm: apartamenti ka pasur nr. pasurie *** dhe garazhi ka pasur nr. pasurie ***. Sipas shtojcës nr. 2 “Deklarata e pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin që të deklarojnë në deklaratën *Vetting* të gjitha pasuritë e akumuluar ndërsa vite deri në datën e dorëzimit dhe, për rrjedhojë, subjekti ka plotësuar në mënyrë të pasaktë deklaratën *Vetting* për shkak të mosdeklarimit të garazhit. Por, Komisioni nuk mund të vlerësojë që subjekti ka kryer fshehje pasurie për shkak të mosdeklarimit të garazhit, pasi mungon ana subjektive/qëllimi i mosdeklarimit për të fshehur pasurinë garazh, të cilin subjekti e ka deklaruar në DPFD-në e vitit 2003, si dhe ka dorëzuar në ILDKPKI kontratën e përfitimit të pronësisë mbi këtë pasuri. Për më tepër, pasuria është regjistruar në hipotekë menjëherë pasi është fituar pronësia, fakt i ditur botërisht dhe lehtësisht i verifikueshëm.

58.3. Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit si burim krijimi të pasurisë apartament banimi me sip. 98 m², blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., huan e marrë nga vëllai i tij

¹²Çmimi për metër katror i paguar nga subjekti ndodhet në intervalin midis çmimit minimal dhe maksimal për metër katror, të llogaritur nga subjekti, nga të gjitha kontratat e krahasuara.

¹³Shihni kontratat ku është paguar çmimi 1.960.000 lekë vetëm për blerjen e apartamentit me sip. 98 m², konkretisht: kontratë datë 8.2.2000 me blerës shtetasin S. Rr.; kontratë datë 9.3.2001, me blerës shtetasin K. M.; kontratë datë 3.6.2002, me blerës shtetasin Q. M.; kontratë datë 16.4.2003, me blerës shtetasin P. C..

P. H. në shumën 300.000 dhe as ka dhënë shpjegime lidhur me shlyerjen e saj, ndërkohë që kjo hua është deklaruar në deklaratën e vitit 2003. Subjekti, i pyetur gjatë hetimit administrativ mbi këtë mospërputhje, ka konfirmuar¹⁴ marrjen e një huaje në shumën 300.000 lekë nga vëllai i tij P. H. me qëllim blerjen e banesës në Tiranë, shumë e cila i është falur prej tij si dhuratë për shtëpinë e re, por nuk jepen sqarime përse kjo hua nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*. Duke qenë se kjo hua është deklaruar si burim në DPV-në për vitin 2003 dhe nga hetimi ka rezultuar se huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme¹⁵ për dhënien e huas, pasaktësia në deklaram nuk vlerësohet me ndonjë peshë specifike të posaçme.

58.4. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar për herë të parë si burim një ndihmë nga familja, por nuk ka deklaruar sa është vlera e ndihmesës. Subjekti, i pyetur gjatë hetimit administrativ, sqaroi se¹⁶ pas ndarjes nga trangu familjar, atij i është dhënë mbështetje nga prindërit e tij dhe vëllezërit P. dhe Gj. H., por është në pamundësi për ta përcaktuar këtë ndihmë në vlerë monetare. Më tej, subjekti ka sqaruar se: “... dhënia e një shume monetare nga familja për djalin që ndahej nga trangu dhe ndërtonte një familje të re, përbënte më së shumti një traditë për t’i ardhur në ndihmë sadopak çiftit të ri për ndërtimin e shtëpisë së tyre. Në këtë kuptim nuk mund të specifikoj dot se sa ka qenë vlera monetare e dhënë nga familja ime për të më ardhur në ndihmë për blerjen e shtëpisë, por di të them se në atë periudhë, prindërit e mi kanë shitur gjënë e gjallë që kishin në Tropojë, pasi kanë ardhur në Tiranë, ndërkohë që kanë përfituar edhe pension pleqërie nga ISSH-ja”. Duke qenë se nga hetimi nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të familjarëve¹⁷, për më tepër në kushtet kur subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë burim, në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhura si ndihmesë nga familjarët.

59. Në lidhje me burimet e deklaruara të krijimit të pasurisë, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi: (a) hua kumatit T. F. në vlerën 1.300.000 lekë, shlyer me këste gjatë viteve; (b) kursime nga pagat; (c) ndihmesë nga familja pas ndarjes nga trangu i babait, burime të cilat gjatë hetimit administrativ janë analizuar në mënyrë specifike si vijojnë:

60. Burimi i krijimit: hua kumatit në vlerën 1.300.000 lekë.

60.1. Në lidhje me këtë burim, nga deklaramet ndër vite konstatohet se: (i) në deklaratën e vitit 2003, në rubrikën “detyrime financiare” subjekti ka deklaruar hua për blerjen e banesës, marrë nga z. T. F. (vëllai i bashkëshortes, emigrant në Itali që prej 1995), në shumën 1.300.000 lekë; (ii) në deklaratën e vitit 2005, në rubrikën “të dhëna që nuk publikohen”, ka deklaruar se ka shlyer shumën 200.000 lekë kumatit T. F. dhe i mbeten edhe 1.100.000 lekë; (iii) në deklaratën e vitit 2006, në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar shumën prej 900.000 lekësh si detyrim i prapambetur për blerjen e banesës ku banon. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm prej 200.000 lekësh dhe gjendja e detyrimit të mbetur në shumën 900.000 lekë; (iv) në deklaratën e vitit 2007, në rubrikën detyrime financiare, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumën 900.000 lekë shtetasit T. F..

60.2. Edhe pse nuk ka një akt shkresor që të vërtetojë huan, subjekti ka qenë i saktë në deklaramet periodike në lidhje me këtë hua. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të shlyer huan sipas deklarameve të tij.

¹⁴Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

¹⁵Shihni arsyetimin në pikën 63 të vendimit.

¹⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

¹⁷Shihni arsyetimin në pikën 62 të vendimit.

60.3. Bazuar në pikën 4 të nenit 32, gjatë hetimit administrativ subjektit iu kërkua të provojë me dokumente burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit T. F., i cili sqaroi¹⁸ se ky shtetas është vëllai i bashkëshortes së tij dhe rezident në shtetin italian për më tepër se 25 vjet, duke fituar edhe nënshtetësinë italiane. Gjithashtu, ka paraqitur ekstraktin e sigurimeve shoqërore¹⁹ të z. T. F. të legalizuar me vulë apostile, si dhe kartën e tij të identitetit të lëshuar nga Komuna N., Itali.

60.4. Nga informacioni i administruar rezulton se: (i) personi tjetër i lidhur T. F. ka qenë i punësuar në shtetin italian ku janë paguar sigurimet shoqërore për periudhën 1.1.1998 – 31.12.2002; (ii) të ardhurat e ligjshme të gjeneruara nga punësimi i tij gjatë kësaj periudhe janë në shumën 62.950 euro, të cilat edhe pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës për një person në vlerën 28.380 euro²⁰ u konsideruan të mjaftueshme për dhënien e huas subjektit në vlerën 1.300.000 lekë/rreth 9.500 euro, për pagesën e një pjese të çmimit të apartamentit, në tetor të vitit 2002.

61. Burimi i krijimit: kursime nga pagat.

61.1 Gjatë hetimit administrativ janë verifikuar të ardhurat e deklaruara dhe të dokumentuara nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes në shumën 3.331.464 lekë, për periudhën nga viti 1994 deri në momentin e blerjes së pasurisë, datë 3.10.2002.

62. Burimi i krijimit: ndihmesë nga familja pas ndarjes nga trangu i babait.

62.1. Ky burim është deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting*, pa saktësuar vlerën konkrete të ndihmës. Në deklaratën e vitit 2003, subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim sipas detyrimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, ashtu sikurse ka deklaruar dy huat e marra nga personat e lidhur P. H. dhe T. F..

62.2. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti është pyetur për kontributin konkret të familjes, si dhe për vërtetimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave të familjarëve. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se pas ndarjes nga trangu familjar, atij i është dhënë mbështetje nga prindërit e tij dhe vëllezërit P. dhe Gj. H., pa saktësuar vlerën e secilit kontribut. Gjithashtu, subjekti paraqiti : (i) dokumente që vërtetojnë të ardhurat nga pensionet e prindërve deri në tetor të vitit 2002, në shumën 638.062 lekë, shumë nga e cila duket e vështirë që prindërit të kenë kryer shpenzimet minimale të jetesës për veten e tyre, si dhe të kenë kontribuar duke i dhuruar një pjesë subjektit për të blerë apartamentin me sip. 98 m² në Tiranë; (ii) dokumente për të ardhurat e vëllait P. H. për vitet 2001 dhe 2002, të cilat nuk mund të konsiderohen, pasi janë vlerësuar si burim për dhënien e huas në shumën 300.000 lekë, deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2003 (poshtëtrajtuar). Nuk janë paraqitur dokumente për të ardhurat e vëllait Gj. H..

62.3. Nga të dhënat e dokumenteve shkresore të paraqitura nga subjekti nuk u vërtetuan as masa e kontributit të familjes sipas pretendimit të subjektit dhe as të ardhura të mjaftueshme familjare për të kontribuar në blerjen e pasurisë nga subjekti. Për më tepër, në kushtet kur burimin “ndihmesë nga familja” subjekti e ka deklaruar vetëm në deklaratën *Vetting* dhe jo në deklaratën e vitit 2003, vit në të cilin ka kryer deklarime për burimet e tjera që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, në analizën financiare nuk është përfshirë si e ardhur ligjore asnjë ndihmesë nga trangu familjar.

¹⁸Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

¹⁹Dokumenti është i përkthyer, i noterizuar dhe me vulë apostile.

²⁰ Shihni EUROSTAT <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

63. Lidhur me huan prej 300.000 lekësh marrë nga vëllai P. H..

63.1. Përveç burimeve të mësipërme të deklaruara në deklaratën *Vetting*, në DPFĐ-në e vitit 2003, subjekti ka kryer deklarime në lidhje me huan në shumën 300.000 lekë, marrë nga vëllai P. H., burim i cili mungon të jetë deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në lidhje me këtë hua, subjekti ka deklaruar, ndër vite, si vijon: (i) në DPFĐ-në e vitit 2003, në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar: hua për blerjen e banesës, marrë nga P. H. në shumën 30.000 lekë; (ii) në DPV-në e vitit 2005, në rubrikën “të dhëna që nuk publikohen”, ka deklaruar se i ka shlyer vëllait P. H. shumën prej 100.000 lekësh dhe i mbetën edhe 200.000 lekë; (iii) në DPV-në e vitit 2006, në rubrikën “detyrime financiare”, subjekti ka deklaruar se detyrimin e prapambetur prej 200.000 lekësh ndaj vëllait të tij P. H., ky nuk e ka pranuar, duke ia falur.

63.2. Lidhur me mundësinë financiare të z. P. H. për dhënien e huas në shumën 300.000 lekë, nga verifikimi i dokumenteve shkresore të legalizuara me vulë apostile²¹ u konstatua se të ardhurat ligjore të dokumentuara të gjeneruara nga punësimi nga vëllai i subjektit P. H. në Itali për periudhën maj 2001 – 2002, kanë qenë në shumën 30.065 euro, të cilat edhe pasi zbritën shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë për një person në vlerën 8.840 euro²² u konsideruan se janë të mjaftueshme për dhënien e huas.

63.3. Për sa i takon mundësisë financiare të subjektit për t’i shlyer personit të lidhur P. H. shumën prej 100.000 lekësh në vitin 2005, nga analiza financiare e këtij viti rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj shume.

63.4. Për sa i takon konstatimit se subjekti nuk e ka deklaruar sipas ligjit në deklaratën *Vetting* huan në shumën 300.000 lekë si burim për blerjen e apartamentit me sip. 98 m² nga shoqëria “****” sh.p.k., në parashtrimet e datës 31.8.2020, z. Kolë Hysenaj sqaroi se huaja në shumën 300.000 lekë, marrë nga vëllai P. H. është deklaruar fillimisht në deklaratën fillestare të vitit 2003. Sipas tij, duke qenë se kjo hua ishte falur, në deklaratën *Vetting* e ka deklaruar si ndihmesë nga familja. Ky pretendim mbetet në nivel deklarativ pasi, referuar DPV për vitin 2005 subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumën 100.000 lekë, ndërsa në DPV-në e vitit 2006 ka deklaruar faljen e shumës 200.000 lekë. Në këto kushte, në analizën financiare të vitit 2005 është përfshirë si shpenzim vetëm shuma prej 100.000 lekësh, deklaruar si e shlyer gjatë këtij viti.

64. Analiza financiare për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 98 m² (në kontratën për blerjen e të cilit është përfshirë edhe garazhi me sip. 25 m²).

64.1. Pavarësisht faktit se në kontratën e porosisë, datë 5.2.1997, parashikohet çmimi prej 19.600 USD, gjatë analizës financiare, si shpenzim për blerjen e pasurisë është konsideruar shuma prej 1.960.000 lekësh përcaktuar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 3.10.2002, duke marrë në konsideratë pretendimin e subjektit se është përdorur kursi i këmbimit lekë/dollarë, në raportin 1:100²³.

64.2. Nga të dhënat e të dyja kontratave duket se çmimi i blerjes së pasurisë është paguar nga subjekti i rivlerësimit përpara vitit 2002 dhe, për këtë arsye, është kryer analizë financiare që nga viti 1994, kur Komisioni ka disponuar të dhëna për të ardhurat e bashkëshortëve Hysenaj,

²¹Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

²²Shihni EUROSTAT <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

²³Shpjeguar nga subjekti në përgjigjet e tij të datës 26.6.2020. I njëjti kurs këmbimi është përdorur edhe në kontratën e shitblerjes datë 8.2.2000, me blerës shtetasin S. Rr., kontratë me kushte të njëjta me të subjektit.

deri në vitin 2002, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese. Nga kjo analizë që është kryer pasi janë marrë në konsideratë: (i) të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe bashkëshortes, përfshirë dy huat, përkatësisht nga shtetasit T. F. dhe P. H., (ii) shpenzimet e jetesës për 4 persona dhe shpenzimet për blerjen së apartamentit me sip. prej 98 m², duket se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar çmimin e blerjes 1.960.000 lekë.

Përshkrimi	1994 - 2002
Pasuri	1 960 000
Apartament banimi me sip. 97 m ² +garazh	1 960 000
Detyrime	1 600 000
Hua nga vëllai P. H.	300 000
Hua nga kunati T. F.	1 300 000
Pasuri neto	360 000
Të ardhura	3 331 464
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	2 991 194
Të ardhura nga paga bashkëshortja	340 270
Shpenzime	2 910 912
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	2 910 912
Mundësia për kursime	60 552

64.3. Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar²⁴ edhe të ardhura të bashkëshortes nga punësimi pranë shoqërisë “***” sh.a., sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 21.10.2016, për periudhën e punësimit tetor 1998 – dhjetor 2002, të administruar edhe nga ILDKPKI-ja²⁵. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këto të ardhura, u konstatua se: (i) në DPV-në e vitit 2003, subjekti nuk ka deklaruar kursime të përfituara nga të ardhurat e bashkëshortes; (ii) nuk është vërtetuar të jenë paguar detyrimet tatimore e sigurime shoqërore, me qëllim legjitimimin e këtyre të ardhurave.

64.4. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe dokumente shkresore, në lidhje me këto konstatime. Në parashtrimet e datës 31.8.2020, subjekti deklaroi se pa të drejtë të ardhurat e bashkëshortes para vitit 2003 nga punësimi pranë shoqërisë “***” sh.a., nuk i janë përfshirë në analizën financiare, si dhe ka paraqitur disa dokumente shkresore, sipas të cilave pagat *bruto* të bashkëshortes së subjektit për periudhën 1998 – 2003, arrijnë vlerën në total 1.601.393 lekë.

64.5. Për sa i takon mosdeklarimit të kursimeve nga pagat e bashkëshortes në deklaratën e vitit 2003, sipas ligjit nr. 9049/2003, subjekti nuk ka dhënë sqarime. Pavarësisht mosdeklarimit të kursimeve në këtë deklaratë, Komisioni nuk mohon faktin që këto të ardhura mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë në vitin 2002. Me përfshirjen e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes pranë shoqërisë “***” sh. a. në analizën kumulative financiare përfundimtare të periudhës 1994 – 2002, balanca pozitive bëhet nga 60.552 lekë në 1.321.675 lekë, e cila, në fakt, është një mundësi kursimi hipotetike dhe jo gjendje *cash* në fund të vitit.

²⁴Shihni përgjigjet e pyetësorit të datës 26.6.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁵Shihni aneksin 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

64.6. Bazuar në të gjitha sa më sipër, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë pasurinë apartament banimi me sip. 98 m², këmbyer me apartamentin me sip. 120 m².

Pasuri “tokë arë” me sip. 2000 m², B., Tiranë

65. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar: *pasuri e paluajtshme “tokë arë” me sip. 2000 m², pasuria nr. ***, B., Tiranë. Vlera: 11.160.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerje nr. ***, datë 16.9.2011. Burimi i krijimit: (a) kursime nga pagat gjatë viteve; (b) kredi e marrë në “Raiffeisen Bank”; (c) të ardhura nga biznesi.*

65.1. Konstatime të ILDKPKI-së për këtë pasuri:

- Deklarim i pamjaftueshëm nga subjekti për shumat e përdorura për blerjen e tokës në B., Tiranë, në vitin 2011, në shumën 11.160.000 lekë, si dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare, duke pasur parasysh se subjekti nuk ka deklaruar kursime, ndër vite, për të plotësuar diferencën e çmimit për këtë blerje, përveç kredisë.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

66. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, ASHK Tirana Veri²⁶ konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasit Kolë N. Hysenaj pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “arë” me sip. 2000 m² (pasuri aktive). Gjatë hetimit administrativ u kërkua informacion nëse mbi këtë tokë ka ndërtime, nga ku nuk rezultoi që mbi këtë pasuri të jetë ndërtuar ndonjë objekt informal, vërtetuar me ortofoto të viteve 2007 dhe 2018²⁷.

67. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes së pasurisë, nga aktet në dosje²⁸ rezulton se:

67.1. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 18.5.2007, pasuria e llojit “arë” me sip. 2000 m², nr. ***, në B., është e regjistruar në pronësi të shtetasit B. V. M., të cilën ai e kishte blerë nga shtetasi F. B. me kontratë shitblerjeje në çmimin 10.000 lekë.

67.2. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.9.2011, subjekti Kolë Hysenaj ka blerë nga shtetasit B. dhe D. M., pasurinë me nr. ***, në vlerën 11.160.000 lekë, likuiduar nga palët. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në e vitit 2011 me burime të njëjta me ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*. Sa i takon mënyrës së likuidimit të çmimit të shitjes, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se çmimi është likuiduar *cash* në favor të shitësit B. M., sipas kërkesës së tij, si dhe ka paraqitur deklaratë noteriale të këtij shtetasi, e cila konfirmon deklarin e subjektit.

67.3 Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 26.9.2011, rezulton e regjistruar në emër të z. Kolë Hysenaj pasuria nr. ***, e llojit “arë” me sip. 2000 m², në B., Tiranë.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie.

68. Sa i takon çmimit të blerjes së kësaj pasurie, sipas VKM-së nr. 139, datë 13.2.2008, “Për miratimin e çmimit të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës”, në Bërxullë, çmimi për 1 m² truall ka qenë në vlerë 2.462 lekë/m² dhe vlera e tokës arë prej 2.000 m² do të ishte në vlerën 4.924.000 lekë. Me

²⁶Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2019, nga ASHK Tirana Veri, në dosjen e Komisionit.

²⁷Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 24.6.2020, nga ASHK në dosjen e Komisionit.

²⁸Shihni aktet në aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

njoftimin e rezultateve të hetimit subjektivit iu kërkuar sqarime mbi blerjen e kësaj pasurie me një çmim disa herë më të lartë se çmimi i referencës dhe se ai i blerjes nga ana e shitësit disa vite më parë. Subjekti, në parashtrimet e datës 31.8.2020, ka deklaruar se kjo pasuri është blerë në kushtet e një lirie të plotë vullneti mes palëve, duke menduar se kjo pasuri me kalimin e kohës do të kishte një vlerë në rritje. Sipas tij, çmimet e referencës kanë si qëllim vendosjen e një çmimi dysheme për vlerën minimale të pasurive të ndodhura në një zonë të caktuar, por nuk kushtëzojnë dhe as derivojnë ligjshmërinë e shitblerjes.

69. Në lidhje me burimin e krijimit, nga Komisioni, janë analizuar specifikisht burimet e deklaruara si vijojnë:

69.1. Burimi i krijimit: kursime nga pagat gjatë viteve. Në analizën financiare janë konsideruar të ligjshme të ardhurat e dokumentuara dhe të deklaruara nga pagat e bashkëshortëve Hysenaj, që nga data 1.1.2011 deri në momentin e blerjes së pasurisë në shumën 1.618.247 lekë. Sa i takon kursimeve nga pagat gjatë viteve, nga verifikimi i deklarimeve të subjektivit rezultoi se deri në vitin 2011 kur është blerë pasuria, nuk janë deklaruar likuiditete *cash* ose në bankë me burim kursime nga pagat.

69.2. Burimi i krijimit: kredi e marrë në “Raiffeisen Bank”²⁹. Në lidhje me këtë kredi, u verifikua se:

- Me kontratë kredie bankare dhe hipotekore nr. ***, datë 28.7.2011³⁰, bashkëshortët Kolë dhe D. Hysenaj kanë marrë në “Raiffeisen Bank” kredi në shumën 5.000.000 lekë për përdorim konsumator me hipotekë, me afat 180 muaj.

- Për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj bankës është vënë si garanci hipotekore apartament banimi me sip. 120 m², nr. pasurie ***, ndodhur në bulevardin “B. C.”,³¹ Tiranë, në pronësi të subjektivit të rivlerësimit.

- Pasi është disbursuar kredia në datën 29.7.2011, subjekti ka tërhequr *cash* në po këtë datë shumën prej 4.913.400 lekësh. Edhe pse kjo shumë nuk u vërtetua të ketë kaluar në rrugë bankare në emër të shitësit B. M., Komisioni iu referua deklaramentit për vitin 2011 dhe deklaratës *Vetting*, ku subjekti e ka deklaruar kredinë si burim. Për këtë arsye, kjo kredi prej 5.000.000 lekësh u përfshi në analizën financiare si e ardhur e ligjshme për blerjen e pasurisë.

69.3. Burimi: të ardhura nga biznesi. Nga verifikimet e kryera³² u konstatua se të ardhurat e dokumentuara nga aktiviteti privat bar-kafe “***”, për të cilat ishin paguar detyrimet tatimore nga data 1.1.2011 deri në momentin e blerjes së pasurisë tokë në B., datë 16.9.2011, kanë qenë në shumën 312.708 lekë, shumë e cila është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare. Vlen të theksohet se deri në vitin 2010, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* nga të ardhurat me burim pagat apo biznesin³³.

69.4. Përveç tre burimeve të deklaruara si më sipër, gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka pretenduar se si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në B.

²⁹Në DPV-në për vitin 2011, ndonëse ka një paqartësi, e cila duket të jetë pakujdesi në momentin e plotësimit dhe printimit të deklaratës.

³⁰Shihni dokumentin në aneksin 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së.

³¹ Në kryqëzimin me rrugën “M. Gj.”.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

³³Analiza e detajuar e të ardhurave nga biznesi është trajtuar hollësisht në këtë vendim në rubrikën “Të ardhurat nga bar-kafe ‘***’”.

Tiranë, kanë shërbyer edhe të ardhurat nga shitja një vit më herët (viti 2010) të automjetit tip “Mercedes-Benz”, përmes kontratës nr. ***, datë 19.7.2010, në çmimin 22.000 euro. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se kjo shumë nuk mund të konsiderohet si burim për blerjen e kësaj pasurie, pasi: (i) këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në DPV-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting*; (ii) shuma prej 22.000 euro përfituar nga shitja e automjetit më 19.7.2010, është deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen e një automjeti tjetër të blerë në vitin 2015; (iii) pavarësisht se subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit në DPV-në e vitit 2010, shuma e përfituar nga shitjes 22.000 euro nuk është deklaruar nga subjekti si likuiditet *cash* në fund të vitit 2010; (iv) për të ardhurën në vlerën 22.000 euro nuk ishte paguar në kohë reale tatimi mbi të ardhurat nga shitja³⁴. Për këto arsye, shuma prej 22.000 euro nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të kryer për blerjen e pasurisë truell në B., përmbledhur në tabelën vijuese, e cila tregon pamundësinë financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie në datën 16.9.2011.

Analiza financiare deri më 16.9.2011	
Pasuri	11 154 417
Tokë sip. 2.000 m ² B., Tiranë	11 270 000
Shtesa/pakësime/likuiditete	-115 583
Detyrime	4 946 229
Kredi 5.000.000 lekë në “Raiffeisen Bank”	5 000 000
Shlyerje kredie në “Raiffeisen Bank”	-53 771
Të ardhura	1 618 247
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit ³⁵	889 063
Të ardhura nga paga bashkëshortja ³⁶	416 476
Të ardhura nga biznesi i bashkëshortes “bar-kafe”	312 708
Shpenzime	515 713
Shpenzime jetese sipas standardit të ILDKPKI-së	432 630
Shpenzime udhëtimesh	83 083
Mundësia për kursime	-5 105 654

69.5. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e truallit në B., Tiranë për shkak të balancës negative prej 5.105.654 lekësh.

70. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

70.1. Në parashtrimet e datës 31.8.2020, subjekti ka kundërshtuar këtë balancë negative duke pretenduar se pa të drejtë nga Komisioni nuk janë marrë në konsideratë kursimet e disa viteve të mëparshme të rezultuara me balanca pozitive dhe ka paraqitur një analizë financiare të re me balancë pozitive, në të cilën këto kursime janë konsideruar të ardhura të ligjshme. Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi në asnjë prej deklaratave periodike vjetore përpara vitit 2011,

³⁴Në lidhje me këtë automjet dhe të ardhurat e përfituara prej tij, është kryer analizë e detajuar në pikën 81 të vendimit.

³⁵Sipas të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ nga “Raiffeisen Bank”.

³⁶Sipas të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ nga “ProCredit Bank”.

kur është blerë pasuria, z. Kolë Hysenaj nuk ka deklaruar kursime si gjendje likuiditeti *cash* ose në bankë, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Është e vërtetë që përgjatë disa viteve subjekti ka rezultuar me balanca pozitive, por, ka pasur detyrimin që në fund të çdo viti të deklaronte kursimet *cash* të pashpenzuara ose ndryshimet e tyre. Deklaratat periodike vjetore do të shërbenin si provë që do të vërtetonin faktin se subjekti ka pasur kursime në fund të çdo viti dhe vlerën e tyre³⁷.

70.2. Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë tokë në Bërxullë, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Pasuria automjet tip “Peugeot”, me targa ***

71. Në deklaraten *Vetting* kjo pasuri është deklaruar: *Automjet tip “Peugeot”, me targa **** (***) duket se është harruar). *Vlera: 14.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerjeje nr. *** rep., datë 1.7.2013; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 30.1.2014; kontratë shitjeje nr. *** , datë 29.4.2014. Burimi i krijimit: (a) kursime familjare të pagës; dhe (b) të ardhura biznesi. Blerja e fundit e paguar me këste mujore.*

Në lidhje me këtë pasuri ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

Hetimi i Komisionit në lidhje këtë pasuri

72. Në lidhje me mënyrën e përfitimit të pronësisë, në rend kronologjik nga aktet³⁸ në dosje, rezultoi se:

72.1. Me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 1.7.2013, automjeti tip “Peugeot” me targa ***, nr. shasie ***, i është shitur shtetasve D. dhe D. H. (fëmijët e subjektit) nga shoqëria “****” sh.p.k., me çmimin 10.000 euro, i cili sipas kontratës do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate. Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i të dhënave bankare, vërehet se nuk është bërë likuidimi i kësaj shume në rrugë bankare. Ky automjet është deklaruar nga djali i subjektit në DPV-në e vitit 2013, por pa u deklaruar burimi i krijimit.

72.2. Me kontratën nr.***, datë 30.1.2014, shtetasit D. dhe D. H. kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. automjetin tip “Peugeot” me nr. shasie ***, me targa *** (mjete objekt shqyrtimi) me

³⁷Gjendja e likuiditeteve *cash* është trajtuar hollësisht në rubrikën “Analizë e gjendjes *cash* dhe vlerësimi i Komisionit” të këtij vendimi.

³⁸Shihni aktet në aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së; dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit; dokumentet bashkëngjitur shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.4.2019, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.6.2020, nga “****” sh.p.k. në dosjen e Komisionit, sipas së cilës sa i takon mënyrës së likuidimit çmimit të shitjes sipas kontratave nr. ***, datë 1.7.2013 dhe nr. ***, datë 30.1.2014, informohet se nuk disponohen mandatpagesat për shkak të faktit se detyrimi i subjektit tregtar për t’i mbajtur këto dokumente përfundon me kalimin e afatit 5-vjeçar, duke nisur nga fundi i vitit tatimor të cilit i përkasin, ndërkohë që këto kontrata pas nënshkrimit të tyre janë deklaruar dhe bërë pjesë e bilancit dhe inventarit të shoqërisë duke u deklaruar rregullisht edhe pranë organeve tatimore.

çmim 14.000 euro, shlyer sipas mënyrës së pagesës së përcaktuar në këtë mënyrë: “8.500 euro vlerësohet automjeti tip ‘Peugeot’, me nr. shasie ***, (automjeti i sipërpërmendur) i cili do t’i shitet sërish shoqërisë ‘***’ sh.p.k.. Diferenca prej 5.500 euro do të paguhet si vijon: 1.000 euro me firmosjen e kontratës dhe çdo muaj do të paguajë 1.000 euro deri në pagesën e plotë, duke nisur nga muaji mars 2014”. Në deklarinimin e vitit 2014 subjekti dhe djali i tij kanë deklaruar blerjen e këtij automjeti, si dhe është deklaruar në mënyrë të detajuar pagesa e çmimit prej 14.000 euro, deklarime që përputhen me deklaratën *Vetting* dhe me deklarinimet gjatë procesit të rivlerësimit.

72.3. Me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 29.4.2014, vërtetohet rishitja e automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, shoqërisë “***” sh.p.k., nga shtetasit D. dhe D. H., me çmimin 8.500 euro, i likuiduar jashtë zyrës noteriale, duke u përmbushur përcaktimi sipas kontratës së sipërpërmendur. Kjo mënyrë likuidimi është vërtetuar edhe nga shoqëria “***” sh.p.k.

72.4. Automjeti tip “Peugeot”, me targa ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 30.1.2014, nga shoqëria “***” sh.p.k. është i regjistruar në DPSHTRR, në emër të shtetasve D. dhe D. H..

73. Në lidhje me burimin e krijimit. Bazuar në deklarinimet e subjektit, pasi janë verifikuar kursimet me të ardhurat e dokumentuara nga pagat dhe aktiviteti tregtar bar-kafe “***”, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, nga Komisioni është kryer analiza financiare e ndarë si vijon:

73.1. Së pari, për të verifikuar mundësinë e krijimit me të ardhura të ligjshme të shumës 10.000 euro me të cilën është blerë automjeti me targa ***, me kontratë të datës 1.7.2013 (automjet që iu rishit shoqërisë “***” sh.p.k. në shumën 8.500 euro me kontratë të datës 29.4.2014), është kryer analiza financiare e përmbledhur në tabelën vijuese, ku duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për të paguar shumën 10.000 euro, në datën 1.7.2013, për shkak të një balance negative prej 911.862 lekësh.

Përshkrimi	1.1.2013 – 1.7.2013
Pasuri	1 418 253
Blerë automjet me targa ***, shuma 10.000 euro	1 410 000
Shtesa/pakësime/likuiditete	8 253
Të ardhura	1 164 500
Të ardhura nga paga subjekti	529 408
Të ardhura nga paga bashkëshortja	545 092
Të ardhura nga biznesi “bar-kafe” bashkëshortja	90 000
Shpenzime	658 109
Paguar kredia 5.000.000 lekë “Raiffeisen Bank”	316 023
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së për 4 persona	282 048
Shpenzime udhëtimesh	60 038
Mundësia për kursime	-911 862

73.2. Së dyti, për të verifikuar burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit të deklaruar në deklaratën *Vetting*, blerë me kontratën e blerjes nr. ***, datë 30.1.2014, në shumën 14.000 euro, vërehet se:

i) shuma 8.500 euro u përfitua nga rishitja e automjetit me targa *** shoqërisë “***” sh.p.k., sipas kontratës nr. ***, datë 29.4.2014, ku çmimi i shitjes është më i ulët se çmimi i blerjes (10.000 euro);

ii) sa i takon burimit të ligjshëm të shumës prej 5.500 euro, paguar me këste gjatë vitit 2014, sipas deklarimeve të subjektit dhe parashikimit të kontratës nr. ***, datë 30.1.2014, është kryer analizë financiare e përmbledhur në tabelën vijuese, ku duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për ta paguar shumën e mbetur prej 5.500 euro deri më 30.6.2014, kur është paguar kësti i fundit për blerjen e automjetit, për shkak të një balance negative prej 905.741 lekësh.

Përshkrimi	1.1.2014 – 30.6.2014
Pasuri	1 751 375
Këste 5.500 euro për blerje automjeti tip “Peugeot”	770 605
Automjet tip “Mercedes-Benz” me targa ***, blerë 7.000 euro ³⁹	980 770
Të ardhura	1 596 330
Të ardhura nga paga subjekti	630 183
Të ardhura nga paga bashkëshortja	734 732
Të ardhura nga biznesi bar-kafe/bashkëshortja	231 415
Shpenzime	750 696
Pagesa për kreditë 5.000.000 lekë në “Raiffeisen Bank”	296 689
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	439 996
Shpenzime udhëtimesh	14 011
Mundësia për kursime	-905 741

73.3. Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me konstatimet, duket se: (i) subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2013 burimin për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, me kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 1.7.2013, në çmimin 10.000 euro; (ii) subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, në çmimin 10.000, në datën 1.7.2013, për shkak të balancës negative prej 911.862 lekësh; (iii) subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e automjetit me targa ***, deklaruar në deklaratën *Vetting*, blerë në çmimin 14.000 euro, sipas kontratës nr. ***, datë 30.1.2014, për shkak të balancës negative prej 905.741 lekësh.

74. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

74.1. Në parashtrime, subjekti ka pranuar që në DPV-në e vitit 2013 nuk ka cituar shprehimisht burimin e krijimit të automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, por kjo sipas tij, nuk përbën mosdeklarim pasurie në kushtet që ai ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë. Në fakt, Komisioni nuk ka evidentuar mosdeklarim pasurie, por mospërmbushje të detyrimit ligjor për deklarimin e burimit të pasurisë sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, pasaktësi e cila merr vlerë të posaçme, në kushtet kur nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i të ardhurave për blerjen e pasurisë.

³⁹Automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, është blerë nga shtetasi D. M., sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 5.2.2014, në shumën 7.000 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

74.2. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, nga shoqëria “***” sh.p.k., në shumën 10.000 euro, me kontratë të datës 1.7.2013, subjekti ka deklaruar se ky është një konstatim i pasaktë, pasi Komisioni ka referuar të ardhurat nga paga dhe biznesi, por nuk ka përlllogaritur të ardhurat e fituara nga likuidimi i kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të ndodhur në F., Tiranë. Përkundër sa pretendohet nga subjekti, konstatohet se jo vetëm që nuk ka deklaruar ndonjëherë si burim për blerjen këtij automjeti të ardhurat e fituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në F., Tiranë, por të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, në deklaratën *Vetting*, i ka deklaruar tërësisht si burim për blerjen e dy pasurive të paluajtshme në Korçë.

74.3. Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit me targa ***, në çmimin 14.000 euro, në datën 30.1.2014, subjekti ka deklaruar se ky është një konstatim i pasaktë dhe ka sqaruar se ky automjet i blerë në vitin 2014, në vlerën 14.000 euro është financuar në këtë mënyrë: “... shuma prej 8.500 euro është vlerësimi (dhe më pas shitja) i automjetit ekzistues dhe pjesa e mbetur është likuiduar periodikisht përgjatë vitit 2014, deri në likuidimin e plotë të këtij çmimi”. Për këtë arsye, sipas tij, analiza duhet të fokusohet në mundësinë financiare të pagesës së vlerës prej 5.500 euro, deri në datën 30.6.2014. Në fakt, subjekti është i paqartë në pretendimet e tij, pasi, analiza financiare për pagimin e shumës 14.000 euro është kryer pikërisht si në mënyrën e pretenduar nga subjekti: (i) shuma 8.500 euro është konsideruar si e ardhur e ligjshme nga rishitja e automjetit të shoqëria “***” sh.p.k.; dhe (ii) sa i takon pjesës së mbetur prej 5.500 euro është kryer analizë për të verifikuar mundësinë financiare për pagimin e saj deri në datën 30.6.2014, sipas deklarimeve të subjektit. Por, duke qenë se më 5.2.2014, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 5.2.2014, subjekti ka blerë nga shtetasi D. M. në shumën 7.000 euro automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, kjo shumë është përfshirë si shpenzim në analizën financiare të kryer deri më 30.6.2014, e cila ka afektuar rezultatin përfundimtar të analizës financiare.

74.4. Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni çmoi se: (i) ka kryer deklaram të pasaktë në DPV-në e vitit 2013, pasi nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targa ***, në shumën 10.000 euro gjatë këtij viti, për blerjen e të cilit nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme; (ii) nuk justifikon me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit me targa *** në vitin 2014, në çmimin 14.000 euro,

Pasuria automjet tip “Smart”, me targa ***

75. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar: *Automjet tip “Smart”, me targa *** Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë blerje nr. *** rep., datë 12.2.2015; kontratë shkëmbimi nr. *** rep., datë 7.10.2016. Burimi i krijimit: shitja e automjetit ekzistues të blerë në vitin 2008, ndërsa kontrata e dytë është nga shkëmbimi mes automjeteve.*

Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Deklarim i dyshimtë për të ardhurat në shumën 22.000 euro, të përfituara nga shitja e automjetit në vitin 2010, blerë në vlerën 500.000 lekë në vitin 2008, çka e bën deklaramin të rremë.

- Të ardhurat në shumën 22.000 euro të përfituara nga shitja e automjetit në vitin 2010 nuk janë deklaruar nga subjekti si gjendje *cash*, duke filluar nga ky vit.

- Sa i përket shkëmbimit, është marrëveshje e palëve lidhur me përfitimet e tyre respektive.

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri

76. Në lidhje me mënyrën e krijimit të kësaj pasurie dhe deklarimin në deklaratat periodike vjetore dhe *Vetting*, nga aktet në dosje ⁴⁰ në rend kronologjik rezultoi e vërtetuar se:

76.1. Me kontratën nr. ***, datë 12.2.2015, djali i subjektit D. H. ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2004, me targa ***, me nr. shasje ***, me çmim 15.000 euro, nga shtetasi B. C., likuiduar plotësisht në momentin e nënshkrimit të kontratës jashtë zyrës noteriale. Nuk vërtetohet që çmimi i shitjes të ketë kaluar në rrugë bankare në emër të shitësit. Kjo kontratë është deklaruar në DPV-në e vitit 2015, por pa deklaruar burimin e krijimit sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

76.2. Me kontratën nr. ***, datë 7.10.2016, shtetasit Kolë dhe D. Hysenaj shkëmbejnë automjetin e sipërpërmendur tip “Mercedes-Benz”, me targa ***(ndryshuar targa), nr. shasje ***, me automjetin tip “Smart Coupe”, me targa ***, vit prodhimi 2008, në pronësi të shtetasit F. S., i cili e ka blerë këtë automjet në shumën 800 euro nga shtetasi S. R., më 23.5.2016. Automjeti tip “Smart” është deklaruar nga subjekti në deklarimin e vitit 2016, si automjet i përfituar sipas kontratës së shkëmbimit nr. *** rep., datë 7.10.2016, me automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë nga subjekti në vitin 2015, në vlerën 15.000 euro.

76.3. DPSHTRR-ja⁴¹ nuk ka identifikuar të regjistruar në emër të subjektit apo fëmijëve të tij automjetin me targa ***, sipas deklarimit të subjektit, por konfirmon automjetin e llojit “Smart Coupe”, me targa ***, në emër të djalit të subjektit, i cili rezulton të jetë i njëjti automjet, pasi i janë ndërruar targat.

76.4. Pasi është konstatuar se janë këmbyer dy automjete të blera me çmime shumë të ndryshme, me diferencë rreth 1 vit e gjysmë nga njeri-tjetri, është pyetur subjekti, i cili në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 ka deklaruar se shkëmbimi i automjeteve ka ndodhur në kushtet dhe gjendjen teknike që kishin në periudhën e shkëmbimit dhe transaksioni është kryer me vullnet dhe dëshirë të plotë të palëve. Më tej, subjekti ka deklaruar se: *“Mbi çmimin e automjeteve në momentin e shkëmbimit të tyre, nuk mund të bëj dot vlerësime, por di të sqaroj se gjatë përdorimit prej më tepër se një vit e gjysmë, automjeti tip ‘Mercedes-Benz’ i përdorur nga djali im, pjesën më të madhe të kohës e ka kaluar në servis për shkak të defekteve të sjella, ndërsa automjeti tip ‘Smart’, vijon ende të jetë në përdorimin tonë familjar”*. Por, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar këto pretendime. Ndërsa, kontrata e shkëmbimit të automjeteve nuk parashikon asnjë fakt në lidhje me gjendjen teknike të automjeteve dhe shkaqet e këmbimit të dy pasurive me vlera të ndryshme.

76.5. Në lidhje me marrëdhënien e tij me shtetasin F. S., subjekti ka sqaruar se nuk ka njohje personale, por është i njohur i djalit të tij, duke deklaruar se këtë person nuk e ka pasur asnjëherë në ndjekje penale (pavarësisht statusit), fakt i vërtetuar nga Prokuroritë⁴² pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Korçë, të cilat nuk konfirmuan kallëzime apo procedime penale të

⁴⁰Shihni aktet në aneksin 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së dhe DPV-të për vitet 2015 dhe 2016.

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.4.2019, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni shkresat kthim përgjigje: nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

trajtuara nga prokurori Kolë Hysenaj gjatë kohës që ka ushtruar funksionin në prokurorinë përkatëse dhe as procedime penale të regjistruara⁴³ në emër të këtij shtetasi.

76.6. Në përfundim të hetimit administrativ, duke qenë se rrethanat e shkëmbimit të dy automjeteve kanë qenë të paqarta, pa asnjë kusht dhe pa kundërshtim, midis shtetasit F. S., i cili në këmbim të një automjeti të blerë prej tij në shumën 800 euro, mori automjetin e blerë nga subjekti në shumën 15.000 euro. Pra, dukshëm në vlerë të konsiderueshme të pabarabartë dhe me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka dhënë sqarime të mëtejshme për sa i është kërkuar.

77. Në lidhje me burimin e krijimit⁴⁴ të automjetit tip “Smart”

Në deklaratën *Vetting* vërehet se si vlerë të automjetit tip “Smart”, me targa ***, subjekti ka deklaruar 15.000 euro, e cila në fakt ka qenë vlera e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2015, i cili ishte këmbyer me automjetin tip “Smart”. Edhe sa i takon burimit të krijimit, subjekti i është referuar burimit që ka shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2015, duke përcaktuar konkretisht të ardhura nga shitja e automjetit ekzistues, të blerë në vitin 2008 (shitur në vlerën 22.000 euro, në vitin 2010), burim i cili për herë të parë deklarohet në deklaratën *Vetting*.

78. Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka kryer hetime në lidhje me automjetin e blerë në vitin 2008, në çmimin 500.000 lekë dhe shitur në vitin 2010, në çmimin 22.000 euro. Bazuar në aktet e administruara nga ILDKPKI-ja⁴⁵ dhe në deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, është konstatuar se:

78.1. Në datën 7.7.2008, shtetasi K. D. I. ka blerë në Gjermani automjetin tip “Mercedes-Benz ***”, vit prodhimi 2007, në çmimin 21.000 euro dhe, në datën 11.7.2008, pasi ka kryer procedurat për zhdoganimin e automjetit në pikën doganore Durrës, ka paguar detyrimet doganore në shumën 516.393⁴⁶ lekë, duke vijuar me targimin me targa ***.

78.2. Në datën 14.7.2008, me kontratën nr. ***, shtetasi K. I. ia ka shitur subjektit automjetin e sipërpërmendur në shumën 500.000 lekë, të cilin subjekti e ka deklaruar në deklaratën e vitin 2008, por pa deklaruar burimin e krijimit, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

78.3. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti është pyetur për shkakun e blerjes së automjetit në shumën 500.000 lekë nga shtetasi K. I., ndërkohë që automjeti ishte blerë në shumën 22.000 euro një javë para shitjes, si dhe për marrëdhëniet me këtë shtetas. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti nuk ka dhënë një shpjegim bindës dhe konkret në lidhje me shkakun e blerjes së automjetit në shumën 500.000 lekë duke deklaruar se shtetasi K. I. është i afërmi i tij dhe në momentin e blerjes së automjetit, ai ka qenë i karamboluar dhe në periudha vijuese ka kryer rregullime të pjesëve të ndryshme të tij. Sipas tij, shtetasi K. I. kërkonte ta shiste automjetin pasi do të shkonte të jetonte për disa kohë jashtë Shqipërisë. Subjekti ka vënë në dispozicion, gjithashtu, deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.2.2020, të shtetasit K. I., sipas së cilës konfirmohen deklaratimet e subjektit dhe se shitblerja e automjetit është kryer me vullnet të lirë dhe të plotë. Nga ana tjetër, këto deklarime të subjektit dhe shtetasit K. I. bien në kundërshtim

⁴³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.5.2020, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁵Shihni aktet në aneksin 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁶Shihni kontratën e shitjes, faturë shitje dhe deklaratë zhdoganimi në aneksin 2 bashkëngjitur shkresës së DPSHTRR-së.

me kontratën e shitblerjes së automjetit datë 14.7.2008, në të cilën deklarohet se shitësi e gëzon automjetin në gjendje të rregullt teknike, po kështu edhe me dokumentin e titulluar “Certifikata e kontrollit fizik të automjetit” në dosjen e DPSHTRR-së, datë 14.7.2008, e cila përcakton se “nuk janë konstatuar problematika”.

Lidhur me një konflikt të mundshëm interesi me shtetasin K. I., nuk rezultuan kallëzime apo procedime penale të regjistruara dhe të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me këtë shtetas⁴⁷.

78.4. Në datën 19.7.2010, me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, subjekti e ka shitur automjetin me targa ***, në shumën 22.000 euro te blerësi G. H., e cila i është dorëzuar *cash* subjektit të rivlerësimit. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti e ka deklaruar shitjen e automjetit, por nuk ka deklaruar shumën e përfituar nga shitja prej 22.000 euro si gjendje likuiditeti *cash* apo në bankë. Në lidhje me shitjen e automjetit disa herë më shtrenjtë se çmimi i blerjes brenda një periudhe 2-vjeçare, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se në momentin e blerjes ai kishte qenë i karamboluar, kështu që në periudhat vijuese kishte kryer rregullime të pjesëve të ndryshme të tij, çka nënkuptonte shpenzime të kryera për riparimin, ndërkohë që subjekti nuk ka deklaruar asnjë shpenzim apo investim për riparimin e automjetit.

78.5. Lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në shumën 22.000 euro, DRT-ja⁴⁸ ka vënë në dispozicion deklaratën individuale të vitit 2011, ku në rubrikën “Të ardhura bruto të tjera të pa përmendura më lart” është deklaruar shuma prej 2.505.420 lekë që korrespondon me vlerën e shitjes së automjetit dhe, gjithashtu, në këtë deklaratë është deklaruar tatimi në shumën 250.542 lekë. Kjo deklaratë e vitit 2011 është depozituar dhe plotësuar prej subjektit në datën 19.6.2019 dhe pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga shitja është bërë në këtë datë, pra, pas depozitimit të deklaratës *Vetting*.

78.6. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se në referencë të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.4.2018, dërguar nga zyra e tatimeve me kërkesë të Komisionit, detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit i përket përfituesit të të ardhurave nga shitja (pra, subjektit) dhe shlyerja e detyrimit mund të kryhej nëpërmjet deklarimit të tatimet ose pas plotësimit të DIVA-s. Konkretisht, subjekti ka pasur detyrimin e pagimit të tatimit deri në datën 20 të muajit pasardhës nga momenti i përfitimit të të ardhurave nga shitja (datë 19.7.2020), pra brenda datës 20.8.2010, ose shlyerja e këtij detyrimi mund të kryhej në momentin e plotësimit/menjëherë pas plotësimit të DIVA-s të vitit kur janë përfituar të ardhurat, në këtë rast deri më 30.4.2011. Nuk rezulton që subjekti të ketë paguar tatimin mbi të ardhurat nga shitja e automjetit brenda afateve sipas detyrimit ligjor, në asnjë prej varianteve të sipërpërmendura. Pra, duket se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor në kohë reale për pagimin e tatimit mbi shitjen.

78.7. Veç sa më sipër, në procesverbalin e pyetjes nga ILDKPKI-ja, në lidhje me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga transaksioni, subjekti është përgjigjur: “... në vitin kur është bërë shitblerja e automjetit datë 19.7.2010, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ... nuk ishte

⁴⁷Shihni shkresat: kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe nr. *** prot., datë 17.4.2020, nga SPAK-u, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.2.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në dosjen e Komisionit.

detyrim ligjor deklarimi i të ardhurave për vitin 2010, dhe vetëm me ndryshimet e bëra më pas, në vitin 2012, në nenin 13, deklarata individuale e të ardhurave vjetore, specifikohet që pas këtij viti, çdo person me të ardhura bruto vjetore mbi 2.000.000 lekë, duhet të dorëzojë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave”. Por, as në vitin 2012 dhe as në vitet në vijim, nuk rezultoi që subjekti të ketë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit dhe as të ketë paguar tatimin mbi të ardhurat, gjë që e ka bërë në vitin 2019, gjatë procesit të rivlerësimit.

79. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës si më poshtë:

79.1. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me automjetin me targa ***, blerë në vitin 2008, në çmimin 500.000 lekë, me kontratë nr. ***, datë 14.7.2008, dhe shitur në vitin 2010, në çmimin 22.000 euro, me kontratën nr. ***, datë 19.7.2010, subjektit iu kërkuan sqarime, si dhe dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si vijojnë:

i) Automjeti është blerë më 7.7.2008 prej shtetasit K. I., në çmimin 21.000 euro dhe në datën 11.7.2008 është zhdoganuar prej tij në vlerën 516.393 lekë.

ii) Në datën 14.7.2008, subjekti ka blerë këtë automjet nga shtetasi K. I. në çmimin 500.000 lekë në gjendje të rregullt teknike sipas parashikimit në kontratën e shitjes, blerje të cilën e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008, por pa deklaruar burimin e krijimit të pasurisë sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

iii) Në datën 19.7.2010, automjeti u shit nga subjekti në çmimin 22.000 euro, pa u paguar tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” në shumën 2.210.015 lekë/22.000 euro.

Referuar këtyre fakteve, duket se janë kryer veprime jashtë logjikës financiare⁴⁹ dhe për këtë arsye mund të ngrihen dyshime që çmimi i shitjes së automjetit me kontratën nr. ***, datë 14.7.2008, duhet të ishte të paktën në shumën 21.000 euro+516.393 lekë zhdoganim, pothuajse aq sa subjekti e ka shitur 2 vjet më vonë.

79.2. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa *** euro, blerë në vitin 2015 në çmimin 15.000 euro, subjektit iu kërkuan sqarime si dhe dokumente për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve si vijojnë:

i) Në DPV-në e vitit 2015, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, por, për herë të parë në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se si burim për shumën 15.000 euro ka shërbyer shuma 22.000 euro, përfituar nga shitja në vitin 2010 të automjetit tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2008.

ii) Shuma 22.000 euro e përfituar në datën 19.7.2010 nuk është depozituar në bankë deri në momentin e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2015.

iii) Shuma prej 22.000 euro, përfituar nga shitja e automjetit me targa ***, me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 19.7.2010, nuk është deklaruar si kursim *cash* në DPV-në e vitit 2010 dhe as në deklaratimet në vijim deri në vitin 2015, vit në të cilin ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” me çmim 15.000 euro, sipas gërmës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

⁴⁹Shihni vendimin nr. 78, datë 15.11.2018, të Komisionit dhe vendimin nr. 23, datë 23.9.2019, të Kolegjit.

iv) Subjekti nuk ka paguar në kohë reale tatimin mbi të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***, në datën 19.7.2010, në shumën 22.000 euro/2.210.015 lekë, sipas parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Si rrjedhim, shuma prej 22.000 euro, përfutur në vitin 2010 prej shitjes së automjetit me targa ***, blerë në vitin 2008, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 15.000 euro, në vitin 2015, vit i cili rezulton me balancë negative prej 2.042.729 lekësh.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2015 në shumën 15.000 euro, të cilin më vonë, në vitin 2016, e ka ndërruar me automjetin tip “Smart”, deklaruar në deklaratën *Vetting*, si rrjedhim nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i krijimit të automjetit tip “Smart” me targa *** (ndryshuar me targa ***).

80. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me konstatimet për transaksionet e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë në vitin 2008 dhe shitur në vitin 2010.

80.1 Sa i takon blerjes së automjetit në vlerën 500.000 lekë nga shtetasi K. I., i cili një javë më parë e kishte blerë automjetin rreth 22.000 euro, përfshirë dhe zhdoganimin, si dhe shitjen e tij në vlerën prej 22.000 euro dy vjet më vonë, në parashtrimet e datës 31.8.2020, subjekti ka dhënë të njëjtat deklaratime si në deklaratimet e mëparshme, duke nënvizuar se ka paguar në favor të shtetasit K. I. vlerën prej 500.000 lekësh dhe asnjë shumë tjetër dhe se me këtë shtetas ka lidhje familjare nga nëna dhe për arsye të tij personale dhe me vullnet plotësisht të lirë ka pranuar këtë çmim, pa u ndikuar nga asnjë rrethanë e kushtëzuar nga profesioni i tij. Gjithashtu, subjekti vijon të deklarojë se në momentin e blerjes automjeti ka qenë i dëmtuar, janë bërë shpenzime për riparimin e tij dhe ky është shkaku kryesor i blerjes në vlerën 500.000 lekë. Sa i takon shitjes së automjetit në vitin 2010, sa shumëfishi i blerjes së tij në vitin 2008, subjekti ka prapësuar se kjo lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin e tij, pasi në momentin e blerjes kishte qenë i dëmtuar.

80.2. Me qëllim qartësimin e situatës në lidhje me dëmtimet e pretenduara në automjet dhe investimet e kryera, me riçeljen e hetimit administrativ, u pyetën në cilësinë e dëshmitarëve shtetasit K. I. dhe G. H.. Shtetasi K. I. në dëshminë e tij⁵⁰, i pyetur mbi arsyet e shitjes së automjetit në vlerën 500.000 lekë, ndërkohë që e kishte blerë mjetin një javë më parë në vlerën 20.000 euro, në Gjermani, sqaroi se në kushtet që automjeti kishte pësuar një dëmtim nga rënia e një dege dhe kishte dëmtuar dy dyert e saj (derën e shoferit dhe pasagjerit) dhe kabinën, duke dashur të shiste sa më shpejt, kishte arritur një marrëveshje me të afërmin e tij Kolë Hysenaj, i cili ishte shprehur i gatshëm që t’i jepte shumën prej 500.000 lekësh në dorë. Shtetasi G. H.⁵¹ konfirmoi blerjen e makinës në shumën 22.000 euro, si dhe faktin se në momentin e blerjes makina ishte e lyer por ka qenë në rregull nga gjendja motorike.

80.3. Nga deklaratimet e këtyre shtetasve, deklaratat noteriale e datës 14.7.2008, të shtetasit K. I., si dhe të gjitha dokumentet shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ shtesë rezultuan të dhëna kontradiktore sa i takon gjendjes teknike të automjetit në kohën e blerjes, si dhe kostove të riparimit. Konkretisht:

⁵⁰Shihni procesverbalin e pyetjes së dëshmitarit K. I., datë 25.11.2020, në dosjen e Komisionit.

⁵¹Shihni procesverbalin e pyetjes së dëshmitarit G. H., datë 14.10.2020, në dosjen e Komisionit.

- Në procesin e pyetjes nga Komisioni shtetasi K. I. deklaroi se automjeti në momentin e shitjes kishte qenë i dëmtuar në dy dyer dhe në kabinë për shkak të rënies së një dege peme (një ditë korriku stuhie me shi), ndërsa në deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.2.2020, ky shtetas ka deklaruar se automjeti ka qenë i karamboluar, fakt të cilin e ka konfirmuar dhe subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

- Po kështu, deklaratimet e shtetasit K. I. dhe të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilave automjeti ka qenë i dëmtuar në momentin e shitjes, bien në kundërshtim me të dhëna të kontratës së shitblerjes së datës 14.7.2008, në të cilën nuk konfirmohen dëmtime të automjetit dhe dokumentin e titulluar “certifikata e kontrollit fizik të automjetit” në dosjen e DPSHTRR-së, datë 14.7.2008, e cila përcakton se “nuk janë konstatuar problematika”.

- Në vitin 2016 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se shtetasi K. I. ka qenë në pamundësi të kryerjes se procedurave të zhdoganimit, pasi nuk kishte lekë të paguante doganën. Ndërkohë, ky deklarim i subjektit, bien ndesh me deklarin e dëshmitarit K. I., i cili gjatë seancës së pyetjes së tij të datës 25.11.2020, e mohoi një fakt të tillë, duke deklaruar se e kishte paguar doganën dhe më pas e kishte shitur automjetin.

- Në vitin 2016 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se automjeti i ka pasur të dëmtuara të katërta dyert. Ky deklarim i subjektit bie ndesh jo vetëm me kontratën e blerjes së datës 14.7.2008, në të cilën parashikohet që mjeti ka qenë në gjendje të rregullt, por edhe me deklarin e dëshmitarit K. I., i cili gjatë seancës së pyetjes së tij të datës 25.11.2020, deklaroi se automjeti kishte të dëmtuara dy dyer dhe kabinën.

- Në vitin 2016 subjekti ka deklaruar në ILDKPKI se: “*K. më shpjegoi se duhet të largohej jashtë Shqipërisë dhe konkretisht në shtetin Gjerman, pasi kishte vendosur që të qëndronte disa kohë për të jetuar dhe punuar atje*”. Nga deklaratimet e dëshmitarit dhe lëvizjet në sistemin TIMS, rezultoi që pas shitjes së automjetit shtetasi K. I., ka pasur hyrje-dalje në periudha të shkurtra kohore jashtë shtetit dhe jo qëndrim të gjatë në Gjermani.

- Në deklaratimet në ILDKPKI në vitin 2016, subjekti ka deklaruar se mesa i kujtohej servisi i kryer në momentin e blerjes, ka kushtuar rreth 300.000 lekë. Ndërkohë, i pyetur në seancën dëgjimore të datës 25.11.2020, ka deklaruar se shpenzimet për riparimin e automjetit kanë qenë në vlerën 60.000 lekë.

80.4. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ shtesë, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mospërputhjet, deklaratimet kontradiktore dhe paqartësitë e konstatuara si më sipër, i cili në mënyrë të përmbledhur deklaroi se nuk rezulton asnjë mospërputhje, por e kundërta, pasi sipas tij, qoftë shitësi K. I., qoftë blerësi G. H., konfirmojnë çmimet e blerjes dhe shitjes së automjeteve, sikurse janë shënuar në kontratat përkatëse. Ndërsa sa i takon shpenzimeve të kryera për riparimin e tij, subjekti paraqiti një variant të ri duke sqaruar se riparimet janë kryer në mënyrë periodike nga 2008 – 2010 dhe se ka shpenzuar vlerat 250.000 – 270.000 lekë/vit, përkatësisht për vitet 2009 dhe 2010.

81. Vlerësimi i Komisionit bazuar në fakte dhe në ligjin e zbatueshëm

81.1. Sa i takon vlerës së automjetit me targa ***, blerë në vitin 2008, në çmimin 500.000 lekë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi jobindëse dhe të pambështetura në dokumente shkresore pretendimet e subjektit referuar fakteve dhe rrethanave, si vijojnë:

i) Subjekti pretendoi se përpos marrëdhënieve familjare me shtetasin K. I., automjeti është blerë në këtë vlerë për shkak se ka qenë i dëmtuar, pretendim i cili jo vetëm që mbetet në nivel

deklarativ, por vjen në kundërshtim me kontratën e shitjes së automjetit me nr. ***, datë 14.7.2008, si dhe me certifikatën e kontrollit teknik të mjetit, datë 14.7.2008.

ii) Shpjegimet e subjektit, deklaratimet e dëshmitarëve K. I. dhe G. H., në lidhje me llojin e dëmtimeve, janë kontradiktore dhe, për pasojë, jo tërësisht të pabesueshme.

iii) Edhe nëse do të merreshin të mirëqena pretendimet e subjektit, dëmtimet e pretenduara në dy dyert e automjetit apo edhe në kabinën e tij, në kushtet kur automjeti nuk kishte pësuar dëmtime në motor⁵², shpenzimet e pretenduara në cilindo prej varianteve, nuk justifikojnë shitjen e automjetit me çmimin 500.000 lekë.

81.2. Sa i takon shitjes së automjetit në vitin 2020, dy vjet më vonë, në çmimin 22.000 euro, Komisioni vlerësoi jo bindëse dhe të paargumentuara shpjegimet e subjektit, si dhe evidentoi deklaratime të ndryshme në lidhje me investimet që ka kryer në automjet, pasi e bleu në vitin 2008. Konkretisht: (i) në deklaratimet në ILDKPKI në vitin 2016, ka deklaruar se shpenzimet kanë qenë në vlerën 300.000 lekë; (ii) në seancën dëgjimore të datës 18.9.2020, deklaroi se shpenzimet kanë qenë në vlerën 600.000 lekë të vjetra; (iii) në parashtrimet e datës 18.3.2021, pas riçeljes së hetimit administrativ, deklaroi se këto shpenzime kanë qenë në vlerën 840.000 lekë⁵³. Në secilin rast, pretendimet e subjektit kanë qenë në nivel deklarativ dhe, për më tepër, bëjnë fjalë për kryerjen e shpenzimeve të tilla të cilat nuk e justifikojnë shitjen e automjetit në vlerën 22.000 euro, dy vjet më pas, i cili ishte blerë me çmimin 500.000 lekë.

81.3. Bazuar në sa më sipër, është e qartë se subjekti ka kryer veprime të pajustificuara financiarisht në të dyja transaksionet që kanë pasur për objekt automjetin me targa ***. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto transaksione nuk kanë qenë bindëse dhe krijojnë dyshime sa i takon vlerës reale të automjetit në momentin e blerës ose të shitjes⁵⁴.

81.4. Ndërsa, për efekt të llogaritjes së shpenzimeve në vitin 2008, përtej dyshimeve që ky mjet mund të jetë blerë nga subjekti më shtrenjtë se çmimi i parashikuar në kontratën e shitjes së datës 14.7.2008, referuar këtij dokumenti shkresor, Komisioni vlerësoi që të përlllogarisë si shpenzim për blerjen e automjetit shumën prej 500.000 lekësh të paguar si çmim shitjeje sipas kësaj kontrate, plus shpenzime të investuara në mjet pas blerjes. Sa i takon këtyre shpenzimeve, në kushtet kur subjekti nuk i vërtetoi me dokumente shkresore, si dhe në kushtet kur ka pasur deklaratime kontradiktore në lidhje me vlerën e investimeve, nga Komisioni u morën në konsideratë deklaratimet në procesverbalin e datës 15.6.2016 pranë ILDKPKI, ku subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar për automjetin vlerën 300.000 lekë, duke vlerësuar që kjo shumë i përafrohet më shumë vlerës monetare të pretenduar për riparimin e dy/tre dyerve, apo dhe të kabinës, në kushtet kur automjeti nuk ka pasur dëmtime në motor. Në analizën përfundimtare financiare, vlera në total prej 800.000 lekësh, është konsideruar si shpenzim në analizën financiare për vitin 2008, vit i cili rezulton me balancë negative në vlerën prej 195.214 lekësh.

81.5 Sa i takon mosdeklarimit të burimeve për blerjen e automjetin në vitin 2008, subjekti ka përmendur se blerja e mjetit ka rezultuar nga kursimet familjare përgjatë atij viti, por pa dhënë arsye mbi mosdeklarimin e burimeve sipas ligjit.

⁵²Shihni procesverbalin e pyetjes së dëshmitarëve K. I. dhe G. H. përkatësisht të datave 25.11.2020 dhe 14.10.2020 në dosjen e Komisionit.

⁵³Subjekti ka deklaruar se përveç shumës prej 300.000 lekësh, ka kryer edhe shpenzime të tjera riparimi, duke shpenzuar vlerat 250,000 – 270,000 lekë për çdo vit, për periudhën 2009 - 2010.

⁵⁴Shihni vendimin nr. 23, datë 23.9.2019, të Kolegjit-së për subjektin Alma Liçaj.

81.6. Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2015, në shumën 15.000 euro me kontratë nr. ***, datë 12.2.2015, ne parashtrimet e tij, subjekti ka prapësuar, si vijon:

Së pari, sa i takon mosdeklarimit të burimit të blerjes së këtij automjeti në DPV-në për vitin 2015, (të ardhura nga shitja e mjetit të blerë në vitin 2008, me targa ***, në vitin 2010 me vlerë 22.000 euro), burim të cilin e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, subjekti ka prapësuar se megjithëse nuk është cituar formalisht në këtë DPV, deri në vitin 2015 ka pasur mundësinë e kursimit të vlerës prej 15.000 euro, pretendim i cili mbetet në nivel deklarativ për sa kohë nuk ka deklaruar kursime *cash* përgjatë vitit 2010 kur u shit mjeti i parë deri në vitin 2015, kur u ble mjeti i dytë.

Së dyti, sa i takon konstatimeve se shuma prej 22.000 euro nuk është depozituar në bankë, si dhe nuk janë deklaruar kursime *cash* në DPV-në për vitin 2010 deri në vitin 2015, kur u ble mjeti tip “Mercedes-Benz”, sipas pikës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjekti nuk ka dhënë argumente të ndryshme nga ato gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se ka pasur kursime *cash* të mbajtura në banesë, të cilat edhe pse nuk janë deklaruar, ndër vite, duhet t’i merren në konsideratë⁵⁵.

Së treti, sa i përket moskalimit të shumës 22.000 euro përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2010 përmes sistemit bankar, subjekti sqaron se kjo ka ndodhur për lehtësi veprimesh mes palëve dhe noterit, por mbi të gjitha sepse ky nuk ka qenë një detyrim ligjor.

Së katërti, sa i takon konstatimit se subjekti nuk ka paguar në kohë reale tatimin mbi të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***, datë 19.7.2010, në shumën 2.210.015 lekë, sipas parashikimeve të gurmës “g”, pika 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, subjekti vijon të pretendojë se ky konstatim është i pasaktë dhe kërkon që kjo shumë të njihet si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të këtij viti. Ndërsa në parashtrimet pas rriçeljes së hetimit administrativ, subjekti ka shtuar se situata familjare në vitin 2010, kur është shitur mjeti, ka qenë shumë e rënduar për shkak të humbjes së dy familjarëve të afërm⁵⁶. Siç vërehet, është e vërtetë që gjatë vitit 2010, kur është shitur mjeti, subjekti ka pasur dy fatkeqësi familjare, të cilat mund të kenë ndikuar në mosveprimin e tij. Por, referuar shpjegimeve të subjektit pranë ILDKPKI, mungesa e pagimit të tatimit mbi të ardhurat nga shitja në vitin 2010, ka ardhur për shkak të paqartësisë së ligjit, për ndryshimet e të cilit është ndërgjegjësuar në vitin 2012, vit në të cilin subjektet duhet të plotësonin deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA). Megjithatë, përsëri, nuk rezulton të jetë kryer pagesa e tatimit mbi të ardhurat deri në datën 19.6.2019⁵⁷, kur është kryer pagesa për efekt të procesit të rivlerësimit. Për këtë arsye, si dhe referuar qëndrimin të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit⁵⁸, si e ardhur ligjore nga shitja e automjetit për vitin 2010 është konsideruar vlera e blerjes 500.000 lekë plus investime në shumën 300.000 lekë, pra, në total shuma 800.000 lekë.

⁵⁵Trajtuar hollësisht në rubrikën “Analizë e gjendjes *cash* dhe vlerësimi i Komisionit”, të këtij vendimi.

⁵⁶Subjekti ka paraqitur certifikatë vdekjeje të nënës K. H., e cila ka ndërruar jetë në datën 2.7.2010 dhe një foto të pllakës përkujtimore të varrit të vëllait ku si datë vdekjeje rezulton 24.6.2010.

⁵⁷Shitja e kësaj makine në shumën 2.505.420 lekë, që korrespondon me vlerën 22.000 euro, është deklaruar në DIVA/2011, në rubrikën “Të ardhura *bruto* të tjera të papërmendura më lart”, gjithashtu, është deklaruar tatimi 10% në shumën 250.542 lekë. DIVA/2011 është plotësuar dhe depozituar prej subjektit në datën 19.6.2019 dhe në të njëjtën datë është bërë pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja.

⁵⁸Shihni vendimin nr. 5/2020, datë 13.3.2020, të Kolegjit.

81.7. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha sa është arsyetuar më sipër, Komisioni çmoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave në shumën prej 22.000 euro deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting* si burim për blerjen në vlerën 15.000 euro të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** (ndryshuar në ***) në vitin 2015, mjet i këmbyer me mjetin tip “Smart”, me targa ***. Që kjo e ardhur të konsiderohej e ligjshme, duhet që të përmbusheshin në mënyrë kumulative dy kushte: (i) të ishte paguar në kohë reale tatimi për të ardhurat nga shitja; (ii) të ishin deklaruar kursimet *cash* të pretenduara si të mbartura nga viti 2010 kur u shit mjeti në vlerën 22.000 euro, deri në vitin 2015 kur u ble mjeti tip “Mercedes-Benz” me targa *** në vlerën 15.000 euro. Po kështu, Komisioni çmoi se modeklarimi i burimit të krijimit të këtij mjeti në DPV-në për vitin 2015, nuk është thjesht një pasaktësi formale, po një pasaktësi që merr peshë specifike të posaçme në kushtet kur nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme për blerjen e tij. Në këto kushte, subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2015 dhe, për rrjedhojë, edhe për mjetin e këmbyer tip “Smart”, deklaruar në deklaratën *Vetting*.

Pasuri e paluajtshme e llojit truall + ndërtesë, Korçë

82. Në deklaratën *Vetting*, kjo pasuri është deklaruar: *Pasuri e paluajtshme e llojit truall + ndërtesë, me sip. 316 m², nr. ***, z. k. ***, Korçë. Vlera: 100.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 13.7.2016; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***. Burimi: (a) kursime nga pagat; (b) shitja e truallit në F., P., shtetasit A. P.; (c) të ardhura nga biznesi, të depozituara në bankë.*

Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Mosdeklarime, ndër vite, referuar kursimeve *cash*, gjendjeve të akumuluar të tyre dhe deklarime të pasakta referuar përdorimeve të gjendjes *cash*.
- Fshehje e shumës së investuar për ndërtimin e banesës 1-katëshe në F., P., si në deklaratat e interesave private në ILDKPKI gjatë periudhës 2008 – 2011, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues përkatës të ndërtimit. Ky fakt do të shërbente edhe për llogaritjen e të ardhurave neto nga transaksioni me tokën në F., P., blerje-ndërtim-shitje.
- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për shumën e investuar për banesën në F., P., për periudhën 2008 – 2011, në shumën minimale prej 2.500.000 lekësh, duke llogaritur sip. 70 m², ndërtim, me çmime të EKB-së.
- Dyshime për rritje joreale në shumëfish të çmimit blerje/shitje të tokës në F., P., si dhe/ose investimet në tokën e blerë janë në shuma të konsiderueshme.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

83. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, nga hetimit administrativ rezultoi:

- ASHK-ja Korçë⁵⁹ informoi se shtetasi Kolë N. Hysenaj është bashkëpronar në ½ pjesë i pasurisë me nr. ***, me sipërfaqe totale 316.36 m², nga të cilat 146.6 m² ndërtesë, në Korçë.
- OSHEE-ja⁶⁰ informoi se shtetasi Kolë N. Hysenaj është abonent dhe ka kontratë furnizimi me energji me datë hapje 10.8.2005, në Korçë, ndryshuar emri i abonentit në datën 24.8.2016.

⁵⁹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.5.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶⁰Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.4.2019, nga OSHEE-së, në dosjen e Komisionit.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit për përdorimin e kësaj pasurie, si dhe nëse ka kryer investime a shpenzime mobilimi, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se kjo pasuri nuk është përdorur dhe se aktualisht mbi të nuk është kryer ndonjë investim. Subjekti ka paraqitur kopjen e faqes së parë të librezës për kontratën ***, që i përket banesës private në emër të Kolë Hysenaj, si dhe informacion të marrë nga FSHU-ja⁶¹, të cilat pasqyrojnë pagesa relativisht të vogla që nisin në janar të vitit 2007.

Në përfundim të procesit, nuk u evidentuan të dhëna që subjekti të ketë përdorur rregullisht këtë pasuri apo të këtë kryer investime mbi të.

84. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë, nga aktet në dosje⁶², rezultoi se:

84.1 Sipas certifikatës për vërtetim pronësie dhe kartelës së pasurisë lëshuar në datën 7.7.2016, vërtetohet se në ZVRPP-në Korçë është e regjistruar në bashkëpronësi të 12 shtetasve, D. P. etj., pasuria nr. *** e llojit truall me sip. 316.36 m², nga e cila 146.60 m² ndërtesë në Korçë.

84.2 Me kontratë shitblerje nr. ***, datë 13.7.2016, shtetasi Kolë Hysenaj bleu pasurinë nr. ***, me çmim 100.000 euro, vlerë e kaluar në llogarinë e noterit pranë BKT-së Korçë në datën 13.7.2016. Në DPV-në për vitin 2016 subjekti e ka deklaruar këtë pasuri me burim: (a) kursime nga pagat; (b) të ardhura nga biznesi ndër vite; (c) shitblerje të deklaruara në vite më përpara; (ç) kursime të depozituara në bankë (sipas veprimit bankar të datës 1.7.2016), pagesa për shitblerjen sipas veprimit bankar të datës 13.7.2016.

84.3. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Korçë në datën 20.7.2016, pasuria nr. ***, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve D. e Kolë Hysenaj me ½ pjesë takuese.

84.4. Sa i takon blerjes së kësaj pasurie, nuk u evidentuan të dhëna që subjekti të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale, pasi: (i) sipas EKB-së, çmimi/m² i shitjes së apartamenteve në Korçë në vitin 2016 ka qenë 45.800 lekë⁶³, pra, ndërtesa me sipërfaqe 146.6 m² do të kushtonte 6.714.280 lekë; (ii) sipas VKM-së nr. 89/2016, vlera e pasurisë tokë truall në qytetin e Korçës ka qenë 9.055 lekë/m², pra, pasuria truall me sipërfaqe 316 m² do të kushtonte 2.861.380 lekë; (iii) në total truall 316 m² + ndërtesë 146.6 m² do të kushtonin 9.575.660 lekë /70.789 euro⁶⁴, ndërkohë që subjekti e ka blerë këtë pasuri me një çmim më të lartë, 100.000 euro.

85. Në lidhje me burimin e krijimit, në deklaratën *Vetting* janë deklaruar: (a) kursime nga pagat; (b) shitja e truallit në F., shtetasit A. P.; (c) të ardhura nga biznesi, të depozituara në bankë, por pa u specifikuar shuma konkrete e secilit prej burimeve.

Si burim faktik për blerjen e kësaj pasurie në vlerën 100.000 euro, është përdorur llogaria nr. ***, në "Raiffeisen Bank", ku subjekti ka pasur të depozituar shumën prej 128.000 euro. Këtë shumë subjekti e ka depozituar *cash* në datën 1.7.2016, pra, 12 ditë më parë se të redaktohej kontrata e shitjes, me përshkrimin "nga biznesi, shitja e banesës në vitin 2012 dhe kursime nga pagat ndër vite". Në datën 13.7.2016, është përpiluar kontrata e shitjes.

⁶¹Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 17.2.2020, nga FSHU-ja, drejtuar subjektit të rivlerësimit bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

⁶²Shihni aktet në aneksin 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶³<https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/UKM-Nr.3-date-28.12.2016.pdf>.

⁶⁴Kursi këmbimit 1euro:135.27 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2016.

86. Analiza e burimeve të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi (të njëjtat me burimet e krijimit të depozitës prej 128.000 euro) është kryer në mënyrë të detajuar për secilin prej burimeve si vijon:

86.1. Burimi: kursime nga pagat. Gjatë hetimit administrativ, u konstatua se të ardhurat nga pagat nga 1.1.2016 – 13.7.2016, kur është blerë pasuria, kanë qenë: (i) të ardhura nga pagat e subjektit në vlerën 810.905 lekë; (ii) të ardhura nga pagat e bashkëshortes në vlerën 740.000 lekë. Shuma totale e të ardhurave nga pagat në vlerën 1.550.905, është marrë në konsideratë si e ardhur ligjore në analizën financiare.

86.2. Burimi: të ardhura nga biznesi të depozituara në bankë. Nga të dhënat bankare nuk rezultoi që subjekti apo bashkëshortja e tij të kenë depozituar në bankë të ardhura nga biznesi. Të ardhurat e deklaruara nga biznesi për të gjithë vitin 2016 kanë qenë në shumën 312.561 lekë, e cila është përfshirë si ardhur e ligjshme në analizën financiare të këtij viti.

86.3. Burimi: shitja e truallit në F., P., shtetasit A. P..

Gjatë hetimit administrativ u vërtetua se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.1.2012, shtetasit D. e Kolë Hysenaj i shitën shtetasit A. P. tokë me sip 1.000 m² në F., Tiranë, mbi të cilën është ndërtuar një shtëpi njëkatëshe, me sip. 70 m², me çmim 14.170.000 lekë. Me qëllim evidentimin e ligjshmërisë së të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie, nga Komisioni u kryen verifikimet si vijojnë:

87. Lidhur me origjinën, mënyrën e përfitimit të pasurisë me sip. 1.000 m² në F., Tiranë, si dhe investimin e kryer mbi të, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së⁶⁵ dhe dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

87.1. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 3.3.2004, shtetasi K. B. ka qenë pronar mbi pasurinë e llojit arë me sip. 1.000 m², me nr. pasurie ***, në F., Tiranë, blerë me kontratën e datës 1.3.2004, në çmimin 1.000.000 lekë.

87.2. Sipas kontratës së datës 9.9.2004 (jonoteriale) mes shtetasit K. B. në cilësinë e pronarit dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., është porositur ndërtimi i një banesë njëkatëshe me tulla me sip. ndërtimi 71 m², me vlerë preventive 1.200.000 lekë në fshatin F., punimet për të cilën do të fillonin pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe do të përfundonin brenda 3 muajve.

87.3. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.4.2008, shtetasit Kolë dhe D. Hysenaj kanë blerë nga shtetasit K. dhe T. B., tokë me sip. 1.000 m² në F., Tiranë, me çmim prej 390.000 lekësh. Në lidhje me faktin e blerjes së pasurisë tokë “arë” me një çmim rreth 1/3 më pak se çmimi fillestar i blerjes nga pronari i mëparshëm në vitin 2004 (përafërsisht sa çmimi i referencës⁶⁶), u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3, deklaroi se shitblerja ishte kryer me vullnet të lirë nisur nga interesi i tij i hershëm, si dhe nevoja imediate e shitësit të pasurisë, i cili po llogohej jashtë shtetit. Po kështu, nga Komisioni u hetua në lidhje

⁶⁵Shihni aktet në aneksin nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 28.5.2019, nga ASHK-ja Tirana Veri; si dhe dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁶⁶Sipas VKM-së nr. 139/2008 çmimi i referencës për tokën arë në F. ka qenë 317 lekë/m², pra, sipërfaqja prej 1000 m² do të kushtonte 317.000 lekë, pothuajse aq sa është shitur te subjekti i rivlerësimit.

me ndonjë konflikt të mundshëm interesi gjatë ushtrimit të detyrës së subjektit, nga ku nuk u konfirmuan⁶⁷ kallëzime apo procedime penale të regjistruara në emër të shtetasit K. B..

87.4. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 8.7.2008, pasuria e llojit arë me sip. 1.000 m² në F., Tiranë, z. k. ***, vol. ***, f. ***, është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Kolë e D. Hysenaj.

Pra, në momentin e redaktimit të kontratës së shitjes, pasuria e shitur ka qenë e llojit toke “arë”, e cila më pas është shndërruar në truall për ndërtim, vërtetuar me: (i) vendimin nr. 2, datë 28.5.2008, të KRRR-të të Komunës P., sipas të cilit i është miratuar shtetasit K. B. leja e sheshit të ndërtimit, për objekt shtëpi banimi 1 kat me çati, në fshatin F., Komuna P., me sip. sheshi 1.000 m², sipërfaqe ndërtimi 71 m²; (ii) vendimin nr. 4, datë 12.9.2008, të KRRR-të të Komunës P., sipas të cilit, i është dhënë shtetasit K. B. leja e ndërtimit për objekt banimi 1 kat me çati, në fshatin F., Komuna P..

87.5. Mbi truallin me sip. 1000 m² u ndërtua një banesë njëkatëshe me sip. 71 m², punimet e të cilës sipas aktit të kolaudimit kanë përfunduar në datën 15.1.2009. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se mbi sipërfaqen e tokës së blerë prej tij, është ndërtuar me investime të kryera prej tij një shtëpi me sip. 71 m², e cila në vitin 2012, së bashku me sipërfaqen e tokës i është shitur shtetasit A. P.. Leja e ndërtimit për këtë objekt është lëshuar në shtator të vitit 2008 në emër të shtetasit K. B., dhe kjo lidhet me faktin se aplikimi është realizuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, por banesa është ndërtuar për interes të tij si pronar i tokës dhe me shpenzime të tij. Nga verifikimi i DPV-së për vitet 2008 – 2010, subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me objektin e ndërtuar mbi tokën e blerë dhe as shpenzime apo pakësime likuiditetesh për kryerjen e investimeve, ndërkohë që ka kryer deklarime në DPV-në për vitin 2011 dhe 2012, vit në të cilin është shitur pasuria.

88. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime. Në parashtrimet e tij, në lidhje me mosdeklarimin e objektit në DPV-të për vitet 2008 -2010 dhe investimet e kryera, z. Kolë Hysenaj, ka deklaruar se duke qenë se ndjekja e punimeve dhe pagesat kryheshin nga z. K. B. dhe duke qenë se shtriheshin në një periudhë të gjatë kohore, nuk i dinte dhe, për këtë arsye, nuk ka mundur t'i deklarojë. Ky pretendim i subjektit nuk justifikon mungesën e deklarimeve për një investim të kryer prej tij, në pronën e tij dhe për më tepër, vjen në kundërshtim me deklaratimet në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ku ka deklaruar se investimet në objekt janë kryer me shpenzime të tij, ndonëse leja e ndërtimit ka qenë në emër të shitësit K. B., duke deklaruar shprehimisht se: “... *teknikisht pagesat prej meje i jepeshin K. dhe më pas ky i fundit paguante çmimin e materialeve dhe shërbimin e ndërtuesit*”.

Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se subjekti është në kushtet e pasaktësisë në deklarime përgjatë këtyre viteve, sipas detyrimeve që ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, ka parashikuar.

89. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për blerjen e pasurisë truall me sip. 1.000 m² dhe investimin e kryer për objektin 71 m² në F., Tiranë.

89.1. Gjatë hetimit administrativ është vërtetuar se për blerjen e pasurisë tokë/truall, ndodhur në F., Tiranë, subjekti ka paguar si çmim shitjeje shumë 390.000 lekë në datën 7.4.2008. Në

⁶⁷Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

lidhje me investimet e kryera mbi këtë pasuri, pavarësisht vlerës së situacionit përfundimtar prej 1.660.000 lekësh, shpenzimet për ndërtimin e objektit me sip. 71 m² janë përlllogaritur nga Komisioni bazuar në çmimet e EKB-së për qytetin e Tiranës në shumën 1.948.169 lekë⁶⁸ dhe viti i ndërtimit është konsideruar 2008, pasi akt-kolaudimi parashikonte që punimet janë dorëzuar të përfunduara në datën 15.1.2009. Pra, shpenzimet e investimit në këtë pasuri, në përfundim të hetimit administrativ u përfshinë në analizën financiare të vitit 2008, vit i cili ka rezultuar me balancë negative në vlerën prej 164.139 lekësh.

89.2. Në parashtrimet e rezultateve të hetimit shtesë, subjekti ka kërkuar që: (i) shpenzimi i investimeve të ndahet midis viteve 2008 dhe 2009 përkatësisht në masën $\frac{3}{4}$ dhe $\frac{1}{4}$; (ii) kosto e ndërtimit të merret sipas aktit të kolaudimit, datë 29.1.2009, nga ku rezulton një vlerë prej 1.660.000 lekësh, të cilës subjekti kërkon t'i zbriten “shpenzimet operationale të EKB-së në vlerën 4%”⁶⁹. Subjekti ka vënë në dispozicion të njëjtat dokumente të paraqitura edhe gjatë hetimit administrativ.

89.3. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se pretendimi i subjektit në lidhje me zbritjen e shpenzimeve në masën 4% nuk qëndron, pasi ky zë nuk është përfshirë në koston e përlllogaritur nga EKB-ja. Vlera e ndërtimit vijoi të vlerësohet bazuar në çmimet e EKB-së, ndërsa ndarja e investimit u vlerësua të bëhet sipas pretendimit të subjektit midis viteve 2008 dhe 2009, për periudhën e ndërtimit nga 12.9.2008 – 15.1.2009⁷⁰, sikurse përcaktohet në aktin e kolaudimit. Këto vlerësime kanë afektuar analizën financiare të vitit 2008 duke ulur balancën negative.

90. Lidhur me kalimin e pronësisë në emër të shtetasit A. P. dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, nga aktet në dosje u verifikua se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

90.1. Në datën 16.11.2012, është kryer rivlerësimi i pasurisë “parcelë tokë me sip. 1.000 m²”, në F., Tiranë, në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes, për të cilin nga Komisioni u konstatua se:

i) Z. Kol Hysenaj kishte plotësuar formularin e aplikimit për rivlerësimin e pasurisë.

ii) Sipas certifikatës së vlerësimit të pasurisë të datës 16.11.2011, pasuria është vlerësuar nga vlerësuesja E. L. në shumën 14.170.000 lekë. Gjatë procesit të rivlerësimit, është mbajtur në konsideratë edhe objekti njëkatësh i ndërtuar në parcelën më sip. 1000 m², edhe pse ky objekt nuk ka qenë i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë. Sipas vlerësueses, pasuria e llojit “arë” me sip. 1.000 m², pasuria nr. ***, është konsideruar si truall për shkak se me vendim nr. 2, datë 28.5.2008, të KRT-së, Komuna P., është miratuar leja e sheshit të ndërtimit të një objekti shtëpi banimi 1 kat me çati. Vlerësuesja shprehet se vlerësimi është i vlefshëm për t'u përdorur nga porositësi për t'u paraqitur pranë ZVRPP-së Tiranë për të realizuar rivlerësimin e pronës në zbatim të ligjit nr.10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, neni 27, “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët”.

⁶⁸Sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.08.2008, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, kostoja mesatare e ndërtimit për metër katror në qytetin e Tiranës është 27.439 lekë. Pra, ndërtimi me sip. 71 m² ka kushtuar 71m² x 27.439 lekë/m²= 1.948.169 lekë.

⁶⁹Subjekti i referohet Udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, të EKB-së.

⁷⁰Është përlllogaritur vlera ditore e ndërtimit për periudhën 124 ditore, nga të cilat 109 ditë i takojnë vitit 2008 dhe 15 ditë vitit 2009.

Gjatë hetimit administrativ, u kryen verifikime në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi të subjektit me vlerësuesen e pasurisë, znj. E. L., nga ku nuk u konfirmuan⁷¹ kallëzime apo procedime penale të regjistruara apo të trajtuara nga prokurori Kolë Hysenaj.

iii) Rivlerësimi i pasurisë është kryer në përputhje me ligjin nr. 10418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” dhe udhëzimin nr. 12, datë 18.11.2011, të Ministrit të Financave, nxjerrë në zbatim të ligjit. Përveç kësaj, Komisioni administroi dhe konsultoi dhe opinionin ligjor të Ministrisë së Financave⁷² lidhur me çështjen e rivlerësimit të pasurive nga ana e subjekteve deklarues në ILDKPKI në kuadër të ligjit nr. 10 418, datë 21.4.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, sipas të cilit, e drejta e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme për individët nuk është falje e detyrimit tatimor, doganor etj., të papaguar në afatin e kërkuar ligjor dhe, për këtë arsye, nuk ka kufizim për të drejtën e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme për kategori të caktuara qytetarësh.

iv) PAGESA e tatimit mbi vlerën e rivlerësimit është kryer nëpërmjet “Union Bank”, datë 17.11.2011, me pagesë *cash* në shumën 137.800 lekë.

Në këto kushte, e ardhura e përfituar nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, është konsideruar dhe përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare për vitin 2013.

90.2. Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 20.1.2012, shtetasit D. e Kolë Hysenaj i shitën shtetasit A. P. tokë me sip 1.000 m², në F., Tiranë, pasuria me nr. ***, z. k. ***, kundrejt çmimit 14.170.000 lekë, e likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës. Siç vërehet, edhe pse objekt i shitjes ka qenë vetëm sipërfaqja e tokës prej 1.000 m², në fakt subjekti i ka shitur blerësit A. P. edhe ndërtesën njëkatëshe me sip. 71 m² të ngritur mbi të, e cila ka qenë e pahipotekuar, vërtetuar me: (i) parashikimin në kontratën sipas së cilës “mbi tokën është ndërtuar një shtëpi njëkatëshe me çati e cila është e paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë”; dhe (ii) deklaratën noteriale të blerësit A. P., datë 30.3.2012, në të cilën ka deklaruar se ka shlyer detyrimin për shtëpinë dhe për tokën, ndaj shitësit Kolë Hysenaj.

90.3. Pasuria me nr. ***, z. k. ***, e llojit arë me sip. 1000 m², u regjistrua në emër të shtetasit A. P., sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 26.1.2012⁷³. Sa i takon objektin me sip. 71 m², nuk rezulton që të jetë regjistruar në emër të blerësit, por, sipas dokumentit nr. *** prot., datë 12.4.2012, të Komunës P., shtetasit A. P. i është dhënë leja e përdorimit të objektit “objekt banimi 1 kat +çati’ me sip. sheshi 1.000 m² dhe sip ndërtimi 71 m²”.

91. Lidhur me çmimin e shitjes së pasurisë në F., Tiranë dhe likuidimin e tij prej shtetasit A. P., gjatë hetimit administrativ është konstatuar se:

91.1. Kontrata e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 20.1.2012, parashikon se: “Çmimi i shitjes është likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës”. Gjatë hetimit administrativ u konstatua se ky çmim, nuk është likuiduar ditën e lidhjes së kontratës, ashtu sikurse kontrata parashikon, por rreth një vit pas lidhjes së kontratës, datë 14.2.2013, vërtetuar me lëvizjet bankare në “Raiffeisen Bank”, ku evidentohet se në datën 14.2.2013, është transferuar shuma prej 135.000 USD ose

⁷¹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 5.5.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.4.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

⁷² Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 14.2.2019, nga Ministria e Financave, në dosjen e Komisionit

⁷³Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

13.821.300 lekë⁷⁴, nga llogaria e z. A. P. në llogarinë e subjektit, me përshkrim “blerje shtëpie në F., P.”. Këtë shumë subjekti e tërhoqi *cash* në datën 5.3.2013. Po kështu, nga lëvizjet e llogarisë së subjektit në euro, në këtë bankë, rezultoi se në datën 24.4.2012 është transferuar shuma prej 35.000 euro nga llogaria e z. A. P. me përshkrimin “blerje shtëpie nga llogaria personale”.

Siç vërehet, në llogari të subjektit janë kryer dy kreditime prej z. A. P., me përshkrimin “blerje shtëpie”, të cilat në total janë në një vlerë më të lartë se çmimi i shitjes së pasurisë.

91.2. Në lidhje me dy kreditimet, u pyet subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ndër të tjera, në mospërputhje me parashikimin në kontratën e shitjes, shpjegon se: “... në janar të vitit 2012 shtetasit A. P. i kam shitur një pasuri të ndodhur në F., Tiranë, ...nga A. më është kërkuar që çmimi i shitblerjes të më likuidohej në dollarë amerikan dhe ky fakt për mua nuk përbente asnjë problem. Deri në kalimin e plotë të çmimit të shitblerjes së pasurisë në datën 24.4.2012, në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’, shtetasi A. P. ka kaluar shumën 35.000 euro, e cila do të ishte si kaocion deri në likuidimin e plotë të shumës, ... kemi rënë dakord që pas likuidimit të plotë të çmimit të shitblerjes këtë shumë garancie do ta ktheja menjëherë siç ka ndodhur realisht...”. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁷⁵ midis të cilave deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.6.2018, të shtetasit A. P., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit se shuma prej 35.000 euro ka qenë në formën e një garancie dhe do t’i kthehej atij me likuidimin e çmimit të shitjes së pasurisë. Ndërsa, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.1.2012, konstatohet se: (i) kjo kontratë nuk parashikon asnjë fakt në lidhje me kaparin prej 35.000 euro; (ii) likuidimi i çmimit të plotë të shitjes, ishte bërë që me nënshkrimin e kontratës së shitjes, pra, tre muaj më parë se dita që subjekti ka marrë kaparin e pretenduar prej 35.000 USD, datë 24.4.2012. Ndërkohë, nuk ka asnjë akt shkresor që të vërtetojë faktin e pagimit të një kapari nga blerësi A. P..

91.3. Sa i takon shumës prej 35.000 euro, të cilën subjekti e ka tërhequr *cash* në datën 24.4.2012 nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, nga deklarata e shtetasit A. P., por edhe shpjegimet e subjektit, rezulton se kjo shumë, i është kthyer *cash* z. A. P. në datën 14.2.2013, datë kur është kryer kreditimi i shumës prej 135.000 USD në llogarinë bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank”. Pra, subjekti e ka pasur gjendje këtë shumë që nga data 24.4.2012, ditë në të cilën e ka tërhequr, deri ditën kur ia ka kthyer *cash* z. A. P., në datën 14.2.2013, sipas deklaratimeve të tij gjatë procesit të rivlerësimit. Në DPV-në për vitin 2012, konstatohet se subjekti nuk e ka deklaruar këtë gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit dhe as detyrimin ligjor ndaj shtetasit A. P., sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

91.4. Sa i takon shumës 135.000 USD, që përbën çmimin e konvertuar në dollarë amerikan të shitjes sipas kontratës së shitjes së pasurisë prej 14.170.000 lekësh, ka kaluar në llogari të subjektit prej shtetasit A. P. në datën 14.2.2013 dhe është tërhequr *cash*, në datën 5.3.2013, në “Raiffeisen Bank”. Në DPV-në për vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në këtë shumë, sipas ligjit. Po kështu, nuk rezulton ta këtë depozituar në bankë dhe as të ketë deklaruar si gjendje likuiditeti *cash* në DPV-të për vitet 2014 dhe 2015, për ta përdorur si burim për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi dhe një pasurie tjetër, të dyja në Korçë, në vitin 2016, ashtu sikurse deklaroi në deklaratën *Vetting*.

⁷⁴ Kursi këmbimit 1USD=128.32 lekë, Banka e Shqipërisë datë 31.12.2013.

⁷⁵ Nxjerrje llogarie të “Raiffeisen Bank”, më 24.4.2012 dhe më 14.2.2013, si dhe deklarate noteriale të shtetasit A. P..

91.5. Në lidhje me shkakun e pagimit të çmimit të shitjes, rreth një vit, pasi është lidhur kontrata e shitjes, si dhe mospërputhjes së pagimit të çmimit me atë çfarë kjo kontratë parashikonte, në përgjigjet e dërguara në datën 26.6.2020, subjekti ka deklaruar se: “... në lidhje me nënshkrimin e kontratës dhe likuidimin e çmimit përmes kreditimit në bankë pas rreth 1 (një) viti, sqaroj Komisionin se nënshkrimi në zyrën noteriale para kalimit të shumës është bërë me dakordësi dhe në kushte mirëbesimi me blerësin me qëllim vijimin e procedurave për regjistrimin e kontratës, ndërsa vonesa në kreditim, si edhe likuidimi në valutën dollarë amerikan, më është kërkuar nga blerësi dhe është pranuar prej meje pasi nuk përbënte asnjë problem, duke qenë se nuk kisha asnjë dyshim mbi likuidimin e çmimit sikurse edhe ndodhi më pas i plotë...”.

91.6. Në lidhje me marrëdhënien me shtetasin A. P., subjekti deklaroi se me këtë shtetas njihet prej më shumë se 30 vjetësh duke qenë nga e njëjta zonë dhe nuk ka pasur asnjëherë asnjë rrethanë që të ketë ndikuar në profesionin e tij. Nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Korçë⁷⁶ nuk u konfirmuan kallëzime apo procedime penale të regjistruara në lidhje me këtë shtetas apo të trajtuara prej prokurorit Kolë Hysenaj.

91.7. Në përfundim të hetimit administrativ, për sa i takon çmimit të shitjes së pasurisë në F., Tiranë, si dhe mënyrës së likuidimit, në ushtrim të barrës së provës, subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet, duket se:

i) Çmimi i shitjes së pasurisë, z. A. P., nuk është likuiduar prej tij ditën e lidhjes së kontratës më 20.2.2012, ashtu sikurse kjo kontratë parashikon, por likuidimi është bërë në datën 14.2.2013, pra, rreth një vit pas lidhjes së kontratës. Po kështu, kontrata e shitjes së pasurisë, datë 20.2.2012, nuk e ka parashikuar kaparin prej 35.000 euro, ndërkohë që kjo shumë i ka kaluar subjektit nga z. A. P. në datën 24.4.2012, pra, tre muaj pas redaktimit të kontratës së shitjes. Në këto rrethana, referuar deklarameteve të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, duket se kontrata e shitjes së pasurisë nr. ***, datë 20.1.2012, përmban fakte të pavërteta.

ii) Shuma e tërhequra prej subjektit në vlerën 35.000 euro në datën 24.4.2012, në “Raiffeisen Bank”, nuk është deklaruar nga subjekti si gjendje likuiditeti *cash* për vitin 2012 dhe as si detyrim ligjor ndaj shtetasit A. P., sipas gremës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Kjo shumë, nuk vërtetohet të ketë kaluar në rrugë bankare në llogari të shtetasit A. P..

iii) Është e paqartë se cili është shkak i dhënies së kaparit të pretenduar nga subjekti prej 35.000 euro tre muaj pas redaktimit të kontratës së shitjes, në kushtet kur kapari jepet përpara përfundimit të procedurave të shitjes, me qëllim garantimin e shitblerjes së pasurisë, sipas nenit 601 e vijues të Kodit Civil.

iv) Është e paqartë se përse z. A. P., i ka kaluar subjektit shumën prej 135.000 USD në datën 14.2.2013, ndërkohë që duhet t'i kalonte diferencën midis kësaj shume dhe kaparit të pretenduar prej 35.000 euro, i cili i kishte kaluar subjektit në datën 24.4.2012.

⁷⁶Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

v) Subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit në DPV-në për vitin 2013 likuiditetin *cash* në shumën 134.900 UDS të kaluar në llogari të tij prej z. A. P. më 14.2.2013 dhe tërhequr prej tij më 5.3.2013.

92. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

92.1. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se fakti i likuidimit të çmimit të shitblerjes së pasurisë së ndodhur në F., Tiranë, nga blerësi A. P. në llogarinë e tij, në datën 14.2.2013 është deklaruar prej tij si në DPV-në e vitit 2012 edhe në DPV-në e vitit 2013 dhe se kurrsesi nuk ka tentuar të mos e deklarojë këtë fakt. Por, përkundër nga sa deklaroi subjekti, nga Komisioni nuk është evidentuar mosdeklarimi i likuidimit të çmimit të shitjes së pasurisë. Po kështu, sipas subjektit, *në vitin 2012 tjetërsimi i pasurive të paluajtshme nuk kërkonte si kusht paraprak kalimin e çmimit të kontratës në një llogari qëllimore të noterit. Duke qenë se nuk kishte një parashikim ligjor të tillë dhe me qëllim vijimin e procedurave për lëshimin e certifikatës në emër të blerësit, është bërë redaktimi i kontratës pavarësisht se likuidimi i saj ka ndodhur në një periudhë pas disa muajsh.* Ndërkohë, përkundër nga çfarë deklaroi subjekti, likuidimi i çmimit të shitjes është bërë një vit më vonë se redaktimi i kontratës së shitjes. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se këto veprime janë kryer në kushte të plota mirëbesimi, pasi nuk kishte asnjë dyshim mbi faktin e likuidimit të çmimit të plotë të shitblerjes.

92.2. Për sa i përket shumës prej 35.000 euro të dhënë si kapar, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si edhe gjatë procesit të rivlerësimit duke deklaruar se shuma prej 35.000 euro ka qenë një garanci paraprake e dhënë nga blerësi, e cila as nuk është përdorur prej tij dhe as ka përfutur ndonjë të ardhur apo interes prej saj. Me kreditimin e plotë të çmimit të shitblerjes, kjo shumë është kthyer e plotë te shitësi.

92.3. Nga parashtrimet e subjektit vërehet se nuk jepen sqarime të qarta në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes në mënyrë të ndryshme nga ajo e parashikuar në kontratën e datës 20.1.2012, si dhe në lidhje me mosparashikimin e dhënies së kaparit prej 35.000 euro në këtë kontratë.

92.4. Në lidhje me mosdeklarimin e kaparit prej 35.000 euro si gjendje likuiditeti *cash* për vitin 2012, apo si detyrim ligjor ndaj shtetasit A. P., në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se mosdeklarimi ka ndodhur për shkak se kjo shumë ka shërbyer si garanci dhe nuk është konsideruar as si e ardhur dhe as si detyrim i tij. Sipas tij, kjo shumë nuk ka qenë e ardhur sepse nuk përbënte çmimin e shitblerjes së pasurisë së ndodhur në F., ndërsa nga ana tjetër nuk mund të konsiderohej as si detyrim ndaj A. P., për sa kohë nuk i ishte kredituar çmimi i kontratës. Ndërkohë që në vitin 2013, pasi iu kreditua çmimi i shitblerjes, ka bërë kthimin e kësaj shume te blerësi, duke mos pasur detyrimin që në fund të këtij viti të deklaronte posedimin dhe as dorëzimin e saj.

92.5. Sa i takon shkakut të dhënies së kaparit të pretenduar prej 35.000 euro, tre muaj pas redaktimit të kontratës së shitjes, subjekti nuk ka dhënë shpjegime. Po kështu, subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me faktin se përse z. A. P., i ka kaluar subjektit shumën prej 135.000 USD në datën 14.2.2013, ndërkohë që duhet t'i kalonte diferencën mes kësaj shume dhe kaparit të pretenduar prej 35.000 euro, i cili i kishte kaluar subjektit në datën 24.4.2012.

92.6. Sa i takon mosdeklarimit të likuiditetit *cash* të shumës 135.000 USD, pasi e ka tërhequr nga banka, në DPV-në për vitin 2013, subjekti ka dhënë deklarime të paqarta dhe është fokusuar te fakti, që edhe pse e ka mbajtur *cash* në banesë këtë shumë, ashtu sikurse dhe të ardhura të

tjera, duhet t'i merren në konsideratë gjatë analizës financiare, duke mos paraqitur ndonjë argument të ri të ndryshëm nga ato gjatë procesit të rivlerësimit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me konstatimet e rezultateve të hetimit administrativ si më sipër, të cilat janë mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, gjatë procesit të vendimmarrjes.

93. Barra e provës që i ka kaluar subjektit në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë nr. ***, në Korçë, të ardhura nga shitja e pasurisë z. A. P., duket se:

i) Për pasurinë e ndodhur në F., Tiranë, subjekti ka investuar në total vlerën prej 390.000 lekësh për blerjen e tokës + 1.948.169 lekë investim në objekt = 2.338.169 lekë. Këtë pasuri të krijuar në vitin 2008, për të cilën nuk u vërtetua të jetë kryer asnjë investim i ri, ia shiti shtetasit A. P. në vitin 2012, në shumën 135.000 USD, sa shumëfishi i vlerës së investimit, veprime të cilat nuk përputhen me logjikën financiare.

ii) Subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, likuiditete në bankë apo *cash* në DPV-në për vitin 2013, vit gjatë të cilit e tërhoqi shumën prej 134.900 USD, si dhe as në deklaratat vijuese të viteve 2014 dhe 2015, ndërkohë që në procesverbalin e datës 15.6.2016 i pyetur nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar se pasi ka tërhequra këtë shumë (më 5.3.2013, sipas dokumenteve bankare), e ka depozituar në kasafortën e banesës së vëllait P. H. dhe më pas e ka përdorur për nevoja dhe shpenzime të ndryshme të familjes dhe se pjesa e pashpenzuar ka qëndruar në kasafortë, duke e lënë të paqartë sa kanë qenë likuiditetet *cash* të pashpenzuara dhe të padeklaruara përgjatë viteve 2013, 2014, 2015, deri në datën 13.7.2016, kur është blerë pasuria nr. ***, në Korçë.

iii) Sa i takon mundësisë financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurive në Korçë, Komisioni kreu analizën financiare, në dy variante: (a) duke mos e përfshirë; dhe (b) duke e përfshirë shumën prej 134.900 USD, si gjendje likuiditetesh për periudhën 2013 – 2016. Sipas kësaj analize viti 2016 rezultoi me një balancë negative në shumën -18.742.463 lekë në variantin e parë dhe -4.931.401 lekë në variantin e dytë. Në këtë analizë, është përfshirë edhe pasuria nr. ***, në Korçë⁷⁷, për shkak se kjo pasuri është blerë në vitin 2016 dhe se burimi i deklaruar për të dyja këto pasuri është i njëjtë.

94. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

94.1. Sa i takon konstatimit të parë, subjekti pretendon se për pasurinë në F., Tiranë, ka shpenzuar vlerën 390.000 lekë për tokën dhe vlerën 1.660.000 lekë për ndërtimin e banesës. Kurse, në lidhje me diferencën mes çmimit të blerjes dhe shitjes, subjekti ka deklaruar se të gjitha veprimet për këtë pasuri janë kryer me vullnet të lirë dhe të plotë dhe pa asnjë ndikim, prandaj konstatimi i Komisionit për mungesë të logjikës financiare nuk qëndron, duke argumentuar se: (i) kjo pasuri e blerë në vitin 2008 ka qenë e vendosur në një zonë plotësisht të pazhvilluar, pa rrugë e infrastrukturë e cila pas ndërtimit të qendrës tregtare ***, në vitin 2010 – 2011, mori zhvillim; (ii) statusi juridik i kësaj pasuri ndryshoi nga tokë “arë” në tokë “truall”, e cila ka një vlerë më të lartë; (iii) vlerësimi i kësaj pasurie është bërë në një periudhë më të hershme se subjekti të kryente tjetërsimin e saj. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi t'i çmojë bindëse argumentet e subjektit.

⁷⁷Kjo pasuri është trajtuar në pikën 95 të këtij vendimi.

94.2. Sa i takon mosdeklarimit të shumës 134.900 USD përfituar nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, si gjendje likuiditeti *cash* apo në bankë në DPV-në për vitin 2013 deri në vitin 2016, kur bleu pasurinë në Korçë, subjekti ka dhënë përgjithësisht të njëjtat argumente edhe gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe ka kundërshtuar analizën financiare në të dyja variantet duke paraqitur varantin e tij, sipas të cilit nuk rezultojnë balanca negative. Argumentet e përdorura nga subjekti kanë lidhje me pretendimin se edhe pse nuk ka deklaruar kursime *cash* deri në DPV-në për vitin 2016, në fund të çdo viti kalendarik ka pasur mjaftueshëm kursime të krijuara me të ardhura të ligjshme nga pagat, nga aktiviteti i kafe-bar “****”, si dhe shitja e disa pasurive, të cilat i ka mbajtur në banesë dhe se këto kursime duhet të merren në konsideratë nga Komisioni si të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurive në Korçë. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një variant të ri të gjendjeve *cash* në fund të çdo viti, të ndryshme nga ato të paraqitura më parë.

94.3. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, në analizë të çdo deklarimi, pretendimi dhe dokumenti shkresor të paraqitur, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës sa i takon burimit të të ardhurave të përfituara nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, të cilat nuk u përfshinë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare përfundimtare të vitit 2016 pasqyruar në tabelën në vijim⁷⁸.

Përshkrimi	2016
Pasuri	20 642 208
Blerë truall ndërtesë Korçë 100.000 euro	13 527 000
Truall me sip. 50,9 m ² nga kjo ndërtesë 50,9 m ² Korçë, 25.000 euro	3 381 750
Automjet tip “SMART” i këmbyer me automjetin tip “Mercedes-Benz”	2 064 750
Shtesa/Pakësimi/ Likuiditete	1 668 708
Të ardhura	5 928 582
Të ardhura nga paga subjekti	1 433 568
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 587 062
Të ardhura nga biznesi bashkëshortja “bar-kafe”	312 561
Nga këmbimi automjet “Mercedes-Benz” (blerë 15.000 euro)	2 064 750
Nga shitja e automjetit blerë nga *** (blerë 3.855 euro)	530 641
Shpenzime	1 990 612
Shlyer Kredia te “Raiffeisen Bank”	494 163
Shpenzime shkollimi	115 000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	940 368
Shpenzime udhëtimesh	441 081
Mundësia për kursime	-16 704 238

94.4. Siç vërehet, balanca negative ka pësuar përmirësim nga varianti i parë i analizës financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit, pasi është marrë në konsideratë pretendimi i tij lidhur

⁷⁸Analiza e hollësishme e likuiditeteve në *cash* është trajtuar në pikën 99 “Analizë e gjendjes *cash* dhe vlerësimi i Komisionit”, të këtij vendimi.

me njohjen e të ardhurave nga këmbimi i automjetit tip “Mercedes-Benz”⁷⁹ me automjetin tip “Smart”, ku vlera e këmbimit është konsideruar e barabartë me vlerën e blerjes⁸⁰.

94.5. Në përfundim, sa i takon pasurisë nr. ***, në Korçë, blerë në vitin 2016, referuar parashikimit të pikës 5 (germat “a” dhe “b”), të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin, si dhe ka qenë në pamundësi financiare për blerjen e saj me të ardhura të ligjshme.

Pasuri e paluajtshme truall + ndërtesë, Korçë

95. Në deklaratën *Vetting* kjo pasuri është deklaruar: *pasuria nr. ***, me sip. 50.90 m², në Korçë. Vlera: 25.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 4.10.2016; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***. Burimi: (a) kursime nga pagat; (b) shitja e truallit në F., Tiranë, shtetasit A. P.; (c) të ardhura nga biznesi të depozituara në bankë.*

Për këtë pasuri ILDKPKI-ja ka konstatuar:

- Mosdeklarime, ndër vite, referuar kursimeve *cash*, gjendjeve të akumuluar të tyre dhe deklarime të pasakta referuar përdorimeve të gjendjes *cash*.

- Fshehje e shumës së investuar për ndërtimin e banesës njëkatëshe në F., P., si në deklaratat e interesave private në ILDKPKI gjatë periudhës 2008 – 2011, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, si dhe mungesë dokumentacioni justifikues përkatës të ndërtimit. Ky fakt do të shërbente edhe për llogaritjen e të ardhurave neto nga transaksioni me tokën në F., blerje-ndërtim-shitje.

- Mungesë burimi të ligjshëm financiar për shumën e investuar për banesën në F., Petrelë, për periudhën 2008 – 2011, në shumën minimale prej 2.500.000 lekësh, duke llogaritur 70 m² ndërtim, me çmime të EKB-së.

- Dyshime për rritje joreale në shumëfish të çmimit blerje/shitje të tokës në F. dhe/ose investimet në tokën e blerë janë në shuma të konsiderueshme.

96. Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

96.1. Në lidhje me statusin aktual të kësaj pasurie, gjatë hetimit administrativ rezultoi:

- ASHK-ja Korçë⁸¹ informoi se shtetasi Kolë N. Hysenaj është bashkëpronar me ½ pjesë te pasuria nr. ***, e llojit truall me sip. totale 50.9 m² nga të cilat 50.9 m² janë ndërtesë.

- OSHEE-ja⁸² informoi se shtetasi Kolë N. Hysenaj është abonent dhe ka kontratë furnizimi me energji me nr. ***, në instancën Korçë, me datë hapje 10.8.2005, ndryshuar emri i abonentit më 24.8.2016.

Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan të dhëna që subjekti të ketë përdorur rregullisht këtë pasuri apo të ketë kryer investime mbi të.

⁷⁹Me rezultatet e hetimit dërguar subjektit, nuk është njohur si e ardhur çmimi i blerjes së automjetit “Mercedes-Benz” në vlerën 15,000 euro, blerë në 2015 dhe këmbyer me automjetin tip “Smart” në vitin 2016, pasi nga analiza financiare kishte rezultuar se subjekti nuk kishte mundësi financiare për blerjen e mjetit “Mercedes-Benz” në vitin 2015, duke penalizuar kështu subjektin 2 herë.

⁸⁰Kjo çështje është trajtuar në pikat 79.2 dhe 81.7 të këtij vendimi.

⁸¹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.5.2019, në dosjen e Komisionit.

⁸²Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 25.4.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

96.2. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit, nga aktet⁸³ në dosje rezultoi se:

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 15.11.2011, si dhe kartelës së pasurisë, vërtetohet se në ZVRPP-në Korçë është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Th. O., etj. (12 persona), pasuria nr. *** e llojit truall me sip. 50.90 m², nga e cila 50.90 m² ndërtesë.

- Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.10.2016, shtetasi Kolë Hysenaj bleu pasurinë nr. ***, me çmim 25.000 euro, vlerë e kaluar në llogarinë e noterit në BKT-në Korçë, me aktin depozitim për të tretë në “Raiffeisen Bank” në datën 4.10.2016. Kjo pasuri është deklaruar saktësisht në deklaratën për vitin 2016.

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 18.10.2016, pasuria me nr. ***, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve D. e Kolë Hysenaj.

- Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan elemente të trajtimit në mënyrë preferenciale të subjektit për blerjen e kësaj pasurie, pasi: (i) sipas EKB-së çmimi/m², në Korçë, në vitin 2016, ka qenë në vlerën 32.381 lekë/ m². Pra, ndërtesa me sip. 50.9 m² sipas EKB-së do të kushtonte 1.648.193 lekë; (ii) sipas VKM-së nr. 89/2016, vlera e pasurisë tokë truall në qytetin e Korçës ka qenë 9.055 lekë/m². Pra, pasuria truall me sip. 50.9 m² do të kushtonte 460.900 lekë. Në total truall 316 m² +ndërtesë 146.6 m² do të kushtonte 2.109.092 lekë, ndërkohë që subjekti e ka blerë në vlerën 25.000 euro.

96.3. Në lidhje me burimin e krijimit

96.3.1. Si burim krijimi i kësaj pasurie janë deklaruar: (a) kursime nga pagat; (b) shitja e truallit në F., Tiranë, shtetasit A. P.; (c) të ardhura nga biznesi të depozituara në bankë por nuk janë specifikuar shumat përkatëse për secilin burim. Nga hetimi administrativ rezultoi se nga shuma prej 128.000 euro, të cilat subjekti i ka derdhur *cash* në datën 1.7.2016, pra, një javë përpara se të lidhej kontrata e shitjes më 13.7.2016: (i) shuma 100.000 euro është përdorur për blerjen e pasurisë trajtuar më sipër në këtë vendim; dhe (ii) shuma prej 25.000 euro, është përdorur për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi.

96.3.2. Në përfundim të procesit, duke qenë se si burim krijimi të pasurisë objekt shqyrtimi nr. ***, në Korçë, janë deklaruar të njëjtat burime si për pasurinë nr. ***, në Korçë, trajtuar më sipër, si dhe në kushtet kur të dyja pasuritë janë blerë në vitin 2016, analiza financiare për të dyja pasuritë është pasqyruar në të njëjtën tabelë të treguar në përfundim të analizës së pasurisë nr. ***, për rrjedhje, subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

97. DETYRIME FINANCIARE

Në rubrikën detyrime financiare është deklaruar kredi bankare dhe hipoteke marrë në vitin 2011, si dhe ndryshimet e gjendjes së detyrimit pas çdo viti deri në janar të vitit 2017. Deri në datën 24.1.2017, detyrimi i mbetur pashlyer është në shumën 3.765.263 lekë. Kredia është trajtuar më sipër si burim për pasurinë nr. ***, me sip. 2.000 m², B., Tiranë. Në përfundim të hetimit administrativ, për sa i takon shlyerjes së kredisë me të ardhura të ligjshme, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i kaloi barra e provës, pasi duket se nga analiza financiare e viteve 2011, 2014, 2015 dhe 2016, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet për shlyerjen e kredisë. Në parashtrimet e tij, subjekti nuk

⁸³Shihni aktet në aneksin 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

ka dhënë sqarime lidhur me këtë barrë prove, por ka dhënë sqarime në lidhje me të gjitha balancat negative të rezultuara, ndër vite (trajtuar hollësisht në këtë vendim).

98. Deklarime të personave të lidhur

Znj. D. H. (bashkëshortja), z. D. H. (djali i subjektit) dhe znj. D. H. vajza e subjektit, kanë plotësuar formularët e deklaramit të pasurive, nga ku nuk kanë rezultuar problematika. Në emër të këtyre personave nuk kanë rezultuar pasuri të tjera të ndryshme nga ato të deklaruara prej tyre.

99. Analizë e gjendjeve *cash* dhe vlerësimi i Komisionit

99.1. Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

Gjatë të gjithë procesit të rivlerësimit, subjekti ka pretenduar se për të gjitha pasuritë e krijuara prej tij ka pasur të ardhura të ligjshme me burim gjendjen e kursimeve *cash* të krijuara nga pagat, biznesi dhe shitja e pasurive të ndryshme, të akumuluar dhe të mbartura nga viti në vit. Për një vlerësim sa me objektiv të kursimeve të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, janë kryer veprimet hetimore si vijojnë:

99.2. U verifikuan DPV-të për të gjithë periudhën 2003 – 2016, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar gjendje apo shtesa/pakësime të likuiditetit *cash* deri në vitin 2016, për të cilin ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 10.000 euro. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me mosdeklarimin e likuiditeteve të gjendjes *cash* në fund të çdo viti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, z. Kol Hysenaj ka deklaruar se: “...për shkak se formulari i deklaramit të pasurisë ka ndryshuar në shumë raste ka qenë e paqartë edhe mënyra e deklaramit të likuiditeteve gjendje në fund të çdo viti.... duke supozuar se meqë në fund të çdo viti janë deklaruar rregullisht të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet, kam menduar se përbënte deduksion teprica financiare e çdo viti, duke mos deklaruar kështu në mënyre eksplicite kursimet që kanë rezultuar në fund të çdo viti”. Më tej, ka sqaruar se lidhur me këtë fakt ka dhënë shpjegime më herët edhe në ILDKPKI, ku është përpjekur që mbi kalkulime të çastit, të japë në mënyrë të përafërt shuma të cilat kanë qenë kursimet e çdo fund viti të familjes së tij. Ndërkohë, me pyetësorin nr. 2, ka paraqitur aktin e ekspertimit të datës 23.12.2019, hartuar nga kontabël i miratuar E. S., ku janë pasqyruar gjendjet *cash* në fund të çdo viti.

99.3. Pas verifikimeve, ku u konstatua se në këtë aktekspertim, është kryer analiza financiare vjetore e subjektit për periudhën 2002 – 2018, bazuar në metodologjinë kumulative. Sipas këtij akti, janë paraqitur gjendjet e kursimeve *cash* për çdo fundvit, ku tepricat pozitive të rezultuara në fund të çdo viti, janë të transferuara në vitin pasardhës dhe të akumuluar nga viti në vit, si “likuiditete të lira”, që disponohen nga subjekti dhe që kanë shërbyer për blerjen e çdo pasurie prej tij

99.4. U verifikuan deklaramet e subjektit pranë ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 15.6.2016, ku subjekti ka deklaruar: “... nuk i kam deklaruar shtesat e mia në kursime vit pas viti pasi kam menduar se duke deklaruar të ardhurat ka qenë një llogari që bëhej lehtë dhe quhej automatikisht e shtuar...nuk kam patur shpenzime ekstra për kënaqësi tonat apo shëndetësore. I kam marrë të mirëqena, tani që më kërkohet sqarimi po i jap.... Në disa deklarata nuk i kam deklaruar të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes por kërkohet të merret parasysh... prej vitit 1992 unë dhe 1993 bashkëshortja kemi qenë në marrëdhënie pune të vazhdueshme...”. Gjithashtu, i pyetur në lidhje me shumën 135.000 USD, të përfutur nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, subjekti ka deklaruar se pasi e ka konvertuar këtë shumë në

130.000 euro, e ka mbajtur në kasafortë, në banesën e të vëllait P. H., në L., ku në fund të vitit 2014 ka pasur shumën 130.000 euro. Të njëjtën gjë ka pretenduar edhe për shumën 22.000 euro të përfituar nga shitja e automjetit në vitin 2020 te shtetasi G. H..

99.5. Në përfundim të hetimit administrativ, u konstatuan mospërputhje në deklarinimin e gjendjeve *cash* të çdo viti në ILDKPKI, sipas procesverbalit të datës 15.6.2016, krahasuar me deklarinimet gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

99.6. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i janë bërë me dije mospërputhjet në gjendjet e likuiditeteve në *cash* në fund të çdo viti duke iu kërkuar sqarime. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur të njëjtat argumente, duke përmendur edhe njëherë deklarinimet e tij në ILDKPKI dhe aktekspertimin e datës 23.12.2019, duke theksuar se: *“...në fund të çdo viti kam realizuar kursime të cilat më janë mundësuar nga të ardhurat e mija të ligjshme të realizuara nga pagat, biznesi dhe diferenca pozitive nga shitblerja e pasurive të ndryshme. Këto të ardhura të realizuara prej meje, kanë qenë të kursyera në fund të çdo viti dhe janë përdorur për krijimin e pasurive përgjatë viteve, duke veçuar këtu, blerjen e pasurisë së ndodhur në B., Tiranë, si edhe nga kursimet e viteve 2003-2010, si dhe pasuritë e blera në Korçë, të cilat janë krijuar nga kursimet e viteve 2011–2015 duke përfshirë në kursimet e këtyre viteve edhe shitjen e pasurisë së ndodhur në Fikas në shumën prej 135.000 USD. Fakti i pasjes së kursimeve në fund të çdo viti, ka qenë edhe arsyeja që për krijimin e pasurive të mija gjatë viteve, kam cituar shpesh si burim krijimi të tyre, kursimet ndër vite...vlera prej 135.000 USD...ka qëndruar si kursim së bashku me të ardhurat e tjera. Sigurisht që është përdorur në momente të ndryshme të viteve për shpenzime familjare dhe blerje të ndryshme, por nuk mundem dot të përcaktoj vlerën e konsumuar apo të mbetur të saj, sepse pavarësisht se ajo është përfituar nga një transaksion i vetëm, blerjet, shpenzimet dhe kursimet familjare janë kryer së bashku dhe jo të ndara. Ajo që mund të them dhe shpjegoj për komisionin është se, kjo shumë, së bashku me kursimet ndër vite nga pagat, dhe biznesi, pas shpjegimeve të dhëna në Inspektorat dhe kërkesës së këtij të fundit për t’i arkëtuar në bankë të gjitha kursimet që disponoja, i kam depozituar ato në llogarinë time në ‘Raiffeisen Bank’ në korrik të vitit 2016. Nga ky depozitim dhe mbi vlerën e këtyre kursimeve kam realizuar blerjen e dy pasurive në Korçë, në vlerën totale prej 125.000 euro”.*

99.7. Me riçeljen e hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar një situatë të re të gjendjes *cash* në fund të çdo viti, duke vijuar të jetë konfuz dhe jokonsistent në deklarime. Kjo situatë e re, është në fakt “mundësia për kursime” e çdo viti kalendarik, e cila ka rezultuar nga një analizë e re financiare të cilën subjekti e ka vënë në dispozicion të Komisionit me parashtrimet e tij, duke kundërshtuar e rezultatet e hetimit shtesë.

Siç vërehet, në gjitha rastet, deklarinimet e kursimeve të pretenduara gjendje *cash* në fund të çdo viti, janë të ndryshme nga njëra-tjetra, pasqyruar si në tabelën në vijim:

Vitet	Gjendja e likuiditeteve <i>cash</i> të deklaruara në DPV (I)	Gjendja e likuiditeteve <i>cash</i> të deklaruara në procesverbalin e ILDKPKI-së në lekë (II)	Gjendja e likuiditeteve <i>cash</i> sipas aktit të ekspertimit të vënë në dispozicion nga subjekti në përgjigje të pyetësorit në lekë (III)	Gjendja e likuiditeteve <i>cash</i> paraqitur me parashtrimet e rezultateve shtesë në lekë (IV)
2002	-	-	1 600 000	
2003	-	350 000	242 741	596 728
2004	-	1 222 000	874 872	1 166 082
2005	-	2 147 000	1 507 100	1 422 432
2006	-	2 599 000	1 965 877	2 062 527
2007	-	3 031 000	2 611 913	3 139 204
2008	-	3 814 000	4 105 545	3 562 391
2009	-	5 614 000	5 101 771	4 295 257
2010	-	9 276 681	8 444 117	8 023 170
2011	-	10 872 341	4 293 704	3 152 277
2012	-	11 948 100	4 558 643	4 247 018
2013	-	25 489 486	18 165 019	4 120 693
2014	-	26 593 868	18 346 309	3 805 531
2015	-	- ⁸⁴	18 474 711	4 217 571
2016	10 000/euro	-	3 857 254	2 916 846

99.8. Arsyetim ligjor bazuar në ligjin e zbatueshëm në lidhje me faktet e konstatuara

Në analizën financiare të kryer në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit duke konsideruar si gjendje *cash* ato të deklaruara nga subjekti në DPV-të për vitet 2003 – 2016, arsyetuar si vijon:

99.9. Sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, “afati dhe objekti i deklarimit”, subjektet detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, detyrimeve financiare, vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, etj.

99.10. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***, datë 16.4.2018⁸⁵, ka konfirmuar detyrimin e subjekteve për të deklaruar kursimet *cash*, duke sqaruar, ndër të tjera, se: “... në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, përcaktohet shprehimisht objekti i deklarimit nga subjektet, si vijon.

Në nenin 4 ‘Afati dhe objekti i deklarimi, subjektet detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj...’.

⁸⁴Në këtë procesverbal subjekti ka deklaruar kursimet e tij *cash* nga viti 2003 deri në vitin 2014.

⁸⁵Shihni shkresën në dosjen e Komisionit.

99.11. Subjekti gjatë gjithë procesit të rivlerësimit pretendon se si burim i ligjshëm për krijimin e pasurive kanë shërbyer kursimet, ndër vite, të mbajtura *cash*, të cilat nuk i ka deklaruar sipas detyrimit ligjor në DPV-të përkatëse deri në vitin 2016. Pretendimi se mosdeklarimi i gjendjeve në *cash* ka ndodhur për shkak se formulari i deklarimit të pasurisë ka ndryshuar në shumë raste dhe se në shumë raste ka qenë e paqartë mënyra e deklarimit të likuiditeteve gjendje në fund të çdo viti nuk qëndron, pasi objekti i deklarimit të pasurive ka qenë parashikuar qartë në nenin 4 të ligjit nr. 9049. Gjithashtu, edhe formulari i deklarimit të pasurisë është tepër i qartë pasi: (i) në rubrikën “likuiditete” jepen shpjegime të qarta se në këtë rubrikë duhet të pasqyrohet gjendja e likuiditeteve *cash*, llogari rrjedhëse, depozitë etj.; (ii) në rubrikën “deklarimi i interesave private” ndryshuar më pas në “ndryshimet e interesave private”, kërkohet të deklarohen shtesat dhe ndryshimet e interesave pasurore, përfshirë gjendjen *cash*, llogari rrjedhëse, depozitë etj., duke mos lënë vend për paqartësi në plotësimin e tyre. Për më tepër, ndryshimet që kanë pësuar formularët apo paqartësitë e pretenduara nga subjekti, nuk e zhveshin subjektin nga përmbushja e detyrimit ligjor për plotësimin e saktë të tyre, në kushtet kur ka pasur gjithë mundësinë për t’u informuar dhe konsultuar paraprakisht me ligjin apo dhe me subjekte kompetente, me qëllim kryerjen e deklarimeve sa më të sakta dhe në përputhje me ligjin të çdo interesi pasuror, ashtu sikurse ka vepruar një pjesë e konsiderueshme e subjekteve deklarues.

99.12. Sa i takon pretendimit të subjektit se: “... duke supozuar se meqë në fund të çdo viti janë deklaruar rregullisht të ardhurat, detyrimet dhe shpenzimet, kursimet janë ato që kanë rezultuar në fund çdo viti”, nuk qëndron, pasi, përpos faktit që subjekti nuk ka deklaruar në asnjë prej DPV-ve shpenzime të çdo lloji, ligji është tepër i qartë duke u kërkuar subjekteve që për çdo vit të deklarojnë jo vetëm pasuritë, të ardhurat, detyrimet, shpenzimet, por dhe gjendjet apo shtesat/pakësimet e likuiditeteve *cash* apo në bankë. Në këto kushte, deklarimi i të ardhurave përgjatë çdo viti kalendarik, nuk supozon që këto të ardhura minus shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe shpenzimet për blerjen e pasurive, të përbejnë kursimet në *cash* në fund të vitit. Është e vërtetë që subjekti mund të ketë pasur mundësi për të kursyer të ardhura në fund të çdo viti kalendarik, por në asnjë prej DPV-ve nuk ka deklaruar kursime *cash*, shpenzime, shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash* apo në banka për shkak të investimeve që ka kryer ndër vite, ashtu sikurse ligji parashikon. Vetëm DPV të plotësuara me saktësi dhe sipas kriteve të parashikuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, do të përbënin provën shkresore që do të vërtetonte shumën e likuiditeteve *cash* të kursyera për çdo vit”.

99.13. Në vijim të argumenteve të mësipërme, në vlerësimin e tij përfundimtar, Komisioni i referohet deklarimeve të subjektit lidhur me shumën 135.000 USD përfituar në vitin 2013 nga shitja e një pasurie në F., Tiranë, të cilën pretendon që ta ketë përdorur si burim për blerjen e dy pasurive në Korçë në vitin 2016, si dhe deklarimeve për shumën 22.000 euro përfituar nga shitja e një mjeti në vitin 2010, pretenduar si burim për blerjen e një mjeti në vitin 2015. Gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, ashtu sikurse dhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se, si shumën prej 22.000 euro, ashtu shumën 135.000 USD, e mbajti në kasafortën e vëllait, pasi në atë kohë qarkullonin fjalë se bankat do të shkonin në prag falimenti, siç kishte ndodhur me bankat në Greqi. Po kështu, subjekti i është referuar interesave të ulëta që ofronin bankat dhe, për këtë arsye, nuk kishte arsye që t’i mbante të bllokuara me afate të gjata *maturimi*, kjo edhe për shkak të kërkesave në rritje të fëmijëve, si dhe kostos në rritje të jetesës.

99.14. Pavarësisht se nuk ka asnjë të dhënë zyrtare që të hedhë dritë mbi pretendimin se në periudhat që subjekti pretendon, bankat kanë qenë në prag falimentimi, është e drejta e çdo individit që kursimet e tij t’i depozitojë në banka ose jo. Por, argumentet e paraqitura nga

subjekti i rivlerësimit, nuk justifikojnë në asnjë rast mospërbushjen e detyrimit ligjor për të deklaruar kursimet në formë likuiditetesh në *cash*, si dhe shtesat apo pakësimin e tyre në rastet kur janë përdorur për blerjen e pasurive, pasi kjo do të ishte e vetmja provë që do të vërtetonte disponimin e këtyre likuiditeteve në fund të çdo viti, si dhe vlerat përkatëse.

99.15. Në deklaratimet pranë ILDKPKI-së, por edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se prej shumës 135.000 USD dhe të ardhura të tjera të mbajtura në kasaforte në formë kursimesh, një pjesë e ka përdorur për shpenzime të ndryshme në momente të ndryshme të viteve për nevoja familjare apo blerje të ndryshme, por nuk mundet të përcaktojë vlerën e konsumuar apo të mbetur të saj. Sot, me të drejtë, subjekti nuk mund të kujtojë sa kane qenë kursimet *cash* në fund të çdo viti për shkak të kohës të gjatë që ka kaluar apo se nuk ka mbajtur shënime siç deklaroi në seancën dëgjimore të datës 15.04.2021, e për këtë arsye ka qenë konfuz dhe kontradiktor në deklaratime. Në këto kushte, edhe në rastin që do të merreshin të mirëqena pretendimet e subjektit lidhur me mbajtjen e kursimeve në banesë jashtë sistemit bankar, Komisioni është në pamundësi objektive për përlllogaritjen e kursimeve të mbetura në fund të çdo viti pas shpenzimeve të kryera, pasi, ashtu sikurse edhe subjekti, është në padijeni të vlerës së tyre. Kjo është arsyeja që ligji ka parashikuar detyrimin e subjekteve për të deklaruar në fund të çdo viti gjendjet *cash*, shtesat dhe pakësimet e tyre, detyrim që subjekti nuk e ka përmbushur në mënyrë sistematike gjatë gjithë viteve deri në vitin 2016.

99.16. Sa i takon detyrimin të deklarimit të saktë të gjendjeve *cash*, shtesave ose pakësimeve të gjendjes *cash* në fund të çdo viti, përveç se është një detyrim i parashikuar nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁸⁶ është tashmë e konsoliduar dhe e aplikuar në disa subjekte rivlerësimi me situata të ngjashme. Konkretisht, në vendimin (JR) nr. 27, datë 22.10.2020, Kolegji, ndër të tjera, arsyeton se: “ ... në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit (*shih vendimet nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019 etj.*), në kushtet kur shpjegimet mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike vjetore, të cilat konsiderohen provë në procesin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe së bashku me deklaratën Vetting përbëjnë të vetmen mënyrë verifikimi të ekzistencës së kësaj pasurie në funksion të procesit të rivlerësimit... ndërsa deklaratimet periodike vjetore përbëjnë dokument zyrtar sipas ligjit dhe janë të vetmet referenca të ekzistencës së likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar, dhe kanë vlerë prove në procesin e rivlerësimit [në zbatim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, analiza e deklaratës Vetting dhe e shpjegimeve të subjekteve në proces përkundër deklaratave periodike është esenciale në vlerësimin e krijimit të pasurive në analizë të mundësive të krijimit me burime të ligjshme”

99.17. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, për të gjitha sa është arsyetuar më sipër, kursimet e pretenduara *cash* por të pavërtetuara, për më tepër të deklaruara në vlera të ndryshme në deklaratime të ndryshme të subjektit, nuk janë marrë në konsideratë si të ardhura ligjore në analizën financiare përfundimtare.

100. Të ardhurat nga bar-kafe “*”**

⁸⁶Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendime lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të prg. 27; (JR) nr. 19/2019 në prg. 84; (JR) nr. 20/2019 në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019 në prg. 31.

Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ⁸⁷, u konstatua se:

100.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar aktivitet privat bar-kafe “****”, Person Fizik, “D. H.” (bashkëshortja), me ***, datë 18.6.2009. Lokal i marrë me qira shtetas T. D.⁸⁸. Shuma e të ardhurave: 6.011.459 lekë.

100.2. Me vendimin datë 17.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin si Person Fizik “D. H.” është regjistruar për të ushtruar aktivitet privat në fushën bar-kafe. Aktiviteti është ushtruar në pasurinë në pronësi të znj. T. D., për të cilën subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së 4 kontrata qiraje.

100.3. Në të gjitha DPV-të subjekti ka deklaruar të ardhura nga ky aktivitet për vitet 2007 – 2016, shuma e të cilave rezulton të jetë 17.212.561 lekë, e cila nuk përputhet me shumën prej 6.011.459 lekësh të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Nga verifikimi i dokumenteve të zyrës së tatimeve, konstatohet që në shumicën e viteve subjekti ka deklaruar qarkullimin si të ardhur në vend të fitimit, dhe ky duhet të ketë qenë shkaku i mospërputhjes në deklarime.

100.4. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 26.1.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të ardhurat e fituara për vitet 2007 - 2016, kanë qenë në shumën 5.730.082 lekë. Në këtë shkresë, për vitin 2007 është dhënë informacion vetëm për qarkullimin dhe jo për fitimin. Komisioni, për të vlerësuar fitimin për këtë vit, ka bërë llogaritje me metodë alternative, duke marrë për bazë mesataren e normës së fitimit të 3 viteve më pas dhe ka rezultuar se fitimi nga të ardhurat e biznesit për vitin 2007 ka qenë në shumën 1.320.000 lekë. Vërehet se shuma totale e fitimit të llogaritur si më sipër është e përafërt me atë të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

100.5. Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat e aktivitetit privat nga bar-kafe “****” gjatë viteve 2007 – 2016 ishin llogaritur në shumën 6.251.459 lekë. Kjo përlllogaritje ishte kryer bazuar në informacionin e marrë nga DRT-ja Tiranë dhe konkretisht shkresa nr. *** prot., datë 11.9.2017, e vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja dhe shkresa nr. *** prot., datë 12.2.2020, e vënë në dispozicion të Komisionit.

100.6. Pas riçeljes së hetimit administrativ, Komisioni evidentoi se këto shkresa përmbanin informacione të ndryshme dhe kontradiktore dhe për këtë arsye u kërkuan shpjegime nga DRT-ja Tiranë lidhur me: (i) shkakun e të dhënave të ndryshme në dy shkresa të ndryshme; si dhe (ii) të dhëna mbi të ardhurat e aktivitetit të Personit Fizik “D. H.”.

100.7. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DRT-ja Tiranë ka vënë në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2020, e cila ka informuar se: “Me shkresën nr. *** prot., datë 11.9.2017, dërguar në ILDKPKI është dhënë informacion për vitet ushtrimore 2008 - 2014, periudhë në të cilën nga ana e tatimpaguesit nuk ka pasur dokumentacion në sistemin elektronik tatimor, por nëpërmjet dokumentacionit të nxjerrë nga arkiva. Ky informacion është depozituar nga subjekti me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2017 (shkresë e administruar edhe nga Komisioni), ku bashkëlidhur janë pasqyra (bilance) të viteve 2007 - 2014 dhe informacioni i vënë në dispozicion të ILDKPKI-së është dhënë duke u bazuar në këtë shkresë. Ky informacion nuk ka një deklaratë tatimore apo pagesë të kryer dhe dorëzuar në organet tatimore në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’, por janë

⁸⁷Shihni dokumentet në anekset nr. 33 dhe nr. 34 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁸Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 10.1.1996, në emër të znj. T. D. rezulton e regjistruar pasuria truall me sip. 76 m² mbi të cilin është ndërtuar njësi tregtare nr. ***, me sip. 76 m².

pasqyra financiare të thjeshta (balance), pasi ky subjekt nuk ka qenë i regjistruar për deklaratën e 'Tatimi mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël'. Për këtë shkak ky informacion nuk është evidentuar në shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2020, dërguar Komisionit”.

100.8. Për sa i takon të ardhurave të subjektit “D. H.”, me NIPT ***, DRT-ja Tiranë informoi se: (i) ky subjekt është i regjistruar si biznes i vogël dhe nga viti 2007 deri më 31.12.2013 tatimi i thjeshtuar mbi fitimin paguhej në organet e pushtetit lokal (bashki), për këtë arsye nuk mund të konfirmojnë pagesat e kryera në lidhje me fitimet e këtyre periudhave; (ii) për vitet 2011 - 2015 subjekti ka qenë me status “pasiv, si rezultat, për këtë periudhë nuk ka pasur fitim; (iii) ndërsa për vitin 2015 e në vijim, deri në shtator të vitit 2020 qarkullimi dhe fitimi për këtë Person Fizik paraqiten si vijon:

Vitet	Qarkullimi	Fitimi	Tatimi i paguar	Fitimi pas tatimit
2015	1 111588	252 068	25 000	227 068
2016	2 111 234	312 561	0	312 561
2017	2 914 372	540 442	0	540 442
2018	2 117 630	323 186	0	323 186
2019	3 661 456	1 745 229		1 745 229
9/2020	2 736 366			

100.9. Më tej, DRT-ja Tiranë ka informuar se subjekti nuk shpërndan dividend sepse në bazë të UMF-së nr. 5, datë 30.1.2006, nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë në lidhje me destinimin e fitimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. Për vitet 2015 dhe 2016 subjekti ka pasur të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore nga aktiviteti bar-kafe “****”, në shumën 539.629 lekë⁸⁹.

100.10. Për sa më sipër, në total, të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për vitet 2007 - 2016 rezultuan në shumën 539.629 lekë dhe jo 6.251.459 lekë, sa ishin përlogaritur të ardhurat e biznesit bar-kafe “****” dhe dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ. Për rrjedhojë, në analizën financiare u përfshi vetëm shuma 539.629 lekë, e cila afektoi këtë analizë dërguar subjektit me rezultatet e hetimit shtesë administrativ.

100.11. Me njoftimin e rezultateve të hetimit shtesë administrativ, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar dhe dokumentuar të ardhurat e bar-kafe “****”, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, duke vënë në dispozicion dokumentacion provues për këto pagesa nga organet e pushtetit lokal (bashki), si dhe çdo institucion tjetër kompetent. Pas njohjes me rezultatet e hetimit shtesë, subjekti parashtrroi se sipas legjislacionit tatimor të kohës bizneset e vogla ku klasifikohet edhe bar-kafe “****”, për vitet 2007 – 2014 deklarorin dhe paguanin tatimet dhe taksat pranë organeve vendore (bashkive). Sipas tij, bar-kafe “****” ka zhvilluar normalisht aktivitetin tregtar për vitet 2007 – 2014, duke kryer rregullisht deklaratimet për xhiron dhe duke paguar detyrimet pranë Bashkisë Tiranë. Po ashtu, bashkëshortja e tij, si administratore e bar-kafe “****”, apo ndonjë person i autorizuar prej saj, nuk kanë aplikuar asnjëherë të ndryshojnë statusin e këtij biznesi në “pasiv”.

⁸⁹Gjithashtu, kjo shkresë informon se subjekti ka detyrime të pashlyera deri në datën 15.10.2020, në vlerën 716.610 lekë, të cilat përbëhen nga TVSH-ja, detyrime ndaj sigurimeve shoqërore dhe gjoba, por jo detyrime që lidhen me tatim-fitimin.

100.12. Subjekti i vërtetoi pretendimet e tij nëpërmjet disa dokumenteve shkresore⁹⁰, nga analiza e të cilave rezultoi se: (i) bar-kafe “***” ka zhvilluar aktivitetin në të njëjtën adresë nga regjistrimi i aktivitetit dhe deri sot. Nga konsumi i energjisë elektrike duket se në këtë ambient/lokal është zhvilluar aktivitet në mënyrë të pandërprerë; (ii) ky biznes ka deklaruar qarkullimin dhe ka paguar rregullisht detyrimet pranë organeve vendore, sikurse e parashikuar për biznesin e vogël (xhiro vjetore deri në 2.000.000 lekë) nga legjislacioni tatimor i kohës; (iii) nga ekstrakti historik në QKB nuk rezulton që ky biznes të ketë kaluar nga status “aktiv” në “pasiv” që nga data e regjistrimit deri aktualisht; (iv) informacioni kontradiktor i sjellë nga DRT-ja Tiranë në lidhje me statusin “pasiv” të aktivitetit është trajtuar si një gabim i informuar nga ky institucion gjatë hetimit administrativ, ndërkohë që ky biznes i vogël nuk ka detyrime të paguara deri më 31.12.2017.

100.13. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se subjekti arriti të kundërshtojë barrën e provës dhe të marrë në konsideratë në analizën financiare përfundimtare të ardhurat nga bar-kafe “***” për vitet 2007 – 2016, sipas pretendimeve të tij, në shumën prej 5.986.459 lekësh⁹¹.

101. Konstatime të tjera

101. 1. Në deklaratën për vitin 2015, subjekti ka deklaruar dy kontrata shitblerjeje automjetesh, si vijojnë:

- Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 5.2.2014, për automjet tip “Benz-Mercedes”, me targa ***, me palë shitëse D. M. dhe blerës Kolë Hysenaj dhe D. H., në shumën 7.000 euro, likuiduar *cash*.

- Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.11.2015, me palë shitëse Kolë Hysenaj dhe blerës Gj. S., në shumën 15.000 euro. Edhe pse subjekti nuk e ka deklaruar këtë automjet si burim për blerjen e ndonjë pasurie, duke qenë se me kontratën e shitjes vërtetohet përfitimi i të ardhurës prej 15.000 euro, pas verifikimeve, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se:

101.2. Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin me targa ***, me kontratën e datës 5.2.2014, për shkak të një balance negative prej 885.806 lekësh. Me kalimin e barrës së provës, subjekti e kundërshtoi këtë konstatim me prapësimin se është logjike që blerja e automjetit kurrësi nuk mund të jetë financuar me të ardhurat vetëm të muajit janar të vitit 2014, por është financuar nga kursimet më të hershme, së paku të një viti më të hershëm,

⁹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 3.12.2020, e Bashkisë Tiranë, e cila na informon se qarkullimi vjetor i realizuar është deri në 2.000.000 lekë dhe konfirmon pagesën e detyrimeve të tarifave dhe taksave vendore për vitet 2007 - 2014; shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020, e DRT-së Tiranë; ekstrakt historik nga QKB-ja për Personin Fizik bar-kafe “***”, në të cilin nuk evidentohet ndryshimi i statusit në “pasiv” nga data e themelimit deri më 15.3.2021 (data e printimit të këtij ekstrakti); njoftim mbi detyrimet për pagesën e tatimeve dhe taksave nga bar-kafe “***” dhe mandatpagesat e shlyerjes së këtyre detyrimeve, për vitet 2007 – 2014; kontratë noteriale qiraje datë 12.1.2020, me afat 2-vjeçar, midis shtetaseve T. D. dhe D. H., për ambientin 76 m², në adresën H. H. D., Tiranë; ekstrakt elektronik nga OSHEE-ja për pagesat e energjisë elektrike për përdoruesen T. D. (pronare e dyqanit); shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, e OSSH-së, e cila informon për historikun e konsumit të energjisë elektrike për periudhën maj 2007 – dhjetor 2020, për konsumatorin T. D.; kopje të librezës së UKT-së me konsumin e ujit dhe pagesat për vitet 2010 – 2012 për konsumatorin T. D..

⁹¹Të ardhurat totale të bar-kafe “***” ndryshojnë nga ato të rezultateve të hetimit për shkak të fitimit të vitit 2007, i cili në rezultatet e hetimit administrativ ishte përlogaritur nga Komisioni për shkak të mungesës së informacionit për fitimin e vitit 2007, në vlerën 1.320.000 lekë, duke marrë për bazë mesataren e normës së fitimit të 3 viteve më pas. Ndërsa, me riçeljen e hetimit, Komisioni mori informacion nga DRT-ja Tiranë mbi fitimin për vitin 2007, i cili është në vlerën 1.080.000 lekë.

pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë, përderisa nga subjekti nuk janë deklaruar kursime në *cash* apo në bankë.

101.3. Subjekti e ka shitur automjetin e sipërpërmendur me targa ***, në vitin 2015, me çmimin 15.000 euro, me anë të kontratës nr. ***, datë 26.11.2015, dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka vërtetuar se shtetasi Kolë Hysenaj ka paguar në vitin 2019 detyrimet tatimore për të ardhurat nga shitja e tij. Në përfundim të hetimit administrativ, shuma 15.000 euro nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme për vitin 2015, i cili rezultoi me një balancë negative prej 1.660.060 lekësh⁹².

Përshkrimi	2015
Pasuri	2 287 033
Automjet Mercedes Benz 15.000 euro ***	2 064 750
Automjet blerë nga *** 3.855 euro shitur 5.000 euro	530 641
SHTESA/PAKESIME LIKUIDITETE	-308 357
Detyrime	-277 698
Shlyerje kredie në Raiffeisen Bank	-277 698
Pasuri neto (1-2)	2 564 731
Të ardhura	3 084 671
Të ardhura nga paga Subjekti	1 284 453
Të ardhura nga paga bashkëshortja	1 548 150
Të ardhura nga biznesi bashkëshortja bar kafe	252 068
Shpenzime	2 180 000
Interesa kredia 5.000.000 lekë Raiffeisen Bank	234 610
Shpenzime pushimesh	757 075
Shpenzime shkollimi	80 000
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	897 104
Shpenzim shkollimi Kole Hysenaj Instit Stud Europiane	75 000
Shpenzime udhëtimesh	136 211
Mundësia për kursime	-1 660 060

101.4. Me kalimin e barrës së provës, subjekti kundërshtoi analizën financiare, me pretendimin se duhet t'i merren në konsideratë kursimet *cash* të vitit 2013, para se të blinte automjetin në vitin 2014, dhe se duhet të pranohej nga Komisioni pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjetit gjatë procesit të rivlerësimit, pretendime që nuk u morën në konsideratë për shkaqe të arsyetuara në këtë vendim. Ndërkohë, Komisioni çmoi ta marrë në konsideratë pretendimin mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit vlerën 15.000 euro pasi, meqenëse subjekti është penalizuar një herë për pamundësinë financiare për blerjen e tij në vitin 2014 në shumën 7.000 euro, në vlerësimin përfundimtar, në analizën financiare të vitit 2015⁹³ u përfshi si e

⁹²Në kushtet kur subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e automjetit me të ardhura të ligjshme në çmimin 7.000 euro në vitin 2014 dhe në kushtet kur subjekti nuk ka paguar në kohë detyrimin tatimor mbi diferencën prej 8.000 euro, shuma 15.000 euro nuk u konsiderua si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2015.

⁹³Në të cilën, me dërgimin e rezultateve të para të hetimit administrativ nuk ishin konsideruar të ardhura nga shitja e automjetit.

ardhur çmimi i blerjes 7.000 euro, dhe për këtë arsye balanca negative për vitin 2015 zvogëlohet nga 1.660.060 leke në 704.290 lekë, pasqyruar në tabelën përfundimtare të analizës financiare.

101.5. Në DPV-në e vitit 2015 subjekti ka deklaruar një kontratë shitblerjeje datë 27.10.2015, me palë shitëse “***” sh.p.k., blerë në shumën 3.855 euro, likuiduar *cash*, pa deklaruar burimin sipas parashikimeve ligjore. Ndërsa, në DPV-në e vitit 2016 është deklaruar: “Kontratë shitjeje autoveturë nr. *** rep., datë 30.6.2016, të shtetases K. B., në shumën 5.000 euro (shpjegim: autoveturë e blerë më herët nga shoqëria “***” sh.p.k., në vlerën 3.855 euro, sipas kontratës së blerjes nr. ***, datë 27.10.2015). Depozitimi i shumës në emrin tim është kryer në datën 30.6.2016, nga blerësja sipas mandatit bashkëngjitur”.

Në lidhje me transaksionet lidhur me këtë automjet, u konstatua se:

101.6. Nga aktet në dosjen e DPSHTRr-së rezultoi se me kontratën nr. ***, datë 27.10.2015, shtetasi Kolë Hysenaj ka blerë nga shoqëria “***” sh.p.k. automjetin tip “Peugeot”, në shumën 3.855 euro, pagesë e kryer në një nga llogaritë e kësaj shoqërie. Nga analiza financiare, subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 27.10.2015, me çmimin 3.855 euro.

101.7. Me kontratën nr. ***, datë 30.6.2016, shtetasi Kolë Hysenaj i ka shitur shtetases K. B. automjetin e sipërpërmendur në shumën 5.000 euro, likuiduar palës në llogari bankare. Duke qenë se nuk është paguar në kohë tatimi për të ardhurat nga shitja, në analizën përfundimtare, Komisioni çmoi që të konsiderojë si të ardhur të ligjshme për vitin 2016 jo shumën 5.000 euro, por çmimin e blerjes së këtij automjeti prej 3.855 euro.

101.8. Nga të dhënat bankare, u konstatua se:

101.8.1. Ka pasur disa transaksione në llogaritë e subjektit të kryera ndër vite nga shtetasit D. Gj., T. L., E. L., I. R., K. N. dhe F. M.. Në lidhje me këta shtetas është pyetur subjekti, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka dhënë shpjegime të detajuara për shkakun e transaksioneve dhe marrëdhëniet me këta shtetas. Po kështu, Komisioni kreu disa verifikime, në përfundim të të cilave nuk rezultuan dyshime dhe problematika, si dhe nuk u evidentua ndonjë rast konflikti interesi me subjektin Kolë Hysenaj gjatë ushtrimit të detyrës⁹⁴. Të gjitha transaksionet e evidentuara nuk kanë sjellë shtim likuiditetesh për subjektin, por janë veprime të kryera në emër dhe për llogari të tij.

101.8.2. Referuar të dhënave të “ProCredit Bank”⁹⁵, rezulton se në vitin 2009 subjekti ka marrë kredi pranë kësaj banke, të cilën nuk e ka deklaruar në DPV-të e viteve 2009 dhe 2010. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me këtë kredi, subjekti ka sqaruar se ka mësuar se bashkëshortja e tij D. H. ka aplikuar për një kredi të vogël konsumatore, pa kolateral, në vlerën prej 250.000 lekësh, që do të përdorej për riparimin e banesës. Për shkak edhe të vlerës së saj të vogël, bashkëshortja ka harruar ta deklarojë në deklarin periodik vjetor. Sjell në vëmendje se kjo kredi është likuiduar në mënyrë periodike brenda vitit. Ai sqaron se mosdeklarimi i saj nuk ka qenë qëllim në vetvete, pasi veprimet janë kryer me kontratë të rregullt dhe me transaksion të ligjshëm bankar. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të kontratës së kredisë së datës 3.6.2009, lidhur mes “ProCredit Bank” dhe D. H., si dhe planpagesa përkatëse.

⁹⁴Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr.*** prot., datë 3.3.2020, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në dosjen e Komisionit.

⁹⁵Shihni shkresën nr.*** prot., datë 3.5.2019, të “ProCredit Bank”.

Kjo kredi konsumatore, si dhe shlyerja e saj në vitet 2009 dhe 2010 është përfshirë në analizën financiare dhe sipas saj rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e kësaj kredie konsumatore.

101.8.3. Referuar të dhënave bankare janë konstatuar disa transaksione në llogaritë e subjektit nga persona të ndryshëm, ndër të cilët edhe një shtetas me emrin K. N., në lidhje me të cilin, pasi është pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, ka sqaruar⁹⁶ se është nënshkrimi i tij në disa dokumente e fatura. Kjo për shkak se në rrethin e ngushtë familjar të zonës së tij shpesh identifikimi i personave bëhej nga emri i tyre dhe i babait të tyre. Gjatë hetimit administrativ u kërkua informacion për shtetasin me emër K. N. nga institucionet ligjore, nga ku kanë rezultuar informacione për këtë shtetas, por me gjeneralitete të ndryshme nga ato të subjektit të rivlerësimit.

101.8.4. Nga lëvizjet e llogarisë në “Tirana Bank” është evidentuar se subjekti ka depozituar shumën 20.000 euro në datën 9.3.2010, të cilën e ka investuar në depozitë me afat deri në datën 19.3.2010. Nga kjo llogari, shtetasi D. Gj. ka tërhequr shumën 19.000 euro, nga marsi deri në qershor të vitit 2010. Në lidhje me këtë shtetas, i pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se⁹⁷ D. Gj. ka qenë ish-koleg i tij (aktualisht noter) me të cilin kanë punuar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe me kërkesë të tij në vitin 2010 kanë hapur një llogari “joint” në “Tirana Bank”, pasi këtij të fundit i nevojitej një vërtetim me qëllim pajisjen me vizë. Për të vërtetuar pretendimin e tij subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.12.2019, të këtij shtetasi, i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

101.8.5. Gjatë hetimit administrativ shtesë, Komisioni verifikoi mundësinë e subjektit për të krijuar me të ardhura të ligjshme depozitën 20.000 euro në mars të vitit 2010. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk kishte pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite, për të cilën i kaloi barra e provës për të vërtetuar origjinën dhe burimin e ligjshëm të shumës 20.000 euro. Në prapësimet e tij subjekti ka kundërshtuar barrën e provës, duke pretenduar se burimi i krijimit të saj janë kursime më të hershme nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe nga aktiviteti i bar-kafe “****”⁹⁸. Subjekti ka prezantuar një përmbledhje të analizës financiare për vitet 2003 - 2009, e cila rezulton me balanca pozitive për të gjitha vitet e analizuara dhe shumatorja e mundësisë për kursime totale rezulton të jetë 4.295.257 lekë, shumë për të cilën subjekti pretendon se është akumuluar dhe mbartur nga viti në vit, duke shërbyer edhe për krijimin dhe depozitimin e shumës 20.000 euro në “Tirana Bank” në mars të vitit 2010. Por në asnjë vit dhe në asnjë rast subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe prandaj këto shuma nuk mund të konsiderohen si burim për krijimin e depozitës 20.000 euro.

102. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk pa pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për depozitimin e shumës 20.000 euro në datën 9.3.2010, pasi në këtë datë rezulton me një mungesë të ardhurash prej -2.488.943 lekësh⁹⁹, sikurse është paraqitur në tabelën në vijim.

⁹⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁹⁷Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁹⁸Subjekti deklaroi se fitimi i aktivitetit bar-kafe “****” për vitin 2007 është 1.320.000 lekë, për vitin 2008 është 1.728.000 lekë dhe për vitin 2009 është 79.000 lekë.

⁹⁹Në analizën financiare të datës 9.3.2010, janë marrë parasysh të ardhurat nga bar-kafe “****”, si dhe është kryer reduktimi i shpenzimeve të mobilimit prej 100.000 lekësh, pasi këto të fundit janë konsideruar të kryera pas tërheqjeve të shumës 20.000 euro nga “Tirana Bank”.

Përshkrimi	9.3.2010
Pasuri	2 802 088
Depozitim te “Tirana Bank”	2 776 200
Shtesa/pakësime/ likuiditete	25 888
Të ardhura	481 558
Të ardhura nga paga, subjekti	224 247
Të ardhura nga paga, bashkëshortja	154 700
Të ardhura nga biznesi i bashkëshortes, bar-kafe	102 611
Shpenzime	168 413
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	100 313
Paguar kredia 250,000 lekë në “ProCredit Bank”	68 100
Mundësia për kursime	-2 488 943

Në lidhje me tërheqjen e shumës 20.000 euro brenda vitit 2010, subjekti parashtroi se motivi i saj ka qenë për t’u përdorur pjesërisht për nevoja familjare (ushqim, veshmbathje, mobilim, pagesë kësti kredie, udhëtime etj.), ndërsa shuma e mbetur ka qëndruar si kursim *cash* e cila është përdorur për blerjen e tokës në B. në vitin 2011. Këto pretendime mbeten në nivel deklarativ pasi, përveçse nuk mbështeten në deklaratën e vitit 2010 ku nuk deklarohen kursime *cash*, bien në kundërshtim me vetë deklarinimin e tij në këtë deklaratë, ku deklarohet: “... tërheqjet janë bërë në kohë të ndryshme për nevoja të mija familjare”. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se shuma 20.000 euro duhet të përfshihet si shpenzim në analizën financiare të vitit 2010¹⁰⁰.

102.1. Pas verifikimeve në sistemin e AMF-së ka rezultuar se në emër të djalit të subjektit kanë qenë të regjistruara dy automjete: (i) tip “Renault”, me targa ***; dhe (ii) tip “Landrover”, me targa ***. Për të dyja këto automjete, pas verifikimeve, nuk rezultuan të jenë në pronësi të subjektit apo djalit të tij, si dhe nuk u evidentuan dyshime, problematika apo lidhje me to.

103. Analiza financiare

103.1. Pas analizimit të të gjitha parashtrimeve dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ dhe rezultateve të hetimit administrativ shtesë, Komisioni çmoi se për të gjitha shkaqet e analizuar dhe të arsyetuara hollësisht në këtë vendim, analiza financiare përfundimtare të bazohet në deklarinimet e subjektit në DPV-të dhe pretendimet në lidhje me kursimet në formën e likuiditeteve *cash* të mbajtura në banesë në fund të çdo viti të mos merren në konsideratë.

103.2. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit trajtuar më sipër rast pas rasti për çdo pasuri, me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare përfundimtare, e cila tregon mundësinë e subjektit për të përballuar krijimin e pasurive dhe shpenzimet përgjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën si vijon.

	1	2	3	4	5	6
--	---	---	---	---	---	---

¹⁰⁰Çdo shpenzim i kryer nga data 19.3.2010, kur ka filluar tërheqja me pjesë e shumës 20.000 euro, dhe deri në fund të vitit 2010, është mbuluar nga shuma 20.000 euro.

Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime
Para 2003	1 960 000	1 600 000	360 000	4 592 587	2 910 912	1 321 675
2003	5 613	0	5 613	978 197	375 856	596 728
2004	1 541	0	1 541	1 007 587	436 691	569 355
2005	212 551	-300 000	512 551	1 324 024	655 124	156 349
2006	-129 285	-400 000	270 715	1 283 874	573 064	440 095
2007	131 174	-900 000	1 031 174	2 450 604	587 589	831 841
2008	2 688 092	0	2 688 092	3 314 748	821 870	-195 214
2009	279 336	107 851	171 485	2 291 740	911 308	1 208 948
2010	-791 106	-107 851	-683 255	2 084 945	2 801 009	-32 809
2011	11 204 066	4 953 976	6 250 090	2 171 810	931 713	-5 009 993
2012	13 818 421	-159 476	13 977 897	16 209 029	1 136 391	1 094 741
2013	-12 751 747	-187 340	-12 564 407	2 329 000	1 400 090	13 493 317
2014	1 748 261	-230 483	1 978 744	3 334 617	1 835 184	-479 312
2015	1 306 263	-277 698	1 583 961	3 059 671	2 180 000	-704 290
2016	18 046 817	-305 964	18 352 781	3 333 191	1 684 648	-16 704
Total	37 729 998	3 793 015	33 936 983	49 765 624	19 241 449	-3 412 807

Siç rezulton, totali i balancave negative është në shumën 23.125.856 lekë.

103.3. Edhe nëse do t'i referoheshim varantit të dytë të analizës financiare të kryer nga Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, duke konsideruar të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë në F., Tiranë, në shumën 134.900 USD, si gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit 2013, të mbartur pa ndryshime gjatë viteve 2014 dhe 2015 deri në vitin 2016, kur janë blerë pasuritë në Korçë, balanca negative do të ulej nga 23.125.856 lekë në 9.632.538 lekë, një vlerë përsëri e konsiderueshme dhe që përbën shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

103.4. Për sa i takon burimet të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të krijuara gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti gjendet në pamundësi financiare, për shkak të balancave negative, si vijojnë:

i) Për krijimin dhe depozitimin e shumës 20.000 euro në “Tirana Bank” në datën 9.3.2010, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -2.488.943 lekë.

ii) Për blerjen e tokës me sip. 2.000 m², në B., në datën 16.9.2011, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -5.105.654 lekë.

iii) Për blerjen e automjetit në datën 1.7.2013, në shumën 10.000 euro, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -911.862 lekë.

iv) Për blerjen e automjetit në datën 5.2.2014, në shumën 7.000 euro dhe për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, datë 30.06.2014 në shumën 14,000 euro, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -905.741 lekë.

v) Për blerjen e automjetit në datën 12.2.2015, në shumën 15.000 euro, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -2.042.729 lekë.

vi) Për blerjen e pronave në Korçë në vitin 2016, subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në shumën -16.704.238 lekë. Në rast se do të konsiderohej shuma 134.900 USD e mbartur si gjendje *cash* nga viti 2013 dhe e përdorur për blerjen e pasurive në Korçë në vitin 2016, pamundësia financiare do të rezultonte në shumën -2.893.176 lekë.

103.5. Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

Të ardhurat

- Të ardhurat e dokumentuara nga punësimi të subjektit nga viti 1994 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit¹⁰¹.
- Të ardhurat nga paga e bashkëshortes duke filluar nga vitit 1993 dhe deri në fund të periudhës së rivlerësimit¹⁰².
- Të ardhurat nga aktiviteti privat kafe-bar “*****”¹⁰³ nga fillimi i aktivitetit në vitin 2007 deri në fund të periudhës së rivlerësimit.
- Të ardhurat nga shitja e pronës në F., Tiranë në vitin 2013.
- Të ardhurat nga shitja e automjeteve e barabartë me vlerën e blerjes së tyre: 800.000 lekë në vitin 2010; 7.000 euro në vitin 2015; si dhe 15.000 euro këmbyer në vitin 2016.

Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare e cila për të gjithë periudhën e rivlerësimit është 4 persona, për periudhat si vijon: viti 1996 shpenzime 5.000 lekë/muaj për person; viti 1997 shpenzime 6.000 lekë/muaj për person; viti 1998 shpenzime 7.000 lekë/muaj për person; viti 1999 shpenzime 8.000 lekë/muaj për person dhe nga viti 2000 e në vijim, bazuar në standardin e ILDKPKI-së.
- Shpenzime për rinovim shtëpie në vitin 2009, duke përdorur kredinë e marrë në “ProCredit Bank” dhe shpenzime mobilimi në vitin 2010 sipas deklaratimeve të bëra në procesverbalin e datës 15.6.2016, në ILDKPKI.
- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁰¹Shihni vërtetimet e pagave të subjektit në aneksin 4/7 në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja.

¹⁰²Sipas vërtetimeve të pagave të bashkëshortes së subjektit, ndodhur në aneksin 4/10 në dosjen e administruar nga ILDKPKI-ja.

¹⁰³Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2017, nga DRT-ja Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2020, nga DRT-ja Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2020, nga DRT-ja Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 3.12.2020, nga Bashkia Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020, nga DRT-ja Tiranë; kontratë noteriale qiraje datë 12.1.2020, për ambientin ku zhvillohet aktiviteti, si dhe ekstrakt elektronik nga OSHE-ja; shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, nga OSSH-ja për pagesën e detyrimeve të këtij ambienti.

- Janë përfshirë si shpenzime, pagesat e interesave të kredisë së marrë për blerjen e tokës në vitin 2011, në B., Tiranë dhe kredisë konsumatore.
- Janë përfshirë shpenzimet e shkollimit për subjektin dhe fëmijët e tij.
- Çdo shpenzim tjetër sikurse është evidentuar nga lëvizjet bankare dhe çdo faturë/mandatpagesë e administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

Pasuritë

- Janë përfshirë të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes.
- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare¹⁰⁴ në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.
- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.
- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.
- Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

Detyrimet

- Kreditë e marra nga subjekti dhe bashkëshortja dhe shlyerjet e kësteve të tyre.
- Huat e marra nga individë/persona të tjerë të lidhur dhe shlyerjet e tyre sipas deklarimeve të subjektit.
- Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet.

Rezultati financiar është i përlllogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura (shpenzime + pasuri *neto*), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

104. Vlerësimi përfundimtar i Komisionit

¹⁰⁴Shihni shkresat nga bankat, të administruara në dosjen e Komisionit: shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2019, nga “Tirana Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2019, nga “ABI Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2019, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 24.4.2019, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 30.4.2019, nga Raiffeisen Invest; shkresë nr. *** prot., datë 3.5.2019, nga “ProCredit Bank”; shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2019, nga “Credins Bank”.

104.1. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit pasuror, referuar parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, u vërtetua që subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin në lidhje me pasuritë e krijuara ndër vite, si dhe nuk justifikoi krijimin e tyre me të ardhura të ligjshme. Për rrjedhojë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit 84/2016, i cili e parashikon këtë si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

104.2. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi që të gjitha konstatimet e bazuara në prova dhe në ligj janë të mjaftueshme për një vendimmarrje në favor të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e pasurisë dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, sipas pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*.

104.3. Në këtë vlerësim, Komisioni iu referua edhe qëndrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbajtur për subjektin Artur Malaj, në paragrafin 69 është shprehur se: *“Në vijim të përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të mësipërme të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues çmon se konkluzionet lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruar në deklaratën e pasurisë Vetting janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra”* dhe në paragrafin 70 është shprehur se: *“Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit dhe denoncimeve të publikut të paraqitura në Kolegj për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”*. Të njëjtin qëndrim, Kolegji ka mbajtur edhe në vendimin nr. 27 datë 22.10.2020, për subjektin Dritan Peka, paragrafi 22.

104.4. Në këto rrethana, Komisioni vlerësoi të mos analizojë gjetjet e tjera në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë të aftësive profesionale, për sa kohë që, ndonjë përfundim mbi këto kriterë nuk mund të ndryshojë vlerësimin përfundimtar bazuar në rivlerësimin e kriterit pasuror. Sa i takon këtyre kriterëve, trupi gjykues çmoi të përmendë në këtë vendim faktet e evidentuara nga organet ndihmëse që sipas ligjit kanë kryer vlerësimin si dhe hapat hetimore të ndërmarra nga Komisioni, pa u ndalur në një analizë të hollësishme të tyre, trajtuar në mënyrë të përmbledhur si vijon.

B. KONTROLLI I FIGURËS

105. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për

këtë qëllim, DSIK-ja¹⁰⁵ vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Kolë N. Hysenaj, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

105.1. Pasi u administruan dhe u verifikuan pranë organeve ligjzbatuese informacione konfidenciale për subjektin e rivlerësimit, pas kërkesës së Komisionit për deklasifikimin e raportit dhe përditësimin e të dhënave, DSIK-ja¹⁰⁶ vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 27.12.2019, të KDZH-së, nga ku rezulton se për këtë subjekt ka pasur informacion nga institucionet e verifikimit, bazuar në të cilat grupi i punës ndryshoi konstatimin fillestar nga përshtatshmëri në vijimin e detyrës në papërshtatshmëri për vijimin e detyrës.

105.2. Me qëllim verifikimin e informacioneve në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ndërmoi hapat hetimore, si vijojnë:

- U kërkuan të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, SPAK-u dhe Ministria e Drejtësisë¹⁰⁷, në lidhje me marrëdhënien e z. Kolë Hysenaj me të gjithë personat që ai kishte udhëtuar sipas sistemit *TIMS*, si dhe për personat me të cilët ka pasur marrëdhënie juridiko-civile, si dhe në lidhje me përfshirjen e tyre në veprimtari të krimit të organizuar.

- U kërkuan informacione për persona të cilët rezultuan që subjekti të ketë pasur kontakte sipas informacioneve konfidenciale të marra nga organet ligjzbatuese.

- U kërkuan informacione për shtetasit B. F., kunati i subjektit të rivlerësimit dhe K.F., vjehri i tij.

- U administruan dhe u shqyrtuan dosjet penale të çështjeve, për të cilat u gjenden informacione konfidenciale pranë organeve ligjzbatuese (përmendur në rubrikën “rivlerësimi profesional”).

- Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me raportin e DSIK-së dhe konkluzionet e tij, si dhe me të gjitha faktet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

Subjekti i rivlerësimit paraqiti në parashtrimet e tij qëndrimin mbi raportin e DSIK-së dhe fakte të evidentuara gjatë hetimit administrativ.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

106. U administrua raporti për analizën e aftësive profesionale, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 24.7.2020, protokolluar nga Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2020.

106.1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për analizën e aftësive profesionale, është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të cilat janë paraqitur prej tij; (ii) pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme. Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në

¹⁰⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, të DSIK-së, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2019, të DSIK-së, ku përcillet raporti nr. *** prot., datë 19.12.2019, mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj.

¹⁰⁷Ministrisë së Drejtësisë i është kërkuar informacion për shtetasin K. I..

Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin subjekt vlerësimi, z. Kolë Hysenaj, nuk rezultojnë masa disiplinore. Referuar ankesave sipas regjistrit të ankesave në Sektorin e Protokoll-Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit kalimtar, z. Kolë Hysenaj, janë paraqitur gjashtë ankesa të trajtuara nga prokuroritë kompetente, për të cilat janë analizuar shkaqet e ankimit, dhe në përfundim nuk janë evidentuar shkelje nga ana e tij. Referuar kallëzimeve dhe procedimeve penale, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ka rezultuar se për subjektin ka pasur katër kallëzime penale dhe një procedim penal, për të cilat, pas shqyrtimit nga prokuroritë kompetente është vendosur mosfillimi i procedimit penal ose pushimi i tij.

106.2. Në raportin e vlerësimit profesional subjekti është vlerësuar përgjithësisht pozitivisht në drejtim të aftësive profesionale, organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, si dhe aftësitë personale dhe angazhimin profesional. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjithashtu, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit.

106.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni ndërmori hapat hetimore, si vijojnë:

- U analizua raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të grupit të punës pranë KLP-së.
- U analizuan tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e përzgjedhura me short.
- U analizuan kallëzimet penale të rezultuara nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si vijojnë: (i) kallëzimi penal nr. ***, datë 11.1.2019, mosfilluar në datën 15.1.2019; (ii) procedimi penal nr. ***, datë 17.12.2018, filluar mbi një kallëzim ndaj subjektit të rivlerësimit; (iii) kallëzimi penal nr. ***, datë 2.2.2015, mosfilluar në datën 4.3.2015; (iv) kallëzimi penal nr. ***, datë 14.7.2015, mosfilluar në datën 11.9.2015; (v) si dhe procedimi penal nr. ***, datë 7.1.2008, pushuar në datën 28.3.2008.
- Bazuar në të dhënat e marra nga burime të ndryshme, u administruan dhe u shqyrtuan materialet e vëna në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për tri dosjet penale që i përkasin: (i) procedimit penal nr. ***, me të pandehur V. B.; (ii) procedimit penal nr. ***, me të pandehur K. H.; dhe (iii) procedimit penal nr. ***, me të pandehur A. F..
- U administruan 15 denoncime nga publiku, për 4 nga të cilat, u kërkuan dhe u shqyrtuan dosjet penale për çështjet e referuara nga denoncuesit, si dhe 5 denoncime nga publiku të administruara nga Komisioni pas riçeljes së hetimit administrativ, për të cilat me njoftimin e rezultateve të hetimit shtesë subjektit iu kërkuan sqarime.
- Subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me çdo konstatim të evidentuar gjatë procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale.
- Subjekti ka paraqitur shpjegime dhe dokumente për cilindo konstatim të evidentuar nga Komisioni.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datat 18.9.2020 dhe 15.4.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, u zhvilluan seancat dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, i cili në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë. Gjatë seancave dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe rezultatet e hetimit administrativ shtesë, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues.

Në datën 19.4.2021 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në komunikimet e tij, lidhur me dërgimin e shpjegimeve dhe dokumenteve të kërkuara, subjekti ka qenë përgjithësisht i gatshëm, por ka kërkuar disa herë shtyrje të afateve të përcaktuara, duke paraqitur në çdo rast arsytet, sipas të cilave ka qenë në pamundësi objektive për dërgimin e përgjigjeve.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, nuk arin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kolë Hysenaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore

dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orianda Liçi